



P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **30.8.2023 (e martë)**, me fillim në orën **10:35**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit, **Arbër Zenuni**. Në fillim konstatoi se ka kuorum për mbajtjen e mbledhjes. **Kryesuesi:** Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryetar i Komunës, **Smajl Latifi**, nënkryetar, **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit, kjo është mbledhja e tete (8) për këtë vit kalendarik. Fillimisht, me lejen tuaj, para se te fillojmë me mbledhjen e Kuvendit, sot, më 30 gusht, shënohet edhe Dita Ndërkombëtare e te Zhdukurve dhe në shenjë nderimi dhe përkujtimi ju kisha lutur për një minutë heshtje. Lavdi! Në mbledhjen e tetë të datës 18 gusht, Komiteti për Politikë dhe Financa, së bashku me Zyrën e kryetarit, vendosi për këtë rend dite:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të jashtëzakonshme, të datës 12.7.2023 dhe 17.7.2023;
3. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike P-02302-0, Zona kadastrale në Rahovec, me pronën e institucioneve qendrore P-0240-1, Zona Kadastrale në Rahovec, për interes publik.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike P-05371 Zona Kadastrale Rahovec, me pronën private P-055390, Zona Kadastrale Rahovec, për interes publik.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike P-01505-0, Zona Kadastrale Retijë, me pronën e institucionit qendror P-0050-0, Zona Kadastrale Opterushë, për interes publik;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike P-01505-0, Zona Kadastrale Retijë, me zonën e institucionit qendror P-01987-0, Zona Kadastrale Opterushë, për interes publik.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronave publike P-01313-1, P-01313-2, P-01313-4 dhe P-01313-5, Zona Kadastrale Rahovec, me pronën private P-01313-3, Zona Kadastrale Rahovec, për interes publik.

9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike P- 01015-1, zona kadastrale Xërxë, me pronën private P-01045-12, zona kadastrale Xërxë, për interes publik;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për faljen e borxhit mbi tatimin në pronë;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit të Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2023;
12. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për përfshirjen e komunitetit rom dhe Ashkali, 2023-2025;

Pikat shtesë

13. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien e lejes për kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore;
14. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-statutit të Ansamblit të Komunës së Rahovecit;
15. Shqyrtimi dhe miratimi i për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.264/22, i datës 25.1.2022, për themelimin e Komitetit për Komunitete, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin 01 Nr.414/22, të datës 28.12.2022

Po ashtu më lejoni të njoftoj që në emaillet e juaja zyrtare ka ardhurur një mesazh, që pika e dhjetë Shqyrtimi dhe miratimi për faljen e borxheve mbi tatimin në pronë, është hequr dhe mbi informacionet e mëtejme do të përgjigjet pjesa e ekzekutivit. Atëherë, me propozimin tuaj, ju njoftoj që ta kalojmë në rend të ditës.

Për arsyetimin e pikës shtesë të sjellë në këtë mbledhje të kuvendit, e ftojme drejtorin e Urbanizmit që të japë shpjegimin rreth kësaj pike.

Albnor Mullabazi – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, të nderuar kolegë drejtorë, asamble e kuvendit dhe gjithë pjesëmarrësit e tjerë të pranishëm në këtë seancë. Para jush e keni kërkesën për vendim për dhënien e vendimit të kuvendit për lëshimin e lejes dhe të kushteve ndërtimore për fondacionin Orllati dhe arsye pse ka ardhurur në kuvend për vendim është se me ligjet që i kemi, pasi e kemi zonën me 50 m rrethim dhe mund të lëshojmë P+2, kurse kërkesa është P+4, kështu që kërkojmë vendim prej kuvendit që të kemi të drejtë ta lëshojmë për kushtet dhe lejen ndërtimore. Po ashtu ju njoftoj që, me miratimin e hartës zonale, këtë zonë, në hartë zonale e kemi P+6, mirëpo për shkak se ende nuk kemi dokumentin e hartës zonale, atëherë kërkojmë një vendim prej kuvendit që të kemi të drejtë për leje dhe kushte ndërtimore.

Afrim Dina – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, anëtarë të kuvendit dhe gjithë ju të pranishëm! Siç e tha edhe kryesuesi, në mbledhjen e KPF-së ka qenë pikë e rendit të ditës Draft-statuti i Ansamblit të Komunës së Rahovecit. Grupi punues ka marrë vendimin nga kryetari i Komunës, i cili është themeluar më 04.04.2023, i përbërë nga 13 anëtarë për hartimin e draft - statutit të Komunës së Rahovecit, ku njëkohësisht grupi punues i ka mbajtur 5 takime të rregullta dhe gjithashtu ka mbajtur takimin apo konsultimin publik me qytetarë, më datën 02.07.2023, në sallën e Kuvendit Komunal ku kanë marrë pjesë qytetarë, profesionistë të artit, të muzikës, përfaqësues të shoqërive kulturore artistike dhe të gjitha procedurat kanë kaluar për draft-statutin që kanë qenë në konsultim publik nga 20 qershori, deri më 20 korrik dhe të gjitha komentet i kemi pranuar nga qytetarët dhe sot në këtë mbledhje e propozojmë që të jetë pikë shtesë e rendit të ditës në këtë mbledhje të kuvendit, ku njëherit kërkoj nga kuvendarët aprovimin e pikës shtesë.

Kryetari – Përshëndetje kryesues Arbër Zenuni, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendit, medie, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të LMT-së dhe gjithë ju pjesëmarrës te pranishëm. Ne e kemi pranuar një vendim i cili ka ardhur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, që ka ardhur si rezultat i plotësimit ndryshimit të ligjit mbi faljen e tatimit në pronë, i cili ka kaluar në leximin e parë në kuvend dhe në leximin e dytë ka hyrë në fuqi. Në vendimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që i është drejtuar kryesuesit dhe kryetarit të Komunës dhe jo vetëm neve si komunë por të gjitha komunave të Kosovës, ku është kërkuar nga kuvendet komunale që brenda datës 15 shtator ta adresojnë këtë kërkesë kuvendet komunale dhe ta mundësojnë faljen e tatimit në pronë deri në 100 euro. Në momentin kur është futur në rendin e ditës, nuk kam qenë prezent e që ndoshta edhe në konsultim me kryesuesin edhe nuk do të ishte futur fare në rendin e ditës sepse vendimi që ka ardhur prej MAPL-së nuk ka pasoja juridike për komunat dhe as për komunën tonë, pra nuk ka pasoja juridike nëse votohet apo edhe nuk votohet. Pra, ligji për plotësim-ndryshimin e faljes së tatimit në pronë nuk është konsultuar me asnjë komunë individuale dhe as me asociacionin e komunave të Republikës së Kosovës. Kështu që, asnjë shqetësim i asociacionit të komunave, i kolegjiut, i drejtorëve të drejtorive për Financa dhe Buxhet, i kryetarëve të komunave, por edhe i komunave individualisht, nuk është përfillur në këtë proces, pasi nuk bëhet fjalë për asnjë lloj koordinimi apo situatë të një marrëdhënieje produktive që duhet ta ketë në radhë të parë MAPL-ja, pasi duhet të ketë konsistencë kur bëhet fjalë për dëmet që mund t'i kenë komunat e Republikës së Kosovës. Kështu që, meqenëse jemi në këtë situatë, ne e kemi pasur një kuvend të jashtëzakonshëm të asociacionit dhe gjithashtu ka pasur takim të jashtëzakonshëm edhe kolegjiut i drejtorëve të drejtorive të Financave brenda asociacionit dhe kemi pasur debate rreth çështjes së pronës, pasi të gjitha ato janë legjitime, sepse kur rritet vlera e pronës apo e pasurisë, atëherë është mirë për Komunën, për shtetin dhe për qytetarët, pasi jemi më të fortë. Kështu që, nëse ne do të futemi në zbatim të këtij vendimi, atëherë nuk do ta harrojmë faktin se 651,172 euro do të humb komuna jonë nga falja potenciale e tatimit në pronë. Dhe secili nga ju mund të thoni se a jeni ju që ta bëni këtë falje të tatimit në pronë dhe unë me plot të drejtë mund të ju them se ne jemi që ta bëjmë moratorium, që tatimet Qeveria e Republikës së Kosovës t'u falë qytetarëve dhe le t'u mundësojë qytetarëve me mundësi të tjera të rritjes së mirëqenies dhe cilësisë së jetës së tyre. Mirëpo duhet të kihet parasysh se ai që do të falë, duhet të mendojë se si të veprojë në realizimin e kërkesave, interesave apo edhe nevojave që kanë qytetarët. Siç e dini, në shumë projekte i kemi me të hyra vetanake apo komunale dhe madje janë të planifikuara pasi edhe janë edhe të kontraktuara dhe në këtë rast Ministria e Financave është dashur të mendojë shumë seriozisht se si t'ia rimbursojë Komunës së Rahovecit shumën 651,000 euro, kështu që nëse humbin, atëherë ne nuk mund të sillemi me qytetarët sikur nuk po ndodh asgjë dhe ne nuk mund të realizojmë një projekt se u kemi falur tatimin në pronë vitin e kaluar apo këtë vit. Pra ata që janë në dijeni dhe secili prej jush që jeni të zgjedhur, e dini shumë mirë se çfarë do të thotë t'ia marrësh Komunës apo t'i humbësh 651,000 euro nga buxheti i Komunës, nga të hyrat vetanake dhe gjithashtu e dini se të miratosh ligje dhe të ftosh ekspertë dhe mos t'i konsultosh komunat dhe t'ia hedhësh topin se kinse komunat nuk duan t'i falin, atëherë kjo është diçka e paparamenduar apo e paakceptueshme. Kështu që nëse ka gabuar dikush apo nuk di dhe nuk ka mundur ta shkallëzuar vendimin brenda katër vjetëve dhe qytetari ta dijë që i është rritur tatimi në pronë dhe pastaj të shkojë shkallë – shkallë, po ndoshta edhe ka mundur ta pezullojë deri sa të kemi një përmirësim të ndjeshëm të gjendjes ekonomiko-sociale. Përderisa asnjëri prej këtyre veprimeve nuk është ndërmarrë dhe tash ne ftohemi ta falim tatimin në pronë në emër të kujdesit ndaj qytetarëve dhe kjo për pasojë të mbetet barrë e Komunës që ta falë apo mos ta falë, që me plot vetëdije të ndëshkohet, goditet apo të komprometohet para qytetarëve, pasi nëse kjo ndodh, falje, atëherë sigurisht se qytetarët kërkojnë shërbime të tjera, si rrugë, rrugica, kanalizim dhe ti nuk mund të gjesh justifikime as si ekzekutiv dhe as si asamble, sepse nuk ka rimbursim të mjeteve dhe për këtë nuk kemi ndonjë sinjal se do të ndodhë rimbursimi dhe argumenti më i rëndësishëm është se ne edhe si Komunë zakonisht kur kemi konteste apo dilema nuk veprojmë, i pezullojmë aktivitetet. Dua të them se ne kemi bërë një

padi në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe padia është bërë nga Komuna e Prizrenit, si komunë individuale, sepse asociacioni si asociacion më vështirë e ka të bëjë një padi ose komunat kanë të drejtë të bëjnë një padi në Gjykatën Kushtetuese. Kështu që padinë në emër të Komunës së Prizrenit e ka bërë kryetari i Komunës, Shaqir Totaj, ku përshkruhet situata edhe dëmet që i ka Komuna e Prizrenit, në këtë rast, pasi padia është bërë nga avokati specialist dhe të gjitha komunat, pa i përfshirë komunat që udhëhiqen nga komuniteti serb, atëherë janë mbi 29 milion euro dhe këtë shumë qeveria nuk e kompenson, po së paku deri më tani nuk ka sinjale se do t'i rimburojë dhe në atë padi janë dy kërkesa të parashtruara, ku kërkesa themelore është të kontestojmë ligjin, sepse ne konsiderojmë se është në kundërshtim me ligjin për vetëqeverisje lokale, pasi e cenon autonominë financiare të komunave dhe është ndërhyrje e pazakontë në autoritetin apo autonominë e komunave të Republikës së Kosovës dhe rrjedhimisht e cenon ligjin për vetëqeverisje lokale dhe kërkesa e dytë është masa e përkohshme e sigurisë. Kështu që ne shpresojmë se gjykata kushtetuese nuk do të vonohet në adresimin e këtij shqetësimi që është i Komunës së Prizrenit, që i humb mbi 3 milion euro, ndërsa komuna jonë i humb 651,172 euro, ndërsa komuna e Prishtinës i humb mbi 8 milion. Kështu që arsyeja themelore që kemi larguar nga rendi i ditës dhe në konsultim edhe me kolegët e mi bashkëpunëtorë, por edhe me kolegët mi homologë të komunave, është sepse ka hyrë në KPF që mendoj se nuk është gabim asgjë dhe është menduar të futet në kuvend, por ndërkohë kanë ndodhur zhvillimet lidhur me padinë që është bërë në Gjykatën Kushtetuese dhe diskutimet thelbësore që kanë ndodhur, pasi prej Komunës tonë, në atë kuvend ka qenë Melinda Oruqi dhe e di shumë mirë se çka është biseduar dhe natyrisht ne do të veprojmë për shkak se mbi të gjitha jemi të interesuar ta mbrojmë interesin publik, pra interesin qytetar dhe mos t'ua komplikojmë jetën qytetarëve por as asambleve komunale apo ekzekutiveve komunale, kryetarëve të komunave dhe në këtë rast neve si Komunë. Pra nuk duhet që ta komplikojmë pasi ne zyrtarisht, buxhetin e dorëzojmë te kryesuesi i Kuvendit dhe planifikimet janë bërë, kështu që ne nuk mundemi dikë pa e konsultuar, pra nuk mund ta bëjmë një ligj që i dëmton komunat e kësaj Republike, të këtij shteti, pasi pa komuna të forta, nuk ka as shtet të fortë dhe nuk mund të marrim një veprim pa u konsultuar me juve si asamble komunale dhe ta marrim mbështetjen e asamblesë. Pra, parimisht u drejtohem qytetarëve të Komunës dhe të gjithë juve si asamble komunale, përveç që jam që të falet tatimi në pronë, jam edhe të mbështes edhe format e tjera që t'u krijojmë kushte të favorshme. Kështu që qeveria le ta shpallë moratorium, mirëpo neve si komuna le të na i rimburojë së paku ato të hyra që i prodhon falja potenciale e tatimit në pronë. Pra, unë jam që kjo pikë të mos futet në rend të ditës dhe ndërkohë presim verdiktin e gjykatës kushtetuese se çka po thotë dhe unë ju ftoj që kjo pikë duhet të largohet nga rendi i ditës sepse nuk mund të jemi ata flamurtarët e një Komune edhe pse është mirë në performancë e në transparencë që të marrim një vendim të tillë, pasi ne nuk duhet të biem në grackën e dikujt që duhet ta ketë respektin apo miqësinë ndaj komunave dhe detyrimet që kanë komunat ndaj qytetarëve. Pasi ne vazhdimisht kemi bërë motivim që qytetarët ta kryejnë obligimin e tatimit në prone dhe sigurisht se është krijuar një standard, pasi më pak ka nevojë të dërgohen vërejtje edhe pse ndonjëherë kemi dërguar edhe vërejtje që i kemi marrë edhe me përmbarues sepse është tatim obligativ. Nuk mundemi ne për një ndërmarrje të fuqishme që e kanë bërë të gjitha pushtetet gjatë ushtrimit të tyre që nga paslufta, nuk mundemi me një veprim me një politikë joserioze për diçka që është krijuar gjatë gjithë këtyre viteve, e kanë krijuar këtë imazh dhe ne krenohemi tani që të hyrat nga tatimi në prone janë 100% dhe kjo politikë joserioze në emër të faljes, të komplikohet jeta e komunave. Pra, çfarëdo diskutimi është i dobishëm dhe i rëndësishëm, por heqja nga rendi i ditës ka arsye themelore, sepse së pari nuk mund t'u them nëse qeveria nuk i kompenson 651,000 euro, çfarëdo ju them juve si asambleistë dhe fushave të tjera si sportit, kulturës e shumë OJQ-ve, do të thoni pse nuk u ndihmuan më shumë këto kategori, mirëpo ju e dini që gjithçka është me subvencione dhe përmes subvencioneve mund t'u ndihmosh sportit, kulturës, rinisë, OJQ-ve, pastaj shoqëritë kulturore-artistike e madje edhe bujqësinë. Kështu që të gjitha këto subvencione janë me të hyra vetanake, mirëpo paraprakisht duhet që ministri i Financave duhet ta konfirmojë të rimburojë këtë shumë, atëherë ne jemi që çdo

vit t'u falim. Pra, në këtë rast, unë reflektoj përgjegjësi individuale edhe si kryetar i Komunës dhe jam i zgjedhur prej qytetarëve të Komunës dhe nuk përtoj që të ballafaqohem me askënd me konstruktivitet, por ne si kuvend i Komunës, ju kisha lut që të përgjigjet dhe të japë shpjegime edhe Ministria e Financave e po ashtu edhe Ministria e Arsimit për çështjen e librave e plot tema të tjera. Pra jam për ta larguar këtë pikë prej rendit të ditës dhe kërkoj mirëkuptimin e qytetarëve pasi qeveria e ka bërë ligjin pa komunat dhe mendoj që kjo përgjegjësi i takon qeverisë edhe sigurisht se jemi pro faljes, por sigurisht që le ta marrë përgjegjësinë të rimbursojë dhe mos ta luftojë suksesin e komunave të Republikës së Kosovës, pasi tani për tani janë komunat ato që kane arsye që po bëjnë diçka për këtë vend.

Sejfullah Sejfullahu - Faleminderit kryesues, përshëndetje kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë dhe gjithë ju të pranishëm. Do të mundohem të flas pa politikë pasi kur flas për ansambël atëherë aty nuk duhet shumë politikë, por duhet angazhime. Siç u tha që Komiteti për Politikë dhe Financa e ka hequr prej rendit të ditës pikën për themelimin e Ansamblit, ku realisht ka qenë kërkesë e imja si asambleist e po ashtu edhe si udhëheqës i ansamblit SH.K.A "Bajram Curri", nga Krusha e Madhe. Ideja për themelimin e ansamblit "Bajram Curri", ka qenë një prej ideve më të mira që ka pasur asambleja prej fillimit, edhe pse në bisedë e sipër se si do të krijohet ansambli më mirë, atëherë kemi menduar se do të ishte mirë ta shndërrojmë ansamblin "Bajram Curri", që të transformohet edhe të bëhet pak më zyrtar edhe pse ka kohë që Ansambli "Bajram Curri" po funksionon si ansambël i Komunës. Mirëpo, pas disa takimeve dhe bisedave që kemi pasur, atëherë në konsultim edhe me drejtorin, e kemi kuptuar se kjo është pothuajse e pamundur, atëherë unë kam bërë kërkesë dhe kam kërkuar prej anëtarëve të KPF-së që mundësisht të shtyhet, pasi kemi probleme statutore, sepse SH.K.A. "Bajram Curri" është e regjistruar si shoqëri kulturore-artistike dhe për të kaluar në ansambël duhet edhe disa procedura dhe medoemos duhet të shtyhet edhe për një muaj. Kështu që i falënderoj anëtarët e KPF-së që e kanë përfillu këtë kërkesë me mirëkuptim, mirëpo ju po insistoni që gjithqysh të themelohet dhe unë nuk dua të jem pengesë që mos të themelohet jo vetëm ky ansambël po kisha dëshiruar që çdo fshat të ketë ansambël, bile edhe qyteti t'i ketë 2 apo 3 ansamble, pasi unë prej moshës 13 vjeçare jam pjesë e ansamblit, afër 40 vjet dhe është gjëja më e mirë që më ka ndodhur, pasi është mirë të kultivohet arti dhe të ruhen vlerat. Pra, i nderuar kryetar, qëllimi im nuk ka qenë për të përfituar si anëtar i SH.K.A "Bajram Curri", po flas jo si Sefë, pasi jam udhëheqës, mirëpo asnjëherë s'kam pasur asnjëherë ambicie dhe nuk do të kem, pasi edhe kriteret nuk i plotësoj, por e kemi një këshill teknik apo udhëheqës artistik që nuk e kam pasur për t'i punësuar ata edhe pse do të ishte shumë e logjikshme që gjatë kësaj periudhe janë po të njëjtit, sepse kanë bërë mund. Pra, siç e dini, gjithmonë kanë qenë bartës të aktiviteteve kudo që janë mbajtur, pasi vetëm në fshatin Krushë e Madhe kemi mbi dhjetë aktivitete e po ashtu edhe kudo në Komunë të Rahovecit. Pra, qëllimi ka qenë i gjithë asaj që kam bërë kërkesë, por sido që të jetë, duke i falënderuar të gjithë anëtarët e KPF-së, nuk dua të jem shkas i mosthemelimit. Mirëpo, dua të pyes nga ju, se përderisa krijohet një ansambël me pagesë, atëherë do të jetë pothuajse e pamundur të mbahen anëtarët e SHKA "Bajram Curri" në kontroll e ndoshta të vije deri te shuarja e ansamblit, kështu që e mbaj përgjegjësinë për fjalën publike se nuk mund të marrë përgjegjësi që mund të vazhdojmë në këtë formë mirëpo nëse ju e keni ndonjë formë apo ide se si të mbahet edhe SHKA "Bajram Currin". Po ashtu, kryesuesi e përmendi 30 Gushtin, atëherë unë ju bëj thirrje se kush ka mundësi të vije sot në orën 19:00 në Krushë të Madhe, si Dita e të Pagjeturve që të ndezim flakadanë, pasi në Krushë të Madhe janë edhe 64 krushjanë të pagjetur.

Kryetari - E kuptoj preokupimin e anëtarit të kuvendit, Sefullah Sejfullahu, mirëpo zakonisht bisedat që i diskutoj në zyrën e kryetarit nuk i bëj edhe në sallën e Kuvendit dhe para dy ditësh i kam pasur në takim Sefën edhe Fatmirin dhe kemi diskutuar për këtë temë. Kështu që tani Sefa është i informuar, pasi kam menduar se ansambli mund të bëhet edhe në një fshat ku ka përvojë dhe traditë, mirëpo e kemi parë që ansambli mund të krijohet veç në Rahovec, pavarësisht se praktikisht po funksionon dhe për këtë jemi pajtuar me Sefën se kjo mund të krijohet veç në qytetin e Rahovecit, e po ashtu Sefa e di që përkrahjen për ansamblin e kemi rritur nga

viti në vit dhe premtoj se do ta rris edhe në vitin e ardhshëm. Pra, ka disa mundësi apo opsione se si bëhen ansamblet, si OJQ, ansamblet private, mirëpo ne po flasim për ansambël komunal, i cili bazohet në ligj, udhëzime, procedura. Ne kemi ansambël komunal edhe në Obiliq, pastaj kemi në Deçan, por ende shteti ynë nuk ka arritur t'i caktojë kuotat edhe t'i punësojë ata që janë të shpallur me konkurs dhe që kanë fituar të drejtat të punësohen si profesionistë me rrogë të përhershme, përveç ansamblit shtetëror që ka një zgjidhje, kurse ansamblet e tjera vazhdojnë të paguhet me subvencione. Mirëpo, nëse e kemi themeluar me vendim të Kuvendit ansamblin, gjithmonë duke menduar se SHKA "Bajram Curri" nga Krusha e Madhe është për shkak të traditës dhe dëshmi, atëherë grupi punues kur ka filluar të merret seriozisht rreth themelimit të ansamblit, e që në mesin e grupit punues janë edhe nga Krusha e Madhe, si respekt për shkak të traditës që e kanë të gjatë, atëherë kanë ardhur në përfundim se nuk mund të themelohet një ansambël pa i përfillur procedurat e duhura, por ansambli bëhet duke u bazuar në normativën ligjore. Por, nëse miratohet draft-statuti dhe behet statut, atëherë nuk do të thotë që ne me automatizëm e krijojmë ansamblin e që ndoshta mund të shkojë edhe deri në 5 vjet deri sa të fitojmë ndonjë kuotë për kryetarin apo drejtorinë, sektorët e tjerë e që ndoshta asnjë Komunë nuk i ka fituar. Mendoj që nuk dua të lë asgjë diskrete, pasi vonesat nuk kanë asnjë kuptim tani edhe pse unë personalisht i kam pasur të paqartë dhe me njëfarë mënyre kam bere presion që të dërgojmë mesazhin, duke menduar se kemi ansamblin "Bajram Curri", duke ditur që kemi themeluar me vendim dhe ekziston infrastruktura e nevojshme dhe grupin e valltarëve e kemi, mirëpo, duke analizuar më tutje, e kemi parë se nuk ishte ashtu, edhe pse unë mendoj se bazamenti i ansamblit është në Krushë të Madhe, duke ditur historinë gati 50-vjeçare dhe traditën që posedon dhe na kanë bërë krenarë kudo që janë prezantuar dhe gjithmonë na janë përgjigjur për çfarëdo kërkesë që kemi pasur, ndoshta edhe atëherë kur nuk kemi pasur mundësi t'u ndihmojmë si Komunë. Unë mendoj se Ansambli i Valleve popullore "Rahoveci", në Rahovec, është mirë të themelohet pavarësisht duam apo nuk duam, pasi nuk lejohet diku tjetër, mirëpo kjo nuk do të thotë që SHKA "Bajram Curri" nga Krusha e Madhe nuk mund të ndryshojë statutin e vet në këtë kuvend edhe ta kthejë në ansambël si OJQ dhe në këtë rast ne si Komunë mund t'i ndihmojmë më shumë përmes subvencioneve, kurse sa i përket rrogave nuk mund t'u japim as këtij ansambli pasi të miratohet, pasi nuk kemi kuota. Pra ne nuk mund ta kemi një drejtor të ansamblit apo kryetar të ansamblit institucional edhe përkundër faktit që e miratojmë statutin sepse duhet t'i kërkojmë kuotat dhe si shembull për këtë e kemi palestrën sportive e kemi krijuar që shumë vite dhe ende nuk kemi asnjë kuotë deri më tani dhe nuk kemi të drejtë asnjë punëtor teknik për shkak të pamundësisë së marrjes së kuotës, edhe pse për çerdhe dhe QKMF, na ka dhënë, mirëpo për palestër nuk kemi pasur mundësi të marrim asnjë kuotë deri më tani e që ndoshta edhe për ansambël nuk kemi siguri se do të na japë, mirëpo do të luftojmë dhe do të bëjmë përpjekje që të sigurojmë kuota që kryetarët e anëtarët dhe gjithë udhëheqësia e ansamblit komunal të paguhet, sikurse që paguhet Ansambli Shtetëror "Shota". Kështu që nëse edhe krijohet pas miratimit, atëherë ne me subvencione mund t'i ndihmojmë sigurisht nëse është funksional, kurse SHKA "Bajram Curri", shpresoj që jo vetëm që nuk do ta ndërpresë aktivitetin, por edhe do ta rrisë aktivitetin dhe publikisht e them se duhet që ta bëjnë një plan vjetor se do të mundohemi të kujdesemi edhe më shumë për t'i forcuar kapacitetet e atyre që janë aktiv dhe sigurisht se do të bëjmë përpjekje të vazhdueshme për të siguruar kuota për ansamblin komunal "Rahoveci". Kështu që mendoj se nuk ka vend për keqkuptime dhe nuk ka nevojë të krijohen paqartësi dhe gjithashtu nuk ka pasur nevojë të largohet nga rendi i ditës, pasi është një procedurë normale, pasi mund të shkojë që deri pas 5 vjetësh fitojmë kuotën, që të kemi mundësi të krijojmë vende të punës dhe t'i paguajmë njerëzit që kontribuojnë për kulturën tonë folklorike apo kombëtare. Edhe njëherë ju ftoj që të rikthehet në rend të ditës, pasi ansambël komunal vetëm një duhet me qenë, kurse ansamble të tjera private apo përmes OJQ-ve, të avncojnë me ndryshim-plotësime pasi edhe OJQ-të e kanë njëfarë statuti që të krijojnë një amendamentim në kuvendet e tyre, mund të avancojnë në ansamble, mirëpo pastaj mund të jetë ansambël që udhëhiqet nga një OJQ, apo është ansambël privat. Sa i përket SHKA "Bajram Curri" në Krushë të Madhe do ta përkrahim vazhdimisht edhe nëse

do të jeni si ansambël privat edhe nëse do të funksionojnë si OJQ me plotësim-ndryshimin e statutit të tyre, do ta kenë përkrahjen e institucionit të Komunës, pasi ka një traditë dhe na ka nderuar si Komunë e madje edhe përtej Komunës me plot aktivitete cilësore kulturore e artistike.

Sejfullah Sejfullahu – Vetëm si sqarim e kam me kryetarin pasi takimin me ju në zyrën tuaj e kisha edhe me tre bashkëpunëtorë të mi që të bisedojmë edhe ta sqarojmë këtë çështje. E para ka qenë e gabuar pasi kryetari im apo udhëheqësi artistik, apo personi që e ka caktuar drejtori për kulturë, prej 5 takimeve ka qenë vetëm në një takim, kështu që nuk na ka informuar sa duhet neve si bord i SHKA “Bajram Curri”. Pastaj takimi në zyrën tuaj, kryetar, ka qenë i domosdoshëm për të marrë një vendim dhe për t’ju kërkuar falje dhe gjithashtu edhe për t’i falënderuar të gjithë anëtarët që kanë kërkuar në mbledhjen e KPF-së që të shtyhet, pasi jam bindur se pasojat juridike, pasi baza juridike nuk e lejon. Kështu që kryetar nuk ka asgjë diçka që të merret personale pasi e dimë se ju e doni SHKA “Bajram Curri” dhe vazhdimisht ju si kryetar i Komunës e keni përkrahur në maksimum me buxhet, në krahasim me qeveritë e kaluara, kështu që ne do të bëjmë përpjekje që ta mbajmë edhe SHKA “Bajram Curri”, por sigurisht se do të jetë një sfidë në vete edhe sigurisht se nuk e kemi aspak të lehtë duke e ditur që punohet më tepër vullnetarisht dhe pa asnjë interes duke bërë prova tri herë gjatë javës.

Kështu që mendoj se numrat në kuvend janë dhe mund ta ktheni në rend të ditës edhe sigurisht se jo vetëm një, por edhe dhjetë ansamble nëse themelohen, unë do të mundohem të jap kontributin tim edhe sigurisht se do ta votoj. Po ashtu e thashë shumë qartë, pasi ideja juaj kryetar ka qenë shumë e mirë duke ditur se SHKA “Bajram Curri” të transformohet si ansambël, duke ditur që ka qenë i gatshëm dhe ta vazhdojë punën.

Defrim Kafexhiu – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë, zyrtarë komunal, përfaqësues të KFOR-it, medie dhe të gjithë ju të pranishëm. Më herët, kryetari i Komunës më quajti më herët flamurtar, pasi e mora fjalën, por gjithmonë do ta kërkoj fjalën për ta kërkuar të drejtën për qytetaret e Komunës së Rahovecit. Kryetari tha që pa u konsultuar me anëtarët e kuvendit nuk bëj asgjë, por ju kryetar po e largoni pikën prej rendit të ditës dhe ju nuk doni të konsultoheni me ne, pasi po e tërhiqni pikën e rendit të ditës vetëm se keni mundësi ta tërhiqni. Kështu që ju mund ta lini në rend të ditës edhe të konsultoheni me anëtarë të kuvendit se çka po bëhet me atë pikë të rendit të ditës, kjo i bie që ju nuk konsultoheni me ne por ju konsultoheni vetëm me bashkëpunëtorët tuaj. Po ashtu urime për përmbushjen e planifikimit mbi të hyrat vetanake për vitin 2023 dhe kjo është një vlerë e shtuar po besoj për ekzekutivin, po unë mendoj se edhe këtu është një e keqe që është keqplanifikim për vitin 2023, pra keqplanifikim i të hyrave vetanake, me qenë se është tejkaluar shumica e të hyrave. Gjithashtu, kryetari e potencoi se mbi 600,000 euro po i humbin Komunës së Rahovecit edhe po bllokohen projektet, atëherë cili projekt u përfundua mirë vitin e kaluar që nuk u falen borxhet mbi tatimin në pronë dhe kurrfarë penalizimi nuk i bëhet Komunës në këtë aspekt. Por, meqenëse kryetari po e largon këtë pikë nga rendi i ditës, unë po e propozoj që në bazë të plotësim-ndryshimit të ligjit 06 L005 për tatimin e pronës së paluajtshme, d.m.th. sipas vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të iniciuar nga Ministria e Financave, saktësisht sipas nenit 11B, në pikën 1, tregon shumën e faljes së tatimit në pronë për të gjithë tatimpaguesit lejohet deri në lartësinë e faturës së tatimit në pronë, të vitit 2023, por jo më shumë se 100 euro dhe pika e dytë e këtij vendimi thotë se vendimi për faljen e tatimit në pronë merret nga kuvendi komunal i çdo komune më së largu 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas përkufizimit të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni. Kështu që ju thoni se kinse unë po veproj mirë me qytetarë, kurse ministria me këtë vendim është vendim politik, kështu që kjo nuk është e vërtetë, pasi Ministria e zgjat për qytetarët një pjesë, kurse pjesën tjetër e bëni ju si Komunë, por vetëm duhet të ketë vullnet për ta bërë. Kështu që, ne emër të grupit të asambleistëve të VV-së, propozoj pikën shtesë të rendit të ditës: Shqyrtimi i propozimit të vendimit për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023, po ashtu kërkoj edhe mirëkuptimin e anëtarëve të kuvendit që ta vendosim këtë pikë në rendin e ditës dhe së bashku të shqyrtojmë fillimisht dhe më pas të

miratojmë vendimin për faljen tatimit në pronë, sipas vlerave të përcaktuara me ligj. Pra, kërkoj që vetëm ta vendosim njëherë në rend të ditës e më pas të diskutojmë.

Kryetari – Për sqarim, e para, tavanet buxhetore edhe në të hyra i bën Ministria e Financave edhe përcakton shumën, kurse planifikimin brenda drejtorive e bën komuna, kështu që nuk qëndron ajo që u tha nga parafolësi. Pra, planifikimi i të hyrave, shuma e të hyrave, pra tavani, përcaktohet nga Ministria e Financave dhe kjo është mirë që mos të dalë keq tani pse këtë duhet që ta dimë të gjithë. Pra, nuk bëhet fjalë për planifikim të dobët të të hyrave, por unë e jap një argument, siç e thashë edhe me herët, pasi u bë zhurmë e madhe se a po dyfishohet apo trefishohet, duke krijuar situata të tilla se ndoshta do të ketë rritje të tatimit në pronë, megjithatë kjo mund të jetë edhe një sukses se ka ngritje të nivelit të edukimit dhe të emancipimit të ndërgjegjes e të përgjegjësisë të qytetarëve për detyrimin ligjor që kanë për ta paguar tatimin në pronë dhe unë jam krenar që drejtori i Financave e ka konstatuar dje që i kemi tejkaluar të hyrat dhe se tatimi në pronë është paguar më shumë se kurrë për shkak të frikës se po dyfishohet, pra ka pasur një mobilizim të njerëzve për ta paguar tatimin në pronë, kështu që realizimi 100% i të hyrave, u jep mundësi ekzekutivit dhe asamblesë komunale për të pasur një vendimmarrje më produktive për interes publik, për shkak se rriten të hyrat dhe shumë mire që rriten. Por, mos harroni se as edhe një orë nuk ka zgjatur kur është dërguar rendi i ditës për anëtarë të kuvendit për këtë mbledhje të kuvendit dhe ju ka ardhur një email nga shefi i Sektorit të Kuvendit, Skender Hamza, se hiqet nga rendi i ditës dhe arsyet e kësaj shpjegohen në kuvend, kështu që nuk duhet harruar faktin se ky ligj ka shkuar në Gjykatën Kushtetuese. Prandaj, nuk nderohemi nëse them njëherë e ka mirë Gjykata Kushtetuese e njëherë tjetër keq, por tani i kemi shpallur kontest ligjit dhe secili e ka të drejtën e vet dhe të konceptuarit të situatave dhe për këtë kemi luftuar, që të jemi shtet demokratik, por derisa ligji është në Gjykatën Kushtetuese, nuk ka arsye ta marrë flamurin Komuna e Rahovecit, përderisa është ligji në kontest dhe ne i kemi shpallur kontest në mënyrë institucionale dhe tani duhet që ta presim vendimin e Gjykatës Kushtetuese, që mos ta marrim flamurin për diçka që ende nuk e ka dhënë verdiktin Gjykata Kushtetuese. Kështu që, ndoshta një moment të caktuar, nga presioni i madh, edhe nga e komunave të Kosovës, por edhe verdikti i Gjykatës Kushtetuese, e detyron ministrin e Financave që të krijojë mendim tjetër që ta rimbursojë shumën e tatimit në pronë që do të falet dhe kështu që nuk duhet të ngutemi për këtë dhe nuk ka të bëjë asgjë me politikë, pasi asgjë nuk më ikën nga vëmendja që ka të bëjë me interesin publik. Pra, asgjë s'ka të bëjë me politikë këtu, përveç që është shqetësim real dhe 651,000 euro janë më pak dhe kjo sigurisht se ndikon në buxhetin Komunës tonë dhe kjo shumë nuk është pak, sepse vendimi i MAPL-së e po ashtu edhe vetë ligji për faljen e tatimit në pronë u ka dhënë të drejtë komunave që ta dërgojnë në Gjykatë Kushtetuese. Në momentin kur u bë rivlerësimi i pronave, u rrit vlera dhe nga frika e rritjes e vlerës së tatimit në pronë, nga kjo pakënaqësi, atëherë ministri i Financave mori iniciativë tjetër të bëjë ligj për faljen e tatimit në pronë dhe këtë ligj e ka bërë pa konsultim me komunat. Për një ligj që ka të bëjë me komunat dhe drejtpërdrejt i prek komunat në anën financiare dhe i dëmton financiarisht komunat dhe gjithashtu i dëmton projektet e Komunës që janë me të hyra vetanake, që janë të planifikuara, pastaj e cenon autonominë e komunave, pasi në njërin, të ka sjellë që ta vendosësh vetë dhe të vendos në një situatë aspak të përshtatshme si Komunë, kështu që duhet të kemi maturi sa i përket kësaj çështjeje dhe duhet të presim. Pra, vendimi i Gjykatës Kushtetuese është ai që na tregon neve, përndryshe vendimi i ministrit të Pushtetit Lokal, që brenda 15 shtatorit, mendoj se nuk prodhon pasoja juridike. Po ashtu edhe po të mos shkonte ligji në Gjykatën Kushtetuese, ministri i Financave u ka lënë në kompetencë kuvendëve që të vendosin dhe ta vlerësojnë vetë dhe cili është shërbimi më i mirë, pasi ka diversitet sa i përket faljes. Kështu që ne duhet ta presim vendimin e Gjykatës Kushtetuese se është më mirë, më e ndershme dhe më politike e po ashtu edhe dinjitoze, për shkak se i kemi shpallur kontest gjyqësor. Tani, në këtë rast, ndoshta edhe i jep të drejtë Gjykata Kushtetuese ministrisë së Financave, por ne si komuna i kemi shpallur kontest dhe duhet të presim, pasi ata e kanë një afat kur neve na kthejnë një përgjigje, e ne këtë rast, Komunës së Prizrenit i kthejnë përgjigje, pasi Gjykata Kushtetuese është institucioni më i lartë që

më pas vendimet janë të pakthyeshme dhe të pakomentueshme. Sigurisht se unë e konsultoj kuvendin, pasi edhe i sjell pikat e rendit të ditës, pasi në momentin kur është futur në rend dite në KPF, nuk kam qenë këtu hiç, edhe nuk janë konsultuar as me kryesuesin dhe në momentin që ka ardhur një vendim, duhet me patjetër të futet në rend të ditës, pasi sikur të isha prezent, as në KPF nuk e kisha futur, sepse kisha pritur çka po bëjnë edhe të tjerët, sepse asnjë Komunë se ka futur as në KPF. Prandaj, meqenëse ka kaluar në KPF dhe ka mbetur për kuvend, menjëherë kam reaguar që menjëherë të lajmëroheni që ne po e respektojmë KPF-në që e ka diskutuar dhe ka mbetur që të futet në kuvend, por duhet që ta largoni nga rendi i ditës dhe arsyet e tërheqjes i shpjegojmë në kuvend. Pra, nuk bëhet fjalë për anashkalim, por për një situatë ndaj të cilës ne duhet të jemi të përgjegjshëm dhe të vëmendshëm sepse nuk ka nevojë të marrim vendim për të falur diçka, përderisa e kemi ligjin në Gjykatë Kushtetuese.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues, kryetar, ekzekutiv, kolegë asambleistë, monitorues, përfaqësues të KFOR-it dhe të gjithë ju te pranishëm! Sa i përket çështjes së faljes së tatimit në pronë, si pikë e rendit të ditës, nga praktika që kemi pasur deri më tani, sponsorizuesi e ka tërhequr disa herë pikën e caktuar të rendit të ditës, kështu që po konsideroj se ky mund të jetë direkt vendim i sponsorizuesit të rendit të ditës që një pikë të caktuar të rendit të ditës ta largojë dhe nuk ka nevojë asambleja ta votojë atë pikë të rendit të ditës nëse sponsorizuesi e tërheq. Në anën tjetër, e kemi edhe një propozim shtesë për të njëjtën pikë të rendit të ditës, unë po konsideroj që do të ishte mirë t'i lëmë hapësirë gjykatës kushtetuese dhe kurdo që u falen borxhet, është në të mirë të qytetarëve dhe nuk ka asgjë të keqe e sigurisht se funksionon ajo, duke pasur parasysh se Komuna e Rahovecit, sipas informatës zyrtare, ka arritur t'i grumbullojë të gjitha borxhet në bazë të parashikimit që kanë, po konsideroj që ndoshta po të ndodhte një vendim i tillë prej 5 apo 6 muajsh, do të kishte pasur efekt, sepse kanë qenë borxhet e parealizuar, mirëpo tani borxhet i kemi të realizuar dhe kemi rrethanë tjetër. Po ashtu, edhe një kërkesë miqësore për secilin, të mos reflektohem shumë prej qëndrimeve të nivelit qendror, sepse mund ta bëjmë mishmash asamblenë komunale, kështu që duhet të jemi më të përmbajtur që të mos t'i bëjmë opozitë qeverisë edhe mos t'i bëjmë pozitë qeverisë, por të sillemi si ekzekutiv, si asamble, konform rrethanave tona që i kemi në shërbim të qytetarëve, për atë edhe për çka jemi të thirrur. Pra, kërkoj mirëkuptimin tuaj që le të mbetet për një seancë të radhës, pa dashur që të diskutohet edhe gjatë, gjithashtu edhe pa tentuar t'i ndërhyjmë ekzekutivit në kompetencat e veta. Pastaj, si çështje tjetër që desha ta ngre në rendin e ditës është që propozim - vendimi për dhënien e lejes për kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore për rastin Orllati, po e konsideroj që për Asamblenë Komunale është shumë e rëndësishme të ketë informata më plotësuese dhe jo vetëm një propozim-vendim, si informata shtesë, si parashihet, jo në detaje, por vetëm si informatë që asambleistët të dinë cila është korniza e objektit, sa kate do të ngritët, rreth kapacitetit e bile nuk do të ishte keq që të ketë edhe një kopje të marrëveshjes që e ka bërë kryetari i Komunës me kompaninë Orllati, e cila është bërë në bazë të një vendimi që Asambleja Komunale i ka lejuar kryetarit të Komunës apo e ka autorizuar kryetarin e Komunës për të bërë një marrëveshje me fondacionin Orllati, për ta ndertuar shtëpinë për persona të moshuar. Pra, është shumë e rrugës që ta informoni plotësisht Kuvendin rreth çështjes së Shtëpisë për qëndrim për persona të moshuar, gjithashtu edhe rreth marrëveshjes edhe rreth kornizave mbi objektin, sepse do ta votojmë edhe mbi bazën se si ai do ta ndërtojë objektin. Po ashtu, kryesues, e kam edhe një pikë shtesë sa i përket rendit të ditës, nuk po e kujtoj saktësisht numrin e vendimit, por po propozojmë që të ketë plotësim-ndryshim të vendimit mbi themelimin e Komitetit për Komunitete, e në këtë rast, në bazë të një marrëveshjeje gjentëlmene që e keni pasur dikur grupet e asambleistëve, ku LDK-ja e ka pasur anëtarin e Komitetit për Komunitete nga radhët e VV-së, mirëpo për shkak të ndryshimit të rrethanave, gjejmë mirëkuptimin që LDK-ja heq dorë nga anëtari i Komitetit për Komunitete dhe si e tillë po propozoj që të kemi propozim-ndryshim të vendimit dhe të caktohet një anëtar tjetër në Komitetin për Komunitete. Ne kemi mundur të bëjmë edhe në mënyrë individuale dorëheqje anëtari për të zgjedhur një anëtar tjetër, mirëpo, për hir të transparencës, po provojmë të jemi sa më të hapur në këtë

çështje dhe gjithashtu po e rekomandoj kryesuesin që pikat e rendit të ditës pastaj të votohen një nga një, këto që janë plotësim, shtesa e jo të votohen në pako.

Kryetari – Faleminderit Burim, pasi është një reflektim i situatës reale në të cilën gjendemi dhe jam dakord që të jemi të ekuilibruar edhe në raport me qeverinë qendrore, pasi nuk e kisha personale për mllef, mirëpo edhe assesi nuk duhet të mbrohet pasi ne jemi në Kuvendin e Komunës. Unë qysh tani do të ju jap disa informata themelore sa i përket fondacionit Adrian Orllati e që e udhëheq Micheline Calmy Rey. Unë e falënderoj Kuvendin e Komunës që e ka pranuar shpejt dhe Ministrinë e Pushtetit Lokal që na ka mundësuar për ta trajtuar ligjshëm dhe për ta konsideruar të ligjshëm vendimin e Kuvendit të Komunës. Sa i përket planit të vjetër zhvillimor, që i ka skaduar afati, pasi i ka kaluar mbi 10 vjet dhe në zonën ku po flasim, aty ku e ka marrë fondacioni “Adrian Orllati”, lejohet vetëm P+2, për shkak se objektet përreth, në perimetrin 50 metra, nuk ka objekte më të larta dhe në këtë rast ne nuk kemi hapësirë që t’ia lejojmë vetëm P+2, për shkak se sipërfaqja nuk është e madhe, për shkak se bëhet fjalë për më shumë banesa për të moshuar, si dhe për shkak se bëhet fjalë edhe për trajtimin e atyre banorëve që jetojnë aty. Prandaj, etazhiteti, kanë kërkuar P+4, pra nëntoka, plus 4 kate dhe gjithashtu projektin e kanë sjellë dhe është menduar që të fillojë më 1 shtator dhe gjithçka për fillimin e saj është gati. Nuk duhet të harrojmë se ne nuk mund t’i japim leje nëse nuk e kemi hartën zonale dhe gjithashtu edhe PZHK-në ende nuk e kemi të miratuar, ku në hartë zonale e kemi të paraparë P+6 dhe ne duhet që ta pajisim me leje së pari dhe argument tjetër është se është projekt humanitar dhe ne duhet që ta aprovojmë me vendim të Kuvendit, për shkak të karakterit humanitar dhe të bamirësisë, mirëpo opsioni më i mirë është të presim hartën zonale edhe pse harta zonale është gati si dokument, mirëpo ende kemi vonesa në dy ministri për PZHK-në dhe ndoshta në këtë javë do të kryhet sa më shpejt që të jetë e mundur. Kështu që e ftoj Kuvendin e Komunës që ta fusë në rend të ditës, që të nisë ndërtimi sa më shpejt dhe të pajiset me kushte ndërtimore dhe pastaj me leje ndërtimi. Arsye pse nuk e kemi futur më herët është pasi kemi menduar se po kalon PZHK-ja dhe të tjerat, mirëpo ende jemi larg dhe nuk mund ta presim dhe nuk duhet ta ndërldhim miratimin e PHZK-së me ndërtimin e objektit, pasi edhe këtu ka afate, pasi edhe MAPL-ja na ka treguar në ligjshmëri se brenda kësaj periudhe ata duhet ta nisin ndërtimin. Kështu që ju falënderoj për mirëkuptimin dhe qëndrimin e arsyeshëm konstruktiv dhe argumentues, pasi ndonjëherë na vijnë disa situata që na vijnë pika që duhet t’i fusim apo t’i heqim dhe sa për informatë, në KPF nuk ka qenë pika e faljes së tatimit në pronë, mirëpo pasi u krye mbledhja ka menduar ta fusë, ndoshta drejtori i Financave, se kemi një vendim, edhe pse nuk ka qenë në rendin e ditës, atëherë jemi marrë vesh që ta lëmë për mbledhje të kuvendit, pasi në mbledhjen e KPF-së nuk është biseduar për faljen e tatimit në pronë, atëherë kemi dashur ta respektojmë KPF-në, pasi kemi pasur mundësi që mos ta fusim hiç. Kështu që, edhe njëherë, ju them se nuk ka vend për politikë këtu, pasi jemi në situatën e tillë pasi qeveria na ka vënë në pozitë të palakmueshme, pasi në këtë rast ne e kemi dorëzuar edhe buxhetin, pasi projektet janë të planifikuara, sepse të dhënat nuk mund të hyjnë në sistem kur të duam ne, pasi ne nuk mund të jemi subjekt i auditimit të jashtëm, por edhe i prokurorisë, për moszbatim të projekteve që janë të planifikuara me të hyra. Kështu që, ju ftoj edhe njëherë që të largohet pika për falje të tatimit në pronë dhe ne si sponsorizues e tërheqim këtë pikë dhe të rikthehet Draft- statuti për Ansamblin, që besoj që të gjithë e kanë të qartë për çfarë po flasim dhe gjithashtu të rikthehet në rend dite pika për fondacionin “Adrian Orllati” dhe gjithashtu propozimi i asambleistit Burim Krasniqi për plotësim-ndryshimi të Komitetit për Komunitete dhe gjithashtu edhe ndonjë çështje tjetër mund të merret vendimi sot, pasi nuk ka nevojë për dorëheqje për shkak se vonesat po na marrin shumë kohë.

Burim Krasniqi – Nuk e kontestova nevojën e nxjerrjes së këtij vendimi apo ta fusim, apo mos ta fusim në rend të ditës, edhe pse jemi pro futjes në rendin e ditës, pasi në asnjë moment nuk e kemi kontestuar, pasi disa herë e kam thënë publikisht dhe do ta them edhe tani, pasi sa herë që është në interesin e qytetarëve, LDK-ja do të jetë gjithmonë që do të përkrahë proceset, pavarësisht mospajtimeve në tema të caktuara. Por në rastin konkret, po

besoj që nuk është e rëndë që Drejtoria e Urbanizmit të na sjellë ndërkohë një informatë pak më plotësuese rreth kësaj çështjeje, sepse do të jetë më në rregull kur asambleisti është i informuar për diçka që po voton edhe sigurisht se arsyetimi do të jetë kuptimplotë për atë që është votuar.

Dëfrim Kafexhiu – Faleminderit kryesues, përshëndetje edhe njëherë për te gjithë. I nderuar kryesues, e di që është fillimi i mandatit dhe i mbajtjes së këtij pozicioni për ty, por unë ju këshilloj që të konsultoheni më shumë me rregulloren e punës së Kuvendit që nuk bën të veprohet me standarde të dyfishta mbi standarde të dyfishta në seanca të Kuvendit Komunal. Unë e kërkoja fjalën për çështjen për te cilën ishim duke diskutuar dhe po i jepni fjalën dikujt tjetër që po e diskuton një çështje krejt tjetër dhe me rregullore specifikohet që përderisa nuk shtjerret një çështje e rëndësishme, sepse ishim duke diskutuar një çështje të rëndësishme. Kështu që përderisa nuk shtjerret debati gjatë seancave të Kuvendit Komunal, atëherë nuk bën të ndryshohet kahja apo rrjedha e seancës. Përndryshe, prapë po e them se po tërhiqet pika nga rendi i ditës dhe propozimi im qëndron, por kryetari nuk po konsultohet me asamblenë komunale dhe po pret që Ministria e Financave të konsultohet me Komunën. Kështu që, kryetari, nëse dëshiron të konsultohet me Asamblenë Komunale, atëherë duhet që ta lërë pikën e rendit të ditës dhe po e diskutojmë më pas, qysh të votohet do të jetë problem i anëtarëve të kuvendit. Por, në këtë rast, dua që të ju përkujtoj se kryetari, bashkë me Aleancën në Rahovec, për herë të parë e kanë këtë mundësi për faljen e borxheve të tatimit në pronë dhe e kanë mundësinë të bëjnë diçka për qytetarët e lodhur të kësaj komune, por, gjithashtu, edhe ju asambleistë të Aleancës, e keni mundësinë prej fillimit të këtij mandati të bëni diçka për këta qytetarë, pasi absolutisht asgjë deri më tani nuk keni bërë. Me këtë vendim të kuvendit, qytetarët e rënduar e kanë mundësinë ta vërejnë dorën dhe ndihmën e Komunës, për shkak se prej fillimit të pandemisë, periudhën postpandemike, krizën ekonomike, inflacionin, kryetari Komunës, gjithëherë është arsyetuar në mungesën e kompetencave për të ndihmuar qytetarët e Komunës. Pra, kryetar, tani e ke mundësinë, mirëpo, siç po shihet, nuk e ke vullnetin, ashtu siç nuk e ke vullnetin që asnjë punë ta bësh si duhet për qytetarët e Komunës sonë. Edhe te çështja e penalizimit të Komunës nga kjo falje, nuk është aspak e vërtetë, për këto arsye që po i jep kryetari, pasi borxhi i tatimit në pronë që qytetarët ia kanë Komunës është shumë i madh, pasi kjo falje prej 100 euro për vitin 2023, nuk luan asnjë rol në të hyra, pasi edhe ashtu, drejtoria, për ta lëshuar vërtetimin e tatimit në pronë, po i obligon qytetarët për të paguar, qysh e tha kryetari me herët se kanë shfrytëzuar çdo mekanizëm të mundshëm që të inkasojnë borxhin e tatimit në pronë dhe rrjedhimisht janë rritur edhe të hyrat vetanake dhe u plotësua pritshmëria për vitin 2023. Po ashtu, kryetari e ka futur Komunën në borxhe aq shumë, sa që edhe nëse janë 600,000, asgjë nuk ka dallim, pasi edhe në vitet e kaluara, siç e thashë edhe më herët, se nuk janë falur borxhet dhe asgjë nuk është bërë për qytetarët, kështu që unë mendoj se nuk do të ketë asnjë dallim nëse falen këto borxhe dhe gjithashtu qytetarët duhet ta dinë se pak muaj më parë dhe nuk duhet që ta harrojnë se ky kryetar u ka falur borxhe bizneseve dhe jo një pjesë të tatimit në pronë të qytetarëve dhe kjo falje e borxheve bizneseve është për shkak të paaftësisë së inkasimit të këtyre borxheve, por e ka gjetur mënyrën për të inkasuar të hyra vetanake dhe të tatimit në pronë, edhe po vazhdon kështu dhe gjithashtu po refuzon që të diskutojë fillimisht, por edhe të miratojë një vendim për faljen e borxheve për shumën 100 euro për vitin 2023 prej tatimit në pronë, kështu që, kryetar, duhet që ta hapësh zemrën, pasi edhe dy vjet e kryen mandatin edhe sigurisht se do të kujtohesh për të mirë që ta kanë parë hairin pak qytetarë, si kryetar, pasi kështu shkon pa u kujtuar për të mirë edhe gjithashtu edhe ju si grup i Aleancës duhet te veproni ashtu, e posaçërisht ju Hasan Përboqi, nuk keni nevojë të jeni zemërgjerë me lëvizjen Vetëvendosje, por zemërgjerësinë duhet ta shprehni me qytetarët e Komunës së Rahovecit. Edhe njëherë, propozimi im qëndron e njëherit ftoj të gjithë anëtarët e grupeve politike në kuvend që ta mbështetni këtë propozim dhe ta miratojmë vendimin për faljen e borxheve të tatimit në prone për vitin 2023.

Kryesuesi – Faleminderit i nderuar anëtar i kuvendit, z. Defrim Kafexhiu, sa i përket rregullores, e kam lexuar dhe e përcjell me vëmendje, por kam një vërejtje për ju, pasi fjalën e merrni, mirëpo minutazhën e kaloni dhe në shenjë respekti për të drejtën e fjalës që po e thoni, minutazhën po e kaloni.

Kryetari – Për dijeninë e të gjithëve, kryetari ka të drejtë sa herë që atakohet dhe nuk është njëjtë si me asambleistë si me kryetarin. E para që dua të them është se dikush ka qëndruar kryesues një vit e gjysmë edhe nuk i ka kuptuar disa gjëra sa i përket punës së Kuvendit. Sponsorizuesi ka të drejtë kur të dojë ta largojë pikën, edhe pse të tjerët mund të vazhdojnë të mbajnë qëndrime, mirëpo nuk është në rendin e ditës, pasi vetëm e kemi futur edhe vetë e largojmë dhe kjo është kompetencë e kryetarit, sigurisht që e dini këtë. Pra, jam sponsorizuesi dhe në këtë rast e sponsorizoj pikën e rendit të ditës dhe sa i përket kësaj, nuk ka debat për këtë, pasi ia kam dhënë mundësinë kuvendit të debatojë dhe cilat janë arsyet se nuk dua ta lë në rend të ditës dhe sigurisht se i kam respektuar qytetarët dhe nuk ka mundësi që dikush, me një numër të vogël të votave, mundohet t'ua tregojë detyrat e shtëpisë atyre që kanë shumicën e votave. Kështu që, deri sa do të jem kryetar i Komunës, ju siguroj sa u takon qytetarëve, e di secili për secilin, pastaj sa kujdesem për qytetarët dhe kujt ua falim ne borxhet, siç e thashë edhe me herët, pse dikush nuk ka mbërri t'i kuptojë gjërat elementare sa ka qëndruar kryesues dhe sigurisht se do ta ketë vështirë t'i kuptojë për shkak të ideologjisë së ngushtë politike. E para, ne u kemi falur borxhe bizneseve në Komunë fiktive pasi ka afate të cilat janë të rregulluara me ligj si për taksa afariste, taksa në qira dhe nuk u kemi falur borxhe bizneseve ruse apo kineze, por bizneseve tona të cilat operojnë në Komunën tonë. Pastaj, unë, qytetarët e Komunës, nuk i trajtoj me interesa të ngushta, por i trajtoj realisht dhe aq sa kam kompetenca dhe aq sa ne kemi kompetencë, veprojmë. Po ashtu, tatimi ne ponë është obligativ dhe nuk duhet që ta harroni këtë fakt, pasi tatimi në pronë është detyrim ligjor, prandaj edhe nëse paguhet me kohë, atëherë kamatat rriten, pasi ne kemi borxhlinj të tatimit në pronë që kanë edhe 5000 e ndoshta edhe 10,000 euro dhe i kemi dërguar te përmbaruesi edhe ndoshta edhe i kemi programuar borxhet, që është krejt normale, pra mos i ngatërroni taksat afariste, taksat për biznese, taksat në qira, sepse janë edhe ata qytetarë, sikur këta të tjerët, kurse tatimi në pronë është tatim obligativ dhe i rregulluar me ligj dhe i vetmi tatim obligativ është tatimi në pronë. Kështu që, edhe njëherë ju them se kjo nuk vlen, pasi tërhiqet nga rendi i ditës, pasi sponsorizuesi e tërheq edhe pse nuk e ka futur në rend të ditës, pasi sot e kam kuptuar se si është futur në rend të ditës dhe rreth asaj se a ka pasoja juridike apo nuk ka, për këtë përgjigjet kryetari i Komunës e jo asambleistët. Pasi, nëse ne prodhojmë efekte juridike për moszbatimin e këtij vendimi, atëherë këtu jam dhe sigurisht se do të jem përgjegjës deri sa do të jem kryetar i Komunës dhe nuk i frikësohem, pasi i respektoj ligjet tona dhe konflikt me ligjin, deri më sot, nuk kam pasur asnjëherë, kurse me ligjet e okupuesit kam pasur vazhdimisht. Pastaj, nuk kemi nevojë të bëjmë politikë aksidentale, pasi ai që do të merret me politikë, duhet të ketë një respekt, pasi këtu nuk flas si emër i përveçëm, por flas si kryetar i Komunës, pasi reflektoj një pozicion të qartë. Pra, nëse ne kemi kontest me këtë ligj, atëherë e kemi dërguar në Gjykatën Kushtetuese dhe nuk ka vend për polemika se kush ka bërë më shumë për qytetarët. Pra, mundësi për të dhënë kontribut për të mirën e qytetarëve të Komunës ka edhe pa qenë kryetar i Komunës, apo asambleist në kuvendin komunal. Pra, siç e tha edhe Burim Krasniqi, prandaj e vlerësova me objektivitet dhe me respekt, pasi ai që e ka sponsorizuar edhe e tërheq nga rendi i ditës, dhe gjithë këtë debat e bëra për respektin ndaj juve pasi ka qenë në rendin e ditës pas mbledhjes së KPF-së dhe jemi marrë vesh me shefin e sekretariatit, Skender Hamza, që kjo pikë e rendit të ditës hiqet dhe arsyet e heqjes shpjegohen në Kuvend, mirëpo, ky debat na ka shërbyer të diskutojmë edhe të shohim ku jemi edhe çka jemi. Unë mendoj se interesin qytetar duhet ta trajtojmë më ndryshe dhe mbështetja duhet të jetë më ndryshe, pasi falja prej 100 eurosh nuk është që e respekton edhe aq shumë qytetarin dhe nuk duhet të lejojmë që institucionet tona ta trajtojnë qytetarin me njëfarë mëshire. Pra, jemi pro faljes, jo vetëm të 100 eurove, por të të gjithë borxhit, por sigurisht se duhet ta rimbursojë Komunën. Edhe njëherë e ftoj Kuvendin e Komunës që kjo pikë e rendit të ditës, si sponsor i kësaj pike, e tërheq nga rendi i ditës dhe rreth kërkesës se asambleistit Burim Krasniqi, ju zotohem se

do të sjell informatën dhe sigurisht edhe projektin me elemente themelore në seancën e ardhshme, pasi ka projekt ideor dhe detal, ku dihet sa është numri i banesave, numri i banorëve dhe këtë informatë, drejtori i Urbanizmit, e sjell në seancën tjetër, pra si informatë zyrtare. Gjithashtu edhe kërkesa tjetër për Komitetin për Komunitete futet si pikë në rendin e ditës dhe gjithashtu rikthehet pika e draft-statutit për ansamblin.

Sinan Kryeziu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit! U detyrova ta marr fjalën për arsye se këtu u fol për propozim për faljen e borxheve dhe meqenëse ligjet i nxjerr parlamenti e jo asambleja, kështu që këtu më shumë e konsideroj se më shumë është popullizëm, për arsye se konsideroj se Komunën e mban tatimi edhe nuk është e drejtë të falen borxhet në tërësi, sikur ai që është në kushte financiare të mira e sikur ai që është në kushte më të dobëta dhe kur e them këtë ju arsyetoj nga ana ligjore, pasi të liruar nga tatimi i përcakton ligji, njerëzit që janë me skema sociale apo njerëzit me aftësi të kufizuara psikike mentale. Këtu u tha se u bë popullizëm me një arsyetim që janë falur borxhet e firmave dhe unë ju them sa për informimin e qytetarëve se në momentin që nuk ishin falur këto borxhe, atëherë këto borxhe menjëherë parashkruhen dhe në momentin që parashkruhen, Komuna, në këtë rast, do të bënte propozim për përmbarim dhe këtë rast borxhliu do të kishte bërë prapësim në përmbarim, do të ishte thirrur në Ligjin për parashkrimin e borxhit, sipas afatit ligjor. Po ashtu, ju përkujtoj se i kishin humbur të gjitha kontestet edhe kishin krijuar shpenzime procedurale. Më kujtohet kur isha pjesë e Vetëvendosjes, në planprogram e ka pasur shumë për qytetaret edhe më kanë bindur pse unë isha aty, ku pjese e planprogramit ishte shteti social, shteti zhvillimor, banka zhvillimore dhe fondi sovran. Nga ana ligjore, në këtë rast, nuk duhet të falen borxhe nga tatimi në pronë, por duhet të veprohet ashtu siç kemi premtuar në fushatë, që të krijojmë fondin sovran, kështu që, pa keqkuptime, shumica nuk e dinë se çka është edhe fondi sovran, ku me fond sovran, në mënyrë direkte e rimbursen qytetarin e jo të thirret me popullizëm që të nxjerrin ligjin për falje të tatimit në pronë, kështu që konsideroj që ne nuk jemi këtu të falim borxhe apo të nxjerrim ligjin, pasi ne nuk nxjerrim ligje por ne nxjerrim vendime dhe përgjegjës për nxjerrjen e ligjeve është parlamenti, ku u shpjegua nga dy parafolësit, në këtë rast kryetari Smajl Latifi dhe Burim Krasniqi, bashkëvendësi im, kështu që ne e presim Gjykatën Kushtetuese dhe ligjet i nxjerr Parlamenti e jo Kuvendi i Komunës.

Ilir Pallqa – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Te vendimi për dhënien e lejes për kushte ndërtimore dhe lejes për ndërtim, unë pak a shumë i lexova këto nenet e ligjet, mirëpo jam konfuz, pasi nuk e di ku e kemi atë të drejtë ne që ta bëjmë këtë ndryshim, duke e ditur që me PZHK-në pastaj na vjen vendimi, por pasi po na jepet kjo e drejtë, pse mos ta bëjmë P+8, vetëm si pyetje e parashtroj, pasi ai mund të kërkojë P+8, kurse ta bëjë P+4 pse nuk e ka kërkuar.

Albnor Mullabazi – Faleminderit kryesues, të nderuar asambleistë! Sa i përket pyetjes për dhënien e lejes për kushte të lejes ndërtimore, kërkesa prej fondacionit është P+4 dhe në bazë të ligjeve që i kemi dhe tani jemi duke shfrytëzuar zonën 50 metra që e përdorim ligjin, aty kemi objekt përdhese, plus dy kate dhe aq është mundësia e lëshimit deri sa të dalë harta zonale, ku në atë pjesë është e planifikuar P+6 dhe ne po kërkojmë një vendim prej kuvendit, në bazë të të cilit, Drejtoria për Urbanizëm, mund të mbështet të leshojë leje edhe kushtet P+4, ashtu siç është kërkuar prej fondacionit.

Drilon Mustafa – Përshëndetje për të gjithë! Desha të ndërlihem te diskutimi i Ilir Pallqës, prita që po pyet se sa do të jetë ISN-ja, apo diçka tjetër, pasi taragjiteti nuk është shumë me rëndësi, pasi drejtori paraprakisht e tha se PZHK-ja e ardhshme parashihet të jetë P+6, kështu që një pyetje më logjike edhe më thellë ndoshta, kisha pritur prej Merisës dhe jo nga ju, se sa do të jetë ISN-ja apo shfrytëzimi i tokës, pasi metarzhuteti nuk është shumë me rëndësi.

Kryesuesi – atëherë meqë nuk kemi të tjera diskutime, vazhdojmë me pikat e propozuara që t'i kalojmë në votim. Pikat e propozuara janë që të rikthehen në rend të ditës: **Shqyrtimi i Draft - statutit të Ansamblit të Komunës së Rahovecit**. E hedhim në votim, me 20 vota pro, kjo pikë e rendit të ditës rikthehet edhe njëherë në

rend të ditës. Pastaj, pika tjetër e propozuar e sjellë nga Drejtoria e Urbanizmit: **Dhënia e lejes për kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore për fondacionin “Adrian Orllati”** - E hedhim në votim. Me 21 vota për, kjo pikë futet në rendin e ditës. Po ashtu kemi edhe një pikë tjetër të propozuar: **Vendimi për plotësimin e ndryshimit të vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete**, e datës 25.01.2022 të propozuar nga asambleisti Burim Krasniqi. E hedhim në votim. Me shumicë unanime të votave, kjo pikë futet në rendin e ditës. **Kryesuesi** – I nderuar anëtar i kuvendit komunal, z. Defrim Kafexhiu, a i qëndroni ende propozimit tuaj për rikthimin e pikës së dhjetë?

Defrim Kafexhiu – Faleminderit, kryesues, po, i qëndroj propozimit.

Kryesuesi – Atëherë e hedhim në votim pikën e dhjetë të rendit të ditës: **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për faljen e borxhit mbi tatimin në pronë**. Të nderuar anëtarë të kuvendit, nuk kalon propozimi i z. Kafexhiu. Atëherë lidhur me rendin e ditës, pas diskutimeve të shumta, pikat që ishin dhe ato të propozuara, kalojnë në votim. Me shumicën e votave nga anëtarët e kuvendit, miratohet rendi i ditës për këtë mbledhje.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi - Atëherë, meqë nuk kemi diskutim sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, e hedhim në votim. Me shumicë të votave aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi dhe miratimi i mbledhjeve të jashtëzakonshme të datës 12.07.2023 dhe 17.07.2023.

Kryesuesi - Atëherë meqë nuk kemi diskutime sa i përket shqyrtimit të mbledhjeve të jashtëzakonshme e qesim në votim. Me shumicë të votave kalon edhe pika e dytë e rendit të ditës sa i përket mbledhjeve të jashtëzakonshme.

3. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.

Burim Krasniqi – E para ka të bëjë me drejtorinë e Arsimit, ku pas bisedës që kam pasur me disa familjarë të cilët i kanë fëmijët e tyre semimaturantë më është dukur e arsyeshme ta ngris si çështje, sepse e kam parë edhe si shumë shqetësuese. Këtë vit, sipas një informate zyrtare që kam parë, ku 681 semimaturantë i janë nënshtruar testit të semimaturës. Por, pas një analize që e kam bërë, ku janë 35% të semimaturantëve të cilët nuk e vijnë shkollën e mesme në shkollat e mesme të Komunës së Rahovecit, ku ka edhe drejtime të gjimnazit natyror, shoqëror, përpos profileve profesionale, ku kjo, në njëfarë forme, po e rrezikon pozitën e profesorëve të shkollave të mesme për shkak të rënies së numrit të nxënësve në ato shkolla. Kështu që, si DKA dhe si ekzekutiv, a është menduar ndonjëherë si të ndalet ky trend i vijimit të shkollave të mesme nga ana e fëmijëve tanë në shkollat e mesme jashtë Komunës së Rahovecit, ku tash e kemi edhe shkollën profesionale, e cila ofron direkt specializime specifike në kuadër të shkollave të mesme. Për mua, si Burim, dhe për ne, si LDK, është shumë shqetësuese dhe tash jemi në një vit ku një pjesë e regjistrimit të nxënësve është bërë dhe është faza e dytë, po ju kërkoj që, meqenëse edhe vitin tjetër jeni ekzekutiv, që ta mendoni njëherë e mirë se si mund të ndalet apo të reduktohet ky trend, që të analizoni dhe të bashkëbisedoni me semimaturantët këtë vit dhe me prindërit e tyre, se cila është arsyeja e tyre që e vazhdojnë shkollën e mesme në shkollat e mesme jashtë komunës së Rahovecit. E dyta, kam bërë një pyetje në mbledhjen e kaluar rreth çerdheve, gjegjësisht rreth edukatoreve që do të pranohen në çerdhe. Kjo është mirë që janë pranuar dhe po besoj që konkursi ka qenë në rregull, duke pasur parasysh se ka pasur panel profesional, por sipas informatës që e pashë, nuk ka lidhur Ministria e Arsimit kontratë për furnizimin me inventarë dhe përveç asaj, lënda është në OSHP dhe kjo nënkupton se ky gjysmëvjetor mund të shkojë pa u nënshkruar kontrata, gjegjësisht pa u bërë furnizimi me inventarë për dy çerdhe dhe më pas çka do të ndodhë me këto edukatore që janë pranuar në punë, a do t'u paguhet paga. Gjithashtu, nëse e keni obligim ligjor për t'i paguar pagat, po ju rekomandoj dhe po ju kërkoj mundësinë e shpërndarjes së tyre nëpër çerdhe ekzistuese e në qoftë nevojia edhe nëpër shkolla që të bëjnë punën e tyre me fëmijët parashkollorë, që të lehtësohet puna. Dhe e treta, te arsimi, është çështja e librave për nxënësit e shkollave fillore, një obligim që del nga e drejta e fëmijëve për t'u shkolluar, por një situatë që është komplikuar goxha shumë pas vendimit të fundit të MASHT-it për rimbursimin e mjeteve për prindërit që i kanë fëmijët nëpër shkolla. Por, nga ana e DKA-së dhe e ekzekutivit, nuk kam parë asnjë veprim që e lehtëson

këtë procedurë për prindër dhe, duke pasur parasysh se afati për aplikim është deri më 31 shtator, ku duhet të angazhohen drejtorët e shkollave, të bëhen ekipe dhe gjithashtu t'u mundësojnë prindërve të cilët nuk dinë të aplikojnë në E-Kosova, që të shkojnë nëpër shkollat gjegjëse, që një grup punues ta kryejë aplikimin për ata, pasi kemi shumë qytetarë që kanë vështirësi ta bëjnë këtë punë dhe po ashtu, plot prej tyre që s'janë edhe të regjistruar as në E-Kosova dhe që janë dy procedura që njëherë të regjistrohen e pastaj të aplikojnë për libra. Kështu që, kërkoj mirëkuptimin që të thirren drejtorët e shkollave që të bëjnë nga një grup punues dhe le t'u mundësojnë prindërve aplikimin në shkolla të atyre prindërve që nuk kanë mundësi. Pastaj, te Drejtoria e Bujqësisë, kemi diskutuar disa herë si grup i asamblesë së LDK-së rreth çështjes së kompensimit të dëmit të shkaktuar për bujqit tanë dhe ndër ta kemi rastin e vitit të kaluar nga dëmtimi nga breshëri, kështu që kërkoj nga drejtori i Bujqësisë që të na japë një informatë në seancën e radhës, ose edhe me shkrim, që të na dërgojë nga një email të gjithë asambleistëve se çka ka ndodhur me rastin e Bahtir Morinës, nga fshati Vrajakë, ku i ka pasur 2.2 hektarë specatë mbjellë, të cilit ia ka dëmtuar breshëri, kur të gjithëve u janë kompensuar, ata që janë rreth tij, kurse atij nuk i janë kompensuar. Dhe informatën që e kam është se nuk është faji te Ministria e Bujqësisë, por gabimi është në Komunën e Rahovecit, sepse kanë dalë parcelë tjetër e dikujt, ia kanë ngatërruar edhe fotografitë, kështu që Komuna e Rahovecit ka bere një lëshim ku i ka pamundësuar qytetarit Bahtir Morina të realizojë të hyra për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga breshëri. Pra, nuk po kërkoj sot, mirëpo pres ndërkohë që Drejtoria e Bujqësisë të na japë informatën e plotë rreth këtij rasti. Edhe shqetësimin e fundit që desha ta ngris në emër të grupit të LDK-së, është te Dëgjimet Buxhetore, ku i kam përcjellë me vëmendje, ku nuk kam marrë pjesë vetë në Xërxë, mirëpo është fakt që Dëgjimet Buxhetore po e kryejnë një obligim ligjor, por kryetar, këto dëgjime vërtet janë shumë të zbehta pasi, të shkosh në Krushë te Madhe e t'i kesh edhe gjashtë fshatra të tjera dhe të marrin pjesë 12 persona, kjo për mua është e papranueshme dhe po ju kërkoj që të shihni se pse po ndodh kjo, a janë të pakënaqur qytetarët me diskutimet publike, me formën e komunikimit, apo ku qëndron problemi se pse qytetarët e komunës së Rahovecit nuk marrin pjesë në dëgjimet publike dhe kjo nuk ka ndodhur vetëm në Krushë, pasi këtë situatë e ke edhe në Xërxë edhe pothuajse në të gjitha vendbanimet ku janë mbajtur Dëgjimet Buxhetore, ndoshta pak më mirë del kur mbahen në sallën e kuvendit komunal në Rahovec, pasi vijnë disa të ekzekutivit dhe po duket pak më mirë, përndryshe është shumë e zbehtë.

Ilir Pallqa – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë asambleistë, drejtorë të drejtorive dhe të gjithë të pranishmit në sallë! Po flas rreth rrethrotullimeve në qendrat më të mëdha të komunës, ku në qytet e kishim njëfarë rrethi, i cili krijonte njëfarë harmonie të qarkullimit dhe tani u krijua konfuzitet total në qarkullim e sidomos në sezonë. Pastaj, në Xërxë, aty ku është shumë e nevojshme, nuk kemi rrethrotullim, i cili është diskutuar disa herë në pjesën qendrore, pastaj në Krushën emblematiche të Kosovës është për marre dhe ne kur hyjmë aty, përshtypja e parë që na krijohet është një fshat i zakonshëm i Kosovës dhe nuk bën asses ta kemi këtë përshtypje në Krushë, po flasim për ata që shkojnë më rrallë, pra te rrethi në Krushë, duhet të bëhet diçka më e bukur, një simbolikë më e veçantë për të treguar madhësinë e vendit sadopak, pasi nuk kërkon shumë kosto rregullimi i atij rrethi, edhe pse mund të arsyetohet me hapësirën e vogël, por kjo nuk qëndron, pasi në shumë vende të botes kemi shumë rrethe të vogla që kanë simbolika të veçanta dhe që mund të bëhen edhe bukur. Pastaj është rrethrotullimi në Ratkoc, ne jse aty është pak më i mirë.

Hasan Përboqi – Faleminderit kryesues, të dashur qytetarë të Rahovecit, Kosovës dhe të çdo treve shqipfolëse. Po e shfrytëzoj këtë pikë të rendit të ditës për ta uruar dhe përshëndetur fillimin e festivalit të rrushit dhe të verës Hardhfest, që mbahet si zakonisht në konak të Rahovecit, i cili fillon më 1 shtator dhe vazhdon deri më 3 shtator. Ky festival shënon edhe zyrtarisht fillimin e sezonit të vjeljes së rrushit edhe pse sikurse në vitet e kaluara, vreshtarët e bujqit rahovecian ballafaqohen me sfida nga më të ndryshmet, por prapë ata gjejnë forcë e kurajë që së bashku me këshillin organizativ të kontribuojnë në organizim sa më të mirë të këtij festivali. Zanafilla e organizimit të këtij festivali daton qysh herët, duke kaluar ndër vite e duke u rritur si festival, deri sa në vitet e fundit e ka marrë namin e një festivali tashmë ndërkombëtar. Ky festival tashmë është vendosur në agjendat turistike që duhet vizituar nga kompanitë më të njohura turistike ndërkombëtare. Aktivitetet e këtij festivali janë

nga më të ndryshmet por që në qendër të organizimit të tij janë rrushi dhe vera e Rahovecit dhe që janë edhe identiteti i yni si vend. Unë, nga kjo foltore, shfrytëzoj rastin që t'i uroj organizatorët dhe këshillin organizativ së bashku me bujqit dhe vreshtarët për një mbarëvajtje të mirë të festivalit dhe gjithashtu i ftoj për pjesëmarrje në këtë festival të gjithë ata që e shohin këtë adresim, duke uruar që në vitet që vijnë, vreshtarët rahovecian të gjenden në një situatë më të mirë me shitjen dhe plasmanin e rrushit. Kështu që të gjithëve ju them, ejani në Hardhfest "prek n'rrush, shijo n'venë".

Edona Kryeziu – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar dhe të gjithë ju të pranishëm. Shtatori po afron dhe nxënës të shumtë presin të nisin vitin e ri shkollor, e barra më e madhe këto ditë ka rënë mbi prindërit të cilët kanë hallin se si fëmijët e tyre do t'i sigurojnë tekstet shkollore, ku këtë vit furnizimi nuk do të jetë i njëjtë sikur vitet paraprake, pasi këtë herë obligohen që blerjen e teksteve mësimore ta bëjnë vetë. Mirëpo, meqenëse shumë herë nëpër seanca është cekur se komuna është çdo herë në shërbim të qytetarëve, atëherë mendoj se kurrë më shumë qytetarët e Rahovecit, nuk kanë pasur nevojë për ndihmë. Më konkretisht, pyetjet e mia drejtuar drejtorit të Arsimit janë që a ka Komuna fonde shtesë që t'i ndihmojë nxënësit lidhur me furnizimin me tekste shkollore, siç e tha edhe shefi i grupit tonë, mirëpo rreth kësaj po ndërlidhem unë edhe njëherë se a ka formuar komuna jonë ndonjë *task force* apo grup emergjent që do të merren me paraqitjen e problemeve që do të kenë prindërit dhe nxënësit tanë lidhur me platformën E-Kosova, duke ditur që ka prindër që këtë platformë nuk dinë ta praktikojnë dhe fëmijët e tyre mund të mbesin edhe pa tekste shkollore. Dhe, gjithashtu, në fund, kam një pyetje lidhur edhe me eficiencën, nëse një shkollë është në problem me eficiencë, a duhet të jenë edhe drejtorët e shkollave në komision vëzhgues, së paku, sepse, kemi se punëkryesit nuk u japin kurrfarë përgjegjësie drejtorëve.

Lirgzon Kastrati – Faleminderit kryesues, ekzekutiv, anëtarë të kuvendit, qytetarë të Komunës së Rahovecit, medie dhe të gjithë ju të pranishëm. Kam disa pyetje rreth kësaj pike të rendit të ditës, fillimisht me drejtorin e Bujqësisë rreth vlerësimit apo punës së komisionit të Drejtorisë së Bujqësisë në Komunën tonë për dëmet që i ka shkaktuar breshëri, ku kam ankesa nga bujqit e fshatit Hoçë e Vogël, që dikujt i është vlerësuar dëmi e dikujt nuk i është vlerësuar edhe pse në të njëjtin vend ka rënë breshëri, që realisht nuk ka qenë trajtimi i njëjtë për dëmet që u janë shkaktuar nga breshëri. Kështu që duhet që të na informojë drejtori i Bujqësisë se qysh ka ndodhur vlerësimi i dëmeve që i ka shkaktuar breshëri sipas vendimit të komisionit të fundit. Për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, po ashtu, kam një pyetje rreth fushës së sportit, se a është paraparë për Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "Heronjtë e Kosovës", në Hoçë të Vogël, ku në këtë shkollë i vijnë mësimet nxënësit e dy fshatrave Hoçë e Vogël dhe Brestoc. Për Drejtorinë e Ekonomisë rreth listës së aplikuesve të pranuar sipas thirrjes publike për praktikantë me pagesë në partneritetin publiko - privat, ku këta të pranuar në cilat biznese do të punojnë pasi nuk i pashë në rezultatet që i keni shpallur. Po ashtu për Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, pasi drejtoresha nuk është e pranishme, mirëpo edhe si anëtar i Komitetit për Shëndetësi po e shpreh shqetësimin e qytetarëve rreth dhënies së infuzioneve, pasi e di që është vendim i Ministrisë, por disa komuna në QKMF janë duke dhënë e sidomos komuna fqinje, se a ka mundur të diskutojë për këtë çështje rreth shqetësimit të këtyre qytetarëve. Po ashtu për Drejtorinë Shërbimeve Publike kam një pyetje rreth pilot-projektit apo siç e keni potencuar kanalizimet lagjeve dhe të fshatrave, që kanë bërë kërkesë qytetarët e Komunës tonë.

Kryetari – Faleminderit kryesues, unë dua t'i përgjigjem Burim Krasniqit, pasi DKA-ja i përgjigjet rreth asaj çështjeje e po ashtu edhe Edona Kryeziut i përgjigjet sa i takon çështjes që lidhet me librat, pasi unë e kam opinionin tim publik rreth kësaj, pasi e kam shprehur edhe në televizionin KTV, pasi kam folur për këtë temë dhe mund ta merrni edhe aty, pasi i kemi pakënaqësitë tona reale e natyrisht që po shpresojmë se do të ndodhë furnizimi me libra dhe do t'i kushtojë më pak buxhetit të Kosovës se sa sikur të ishin lidhu kontratat me shtëpitë botuese. Burim Krasniqi edhe pse tani nuk është i pranishëm, ka kërkuar një situatë më të qartë për seancën e ardhshme pasi tani drejtorin nuk e kam këtu, pasi është zëvendëskryesues i këshillit organizues për Hardhfest. Ne kemi 214 fermerë që janë kompensuar deri më tani për dëmet e shkaktuara në bujqësi, që gjithsej janë 540 fermerë që janë dëmtuar në shtatorin e vitit të kaluar. Po ashtu kanë vazhduar të dëmtohen edhe këtë vit, tash me udhëzim administrativ, secili fermer që konsideron që i është dëmtuar pasuria, kulturat e tyre, duhet të bëjë kërkesë në Drejtorinë Bujqësisë se përndryshe nuk na pranon Ministria e Bujqësisë edhe shkon komisioni e bën vlerësimin

e dëmeve. Unë jam dakord se mund të ketë edhe ndonjë element subjektiv në vlerësime pasi Lirigzoni e shtroi çështjen e gabimeve, por siç ka subjektivizma lakmi edhe nga fermerët, pasi ne nuk mund të angazhojmë ekspertë të jashtëm në vlerësime, pasi nuk kemi kapacitete as financiare por edhe nuk përfshihen ekspertët e jashtëm, pasi është një kriter që Drejtoria e Bujqësisë, në harmoni me Ministrinë Bujqësisë i ka anëtarët dhe po ju siguroj se anëtarët e komisionit janë të profileve profesionale, të fushës, dhe gjithashtu që merren edhe me ekonomi. Po ashtu ka fermer që thotë se nuk dëshiron t'ia dërgojë një emër të përveçëm në komision, kështu që vlerësimet janë kryesisht objektive dhe ka plot raste kur fermerët vijnë edhe në zyrën time, ankohen dhe kur fillojnë ballafaqimet del që ka edhe ndonjë fermer, p.sh. prej 3200 fermerëve, sigurisht se nja 100 janë që dëmet i kanë shkaktuar vetë dhe tenton që t'i thonë komisionit që t'ia vlerësojë dëmin e shkaktuar nga vetë ai. Për rastet e tilla kemi marrë masa dhe i kemi lutur që të mos vazhdojnë ashtu dhe të jenë të përgjegjshëm në të ardhmen që të krijojnë aso mashtime pasi faktet janë fakte dhe njerëzit e dinë. Te rasti i fermerit Bahtir Morina, siç ju thashë edhe më herët se 214 fermerë janë trajtuar, ndërsa të tjerët nuk janë kompensuar ende, kështu që vendimi i komisionit për dëme ekziston dhe raportet janë të miratuara dhe neve na kanë mbetur edhe 70-të që nuk janë pranuar në listë që lidhen me rastet e dyshimta të fotografive të cilat realisht nuk varen prej komisionit por varen edhe prej situatës në të cilën është gjendja e parcelës edhe sigurisht përkushtimit edhe evidentimit që ia ka bërë vetë fermeri. Kemi pasur aso situata që fotografitë e një prone kanë shkuar për një pronë tjetër, por nuk duhet të harrojmë se ne kemi situata kur 5 hektarë janë vërsuar në ujë, mirëpo aty janë mbi dhjetë pronarë dhe është e pamundur të bëhen fotografi dhe të identifikohen kur është ujë krejt, kështu që kemi pasur edhe këso situata të tilla, të cilat në masë të madhe janë tejkaluar, mirëpo vetëm 70 fermerë kanë mbetur dhe jemi duke u marrë me FAO-n, pra Organizata Botërore e Ushqimit që është një projekt që po dëshiron t'i mbështesë fermerët e dëmtuar nga breshëri dhe reshjet e shumta. Edhe njëherë po e potencoj që Qeveria e Kosovës duhet ta fusë në rend të ditës, pasi ne kemi prapë një përgjigje nga komisioni i dëmeve se lënda për dëmet në bujqësi, për kompensimin e dëmeve është në qeveri dhe i mbetet qeverisë ta fusë në rend dite dhe të marrë vendime, por edhe kjo për kompensimin e dëmeve në amvisëri, ekonomi familjare por edhe dëme të tjera që janë bërë në biznese. Qeveria ka dhënë një sinjal që do ta fusin në rend të ditës, mirëpo ende nuk e ka bërë një gjë të tillë, mirëpo unë e kam në plan t'i drejtohem kryeministrit dhe zëvendëskryeministrit, ministrit të Pushtetit Lokal dhe Qeverisë se a kemi ndonjë mundësi të shpejtë që ta fusim në rend dite dhe t'i sqarojmë qytetarët, pasi rreth kësaj kërkesë ata adresohen te ne. Pra, rreth kompensimit të dëmeve, janë miratuar raportet, mirëpo ne po e presim vendimin e Qeverisë. Rreth Dëgjimeve Buxhetore, nëse bëjmë krahasimet, numri i pjesëmarrësve në Dëgjime Buxhetore në vitin e kaluar është më i vogël sesa në këtë vit, mirëpo sigurisht se totalisht jam i pakënaqur rreth kësaj çështjeje. Por, kur flitet për debate publike, për shqyrtime publike edhe kur është prezent kryetari Komunës, zakonisht vijnë më shumë, kurse kur bëhet fjalë për dëgjime buxhetore edhe kësaj radhe, edhe përkundër fushatave dhe përsëritjes së thirrjeve, por prapë nuk jam i kënaqur rreth kësaj edhe kjo ishte dukuri pothuajse në të gjitha vendbanimet e po ashtu edhe në qytet, kurse për takimet me OJQ-të që po mbahen, po vijnë më shumë. Kështu që ne do të shohim për ndonjë modalitet në bashkëpunim me të tjerët se si mund ta rrisim numrin e pjesëmarrësve. Sa i përket pyetjes se në cilat biznese do të punojnë praktikantë, sigurisht se do të japë përgjigje drejtori i Ekonomisë, z. Erhan Morina, por ne veç kemi një zotim edhe nga bizneset që 150 euro ne si Komunë i paguajmë, kurse shumën tjetër e bëjnë bizneset, por sigurisht se nën një shumë 150 euro, bizneset, nuk do të lejohet që të bëjnë pagesën, prandaj 36 aplikantë brenda pak muajve do të akomodohen nëpër biznese. Te çështja e infuzioneve, për mua çështja shtrohet pse duhet të kufizohen infuzionet, pasi ka një traditë dhe njerëzit nuk po e kuptojnë, pasi me njëfarë vendimi nuk lejohet të jepen infuzione. Ne kemi biseduar edhe me zëvendëskryeministrin e Shëndetësisë që të ketë mundësi të bëhet një dhome e trajtimit të veçantë ditor ku mund të jepet eventualisht edhe ndonjë infuzion, pasi ne tash kemi anomali, pasi ata mjekë që nuk lejohet të japin aty infuzione, atëherë nuk jemi të sigurt se a japin infuzione në ordianca private. Kështu që mendoj se dhe një kohë duhet të jepen infuzione deri sa të krijohen edhe të ndërrojnë parametrat e gjendjes morale dhe psikologjike të qytetarët. Pra, jam edhe mendoj se dinë të japin infuzione dhe ka kapacitete të japin infuzione, por ka barrierë ligjore. Pastaj, te çështja e rrethrotullimeve, ku në qendër e kanë paraparë profesionistët ta largojnë atë rrethin e vogël për shkak të hapësirës së kufizuar, pastaj te projekti në qendër besoj që keni parë se kanë filluar

t'i vendosin edhe ato kabllot e rrymës nën tokë, kështu që do të trajtohet dhe ne kemi një zgjerim të qendrës, por nëse shohim se ka nevojë ta rrisim funksionalitetin, do të shohim mundësinë e një rruge qarkore aty. Pastaj në Xërxë, siç e dimë, ka pasur një kontratë që ka dështuar dhe ka disa probleme me prona, pastaj me pronën e hekurudhës, pastaj në Krushë ka pasur një kontratë që edhe aty ka dështuar dhe shumë keq është rrethrotullimi në Krushë të Madhe. Po ashtu edhe rrethrotullimi të Gradishi është në një pozicion shumë të keq edhe realisht s'ka hiç. Pastaj rrethrotullimin që kemi në dalje të qytetit në drejtim të Xërxës është pjesë e kontratës që do të rregullohet më mirë me rrugën katër korsi, pra jam dakord me atë që e ngrite si çështje, pasi duhet t'i trajtojmë, pasi Krusha e Madhe është duke vuajtur me mungesën e rrethrotullimit, e njëjta gjendje është edhe në Xërxë, pasi kemi edhe plot probleme të tjera të kësaj natyre dhe ne i kemi adresuar këto shqetësime dhe sigurisht përsëri tash në kërkesa e kemi lutur Ministrinë e Infrastrukturës që të merret me këto tema ose t'i rikthejë kontratat, apo të lidhë kontrata të reja që të bëhet zgjidhje pasi për rrethrotullimin në Xërxë e kemi me rrugën katër korsi, kurse për rrethrotullimin në Krushë të Madhe nuk kemi kurrfarë autoriteti, sepse është i Ministrisë së Infrastrukturës dhe i Planifikimit Hapësinor, kështu që shpresojmë se do ta kryejnë, pasi sivjet ka qenë një tollovi e madhe duke pritur deri në një orë për të dalë në rrugë kryesore. Pastaj te kanalizimet në Hoçë të Vogël, është fakt që kemi probleme, por në disa raste veç po ndërhyjmë, pasi kemi kontratë të re për kanalizime, pasi kemi bërë zgjidhje në plot vende e po besoj që edhe në Hoçë të Vogël do të bëjmë, mirëpo për më tepër rreth kësaj mund të japë drejtori i Shërbimeve Publike, Përparim Krasniqi. Te pyetja e parashtruar për drejtorin e Arsimit se a mund t'u ndihmojë komuna, po unë ju them se sikur sivjet të na tregonin që librat do të blihen ndryshe dhe do të shpërndahen ndryshe, atëherë vitin e ardhshëm ndoshta do të kishim pasur mundësi të përgatiteshim, mirëpo tani nuk kemi asnjë mundësi rreth kësaj, madje ka pasur një kërkesë si asociacion, mirëpo e kanë parë se disa komuna e kanë të pamundur vetë komunat t'i thonë ministrisë se faleminderit se na keni nderuar shumë kësaj radhe, pasi pas 15 vjetësh nuk ka libra dhe do t'i blejmë librat vetë, por për shkak që t'i respektojnë këto komunat e tjera nuk kanë vepruar as komunat që kanë fuqi më të madhe e që ndoshta edhe kanë mundësi ta kryejnë këtë shërbim me buxhetin e tyre. Shpresoj se E-Kosova është rikthyer në funksionim dhe do të shohim se nëse ka mundësi t'u ndihmojmë në aspektin logjistik, që t'i trajtojmë, sigurisht se jam dakord me ato që i tha Burimi më herët që t'u ndihmojmë sa i përket aplikimit edhe pse vendimi vlen deri në fund të shtatorit, por sivjet tash kanë nisur ankesa të tjera, pasi nuk po kushtojnë librat për ciklin e ulët 50 euro, por mbi 70 euro, pasi menjëherë këtu kisha ndërhyrë sikur të kisha kompetenca edhe të themi se nuk kemi mundur të lidhim kontrata edhe ta vëmë në kuvend që t'u ndihmojmë nxënësve edhe të krijojnë ekipe mobile që t'u shpërndahen librat që të bëhet zgjidhje. Këto justifikime nuk po i shoh të arsyeshme rreth numrit të aplikuesve, por unë për fëmijën tim nuk kam aplikuar. Kështu që e ftoj drejtorin e Arsimit që të shkojë nëpër shkolla dhe me drejtorët e shkollave t'u ndihmojnë atyre që kërkojnë ndihmën tonë për aplikim. Tek efienca e energjisë nuk kemi të drejtë fatkeqësisht, por vetëm me statusin e vëzhguesit kemi të drejtë të bëjmë vërejtje si vëzhgim, pasi nuk kemi mbikëqyrje, pasi në disa shkolla po na thonë se jemi shumë të kënaqur me punimet, mirëpo në disa shkolla jo edhe aq, pasi nuk janë e njëjta kompani dhe në komunën tonë i kemi disa shkolla në efienca edhe sigurisht se jam dakord t'i vëzhgojmë që nëse keni ndonjë situatë problematike, atëherë DKA-ja dhe kryetari i Komunës e ka kapacitetin të ndërhyjë te udhëheqja e fondit të efiençës për energji që të kërkojë korrigjime apo përmirësime, por vendime nuk mund të marrim, për shkak se agjencia vetë i nis procedurat, vetë i lidh kontratat dhe ne jemi vetëm si vëzhgues dhe realisht, drejtori i shkollës në Xërxë, Kryeziu, që e ka shkollën me efienca dhe secili drejtor që e ka shkollën me efienca, e kanë të drejtën ekskluzive pasi ne u japim këtë të drejtë se çkado që vërejnë ta fotografojnë dhe të mbajnë shënime dhe më pas ato vërejtje ne ia përcjellim udhëheqësit të Agjencionit.

Leonard Morina – Faleminderit kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë dhe të gjithë të pranishmit në sallë. Ne e dimë që Komuna e Rahovecit ka një kontratë me operatorin e telefonisë mobile Vala dhe a ka mundësi të na tregojë dikush se kur është lidhur kjo kontratë së fundi dhe sa është vlera e saj, pastaj a ka pasur rishikim të kontratës me operatorin Vala dhe nëse ka pasur rishikim pse ka ndodhur dhe kush e ka negociuar dhe kush ka përfituar prej rishikimit, apo edhe nëse ka pasur dhurata mënyra e shpërndarjes si ka ndodhur.

Kryetari – Me data nuk e di por e di qe kemi një përparësi, ndërmarrjet publike e në këtë rast Telekom, Posta e Kosovës, Kek-u, kanë përparësi në komunikimet dhe bashkëpunimet edhe potencialisht në kontratat me Komunën. Ka rishikim, ka lehtësira mirëpo nuk ka dhurata, edhe pse ka pasur më përpara negociatorë, sigurisht se është Fatmir Iska me Afrim Limanin, pasi më shumë këta janë marrë me këtë çështje, mirëpo një gjë e di se pa Postën e Kosovës, do ta kishim më të vështirë edhe te shpërndarja e tatimit në pronë, pra kryen shumë shërbime të mira edhe pse ne nuk jemi të kënaqur me shërbimet të cilat ofrohen por i mirëkuptojmë për shkak të vështirësive në të cilat po kalojnë institucionet publike edhe si institucion i sigurisë ne i kemi dhënë përparësi Valës dhe jo ndonjë operatori privat. Pra, me lehtësira, me rishikim, ndoshta më lirë e kemi, mirëpo dhurata nuk ka, nëse do të isha negociator, pasi e kanë obligative të na dhurojnë neve diçka, ju siguroj se shefit të grupit të VV-së, Leonard Morinës, më së pari atij ia kisha dhënë dhuratën, por për shkak se politikat e tjera menaxhohen nga Vala, por vështirësitë i ka të njëjta, por sigurisht se dhurata do të kishte edhe për Asamblenë, nëse do të kishte dhurata.

Vlora Vuçitërna – Përshëndetje për të gjithë! Atëherë, para disa seancave, në emër të Komitetit të Shëndetësisë, kemi bërë disa herë kërkesë që QMF-të dhe AMF-të në Komunën tonë të furnizohen sa më shumë me barna e sidomos me barna kundër temperaturës dhe antibiotikë për fëmijë, mirëpo edhe kësaj here kërkesat tona po shpërfillen dhe cila është arsyeja e kësaj. Në minibarnatoret e QMF-ve dhe AMF-ve janë vendosur 4 -5 lloje të ilaçeve sa për dekor dhe e njëjta gjë po vazhdon edhe në AMF-në në Xërxë, në QMF-në në Krushë te Madhe, në Rahovec, në Lagjen e Poshtme, ku mungesa e barnave esenciale është e dukshme përkundër asaj që pacientë ka edhe vullnet të stafit ka, pra kur është e parashikuar që të furnizohen me ilaçe. Dhe një gjë tjetër shqetësuese është që në repartin e Pediatriisë, në orarin e pasdites punon mjekja e përgjithshme e jo mjeku pediatër. Sipas statutit të QKMF-së a lejohet mjekja e përgjithshme të punojë në pediatri dhe tjetra, nëse ka mungesë të pediatri, atëherë pse nuk shpallët konkurs kur e dimë se Rahoveci ka pediater mjaftueshëm.

Kryetari – Për barna esenciale, deri më tash, vetëm ministria e shëndetësisë e ka furnizuar me barna esenciale dhe nga ky vit ka filluar edhe komuna, por sigurisht se shpenzimi i barnave është evident edhe ndonjëherë nuk është se jemi të kënaqur me furnizim të rregullt edhe nga ministria për pjesën e barnave që kryejnë ata. Pra, ne jemi duke e ndihmuar QKMF-në, respektivisht QMF-në dhe AMF-në me furnizime shtesë, sepse komuna tash po harxhon buxhet që nuk e ka harxhuar më përpara, pasi kompetente është Ministria e Shëndetësisë, por përsëri ka kërkesa. E dyta, ne e kemi shpallur një konkurs më herët për fizioterapeut dhe kemi hasur në probleme, pra ne kemi nevojë për diçka, por nuk do të thotë që kemi të drejtë për diçka, pasi kemi edhe kufizimet tona ligjore. Ne e kemi një pediater që nuk kemi mundur edhe ta largojmë, pasi është që një kohë të gjatë, por nuk do të thotë që kemi të drejtë të hapim konkurs për një pediater të ri se kemi kufizime ligjore. Mirëpo, për këtë temë duhet që të konsultohemi edhe njëherë me zyrën ligjore dhe në seancën e ardhshme, nëse nuk është prezente drejtoresha e Shëndetësisë, atëherë do të përgjigjem unë. Pastaj, sa i takon se a duhet të jetë mjeku i përgjithshëm në repartin e pediatriisë, mendoj se logjikisht duhet të jetë pediatri, mirëpo tash a kemi ne mjekë pediatër edhe në ndërrimin e pasdites, kjo është një çështje tjetër, pasi duhet të kemi parasysh se kemi edhe mungesa të pozicioneve të caktuara, pra mungesë të kuadrit pediatrik. Rreth AMF-së në Xërxë, po kërkojmë dhe po shpresojmë që të gjejmë mirëkuptim që të bëhet QMF-ja për shkak të numrit më të madh të pacientëve në Xërxë, po rritet, kurse në Fortesë është duke u zvogëluar numri, ndoshta që edhe një numër i pacientëve po vjen në Rahovec. Kështu që, nëse e kthejmë në QMF, edhe pse disa sinjale na kanë dhënë në kujdesin ndaj AMF-së në Xërxë, do ta rrisim për shkak se numri i pacientëve është shumë më i madh. Furnizimi me barna do të vazhdojë, sepse ne vazhdimisht do të ndajmë buxhet, sepse me barna esenciale nuk është se jemi të kënaqur për shkak të numrit të madh të qytetarëve që po kanë nevoja për barna esenciale, po rritet. E di qe ka shqetësime të tjera në shëndetësi, tash do të fillojmë me riparime të brendshme e të jashtme dhe unë mendoj që QKMF-ja në komunën tonë, me shërbimet që i ofron falas, prandaj edhe jemi nga komunat e rralla që kemi fituar grand edhe për kujdesin shtëpiak që u lëshua në funksion tash, kështu që, me shërbimet që ofron komuna jonë, atëherë goxha është një buxhet i madh, harxhohet, mirëpo, sido që të jetë, buxhetin në Shëndetësi e kemi më mirë sesa në Administratë dhe Arsim, e sigurisht se do ta kemi edhe më mirë vitin e ardhshëm edhe do të kemi mundësi të ofrojmë shërbime dhe nevoja që u mungojnë qytetarëve të komunës tonë.

Rasim Fazliu – Përsëritet për ju kryesues, kryetarin, anëtarët e kuvendit komunal, drejtorët, përfaqësues të medieve dhe të gjithë të pranishmit në sallë. Unë desha të ngris një çështje, më tepër si informatë dua ta marr dhe pyetja i drejtohet Komitetit për Politikë dhe Financa që është Komitet obligativ dhe i nxjerrë nga ky kuvend, pasi edhe një muaj ka mbetur që do ta bëjmë miratimin buxhetit. Kështu që desha të pyes se a ka bërë ndonjë kalendar për Dëgjime Buxhetore dhe nëse e ka bërë, atëherë a e ka publikuar dhe a është duke i respektuar ato afate, pra a i ka mbajtur, apo do t'i mbajë, kjo është pyetja, sepse siç e thashë është Komitet obligativ dhe e përfaqëson Kuvendin dhe ne, përmes KPF-së, i marrim të gjitha kërkesat prej qytetarëve dhe më pas, në harmoni me ekzekutivin, e miratojmë buxhetin dhe e dimë më mirë për kërkesat dhe nevojat e qytetarit të Komunës. Pra, kërkoj një informatë nga anëtarët e KPF-së, mirëpo kjo nuk vlen edhe për ju kryesues, pasi jeni rishtas në krye të detyrës dhe ju uroj shëndet dhe punë të mbarë!

Burim Krasniqi – Meqenëse ju amnistoi juve, pasi jeni kryesues rishtas, i nderuar Rasim, sa i përket buxhetit, atëherë mesa e di, draft-buxheti i është dorëzuar sot kryesuesit të kuvendit dhe po besoj që në momentin që kryesuesi i propozon KPF-së një draft-axhendë për diskutime publike, atëherë KPF-ja do të jetë e gatshme të shkojë prapa kryesuesit dhe ta kryejë obligimin e tij ligjor, por deri më sot nuk kemi pasur buxhet, mendoj që kjo është përgjigja që mund të jap si anëtar i KPF-së.

Ali Morina – Faleminderit i nderuar kryesues, të nderuar anëtarë të kuvendit, drejtorë të drejtorive dhe të gjithë të pranishmit. Dua të jap një sqarim në emër të Kabinetit të kryetarit, pasi kam qenë edhe pjesë e organizimit të Dëgjimeve Buxhetore. Si praktikë, në të kaluarën janë organizuar në të njëjtën kohë pothuajse edhe dëgjimet me KPF-në, mirëpo tash edhe me komandimin edhe të organizatave monitoruese na kanë rekomanduar që pas dorëzimit të buxhetit të kryesuesi dhe të anëtarët e Kuvendit, veçanërisht KPF-ja organizon Dëgjime Buxhetore. Kështu që pasnesër ne e bëjmë një kalendar për Dëgjime Buxhetore në konsultim me kryesuesin dhe me anëtarët e KPF-së dhe i organizojmë këto dëgjime.

Avni Morina – Përsëritet për ju kryesues, anëtarët e kuvendit, kryetarin, kolegë drejtorë, media dhe të gjithë ju të pranishëm. Pata disa pyetje që më janë adresuar mua si drejtor i Arsimit, ku pyetja e parë ishte nga Burim Krasniqi rreth mosvijimit në shkollë për semimaturantë që mbarojnë klasën e 9-të në Komunën tonë. Sipas të dhënave që i kemi në Drejtorinë e Arsimit, është një numër i nxënësve të cilët regjistrohen edhe në komuna të tjera për shkak të prirjeve që ata kanë për të zgjedhur drejtimet apo profilet profesionale që ndoshta nuk mund të jenë në komunën tonë. Kjo është një përqindje e vogël dhe kjo sado numër i vogël të jetë që nuk e vijnë mësimin në komunën tonë dhe shkojnë në komuna të tjera, sigurisht se ndikon në zvogëlimin dhe rënien e numrit të nxënësve në nivel komunal. Mirëpo, e drejta për arsim është e drejtë universale themelore e nxënësve dhe nuk mund t'u imponojmë vullnetin e tyre për t'u regjistruar në profilet që ata kanë dëshirë, kryesisht në profilet që ndoshta nuk janë në Komunën tonë dhe kjo është një dukuri që është vështirë të ndalet dhe unë vetë vajzën time nuk kam mundur ta ndaloj, pasi është regjistruar në Prishtinë në Shkollë të Mesme të Mjekësisë “Ali Sokoli”, me meritë. Megjithatë ne kemi bërë përpjekje që drejtimet profesionale që i kemi në Komunën tonë t'i sensibilizojmë nxënësit e klasave të nënta, pastaj qendra e karrierës që është funksionale në shkollën e mesme profesionale, që gati e ka një vit, koordinatorët e qendrës, bashkë me mësimdhënësit e kësaj shkolle, gjatë muajit prill edhe maj, kanë dalë në të gjitha shkollat dhe kjo ka ndikuar pozitivisht që të nxisin nxënësit e klasave të nënta të shkollave fillore të komunës tonë t'i vijnë mësimet në drejtimet profesionale në shkollat profesionale dhe me këtë rast është rritur numri i nxënësve në këtë vit në shkollën profesionale, në profilet profesionale. As unë vetë nuk e kisha menduar që numri i nxënësve në klasën e dhjetë të regjistruar në shkollën profesionale këtë vit do të jetë i barabartë me numrin e nxënësve në Shkollën e Mesme të Lartë “Xhelal Hajda”, në Rahovec, pra rreth 120 nxënës në gjashtë paralele janë themeluar edhe në shkollën profesionale në profile te ndryshme. Problemi tjetër që lidhet edhe me pyetjet që i bëri edhe Burimi, është edhe problemi me çerdhet, siç e dini ne i kemi përruruar 3 çerdhe të reja, të cilat i kemi ndërtuar me buxhetin e Komunës tonë, ku njërin e kemi përruruar më 21 dhjetor në Xërxë, ndërsa më 1 qershor e kemi bërë përrurimin e dy çerdheve të tjera në Krushë të Madhe dhe në Ratkoc. Po presim furnizimin me inventarë, pasi nga muaji prill, sipas informacioneve që kemi nga zyrtarët e Ministrisë së Arsimit, konkretisht nga

Departamenti për Infrastrukturë, ende nuk është lidhur kontrata për shkak të një ankese të një operatori dhe lënda është në OSHP, kështu që po presim këto ditë që të lidhet kontrata sa më shpejt dhe të fillojë pastaj furnizimi me inventarë i tri çerdheve të reja. Ndërkohë, gjatë muajit korrik dhe gusht, ne kemi zhvilluar procedurën e rekrutimit të 16 edukatoreve të reja, përfshirë edhe një listë pritëse, pasi kemi pasur një konkurrencë shumë të madhe dhe edhe sipas ligjit për zyrtarë publikë, por edhe sipas konkursit, edukatorët do të punësohen apo kontratat e tyre do të bëhen në momentin kur të fillojnë punën. Kështu që, sipas ligjit për zyrtarë publik, ky konkurs, por edhe çdo konkurs tjetër, lista e kandidateve që janë përzgjedhur me konkurs, kanë të drejtë punësimi brenda një viti të plotë, duke filluar nga data 10 gusht 2023, deri më 10 gusht 2024. Prandaj, ne mezi po presim që të na vije inventari dhe sapo të vije, ne do të fillojmë punën me tri çerdhet e reja. Rreth çështjes së librave që ishte pyetje e përbashkët nga asambleistët Edona dhe Burimi, vërtet na kanë krijuar probleme edhe neve si DKA, sepse dhjetë ditë para se të fillonte viti shkollor, ministri i Arsimit doli me një njoftim që të gjithë e dinë dhe që na ka zënë në befasi edhe ne, pasi pa u konsultuar fare me DKA-të e asnjë Komune, e ka nxjerrë një vendim që librat kësaj radhe do të blihen nga prindërit dhe paratë do të rimbursohen përmes aplikimit në platformën E-Kosova. Javën që shkoi, kemi pasur një takim me Kolegjiun për Arsim, ku ishim prezentë shumica e drejtorëve të drejtorive komunale, ku e kemi ftuar edhe ministrin e Arsimit, ku edhe në atë takim ministrja fare nuk ka ardhur. Megjithatë, meqenëse njoftimi doli dhe njoftim mëse i vonuar, atëherë ne jemi angazhuar që përmes drejtorëve të shkollave t'i informojmë të gjithë prindërit të cilët nuk dinë apo nuk kanë informacion që ta shpërndajmë informacionin apo t'i informojmë dhe t'i udhëzojmë se si duhet të aplikohet në platformën *online* për blerjen e librave për rimbursim dhe siç e keni parë këto ditë, nëse keni pasur mundësi t'i përcillni ueb-faqet e shkollave, pothuajse secila shkollë ka nxjerrë njoftim publik, ku edhe ka bërë njoftimin e ministrisë për platformën dhe mënyrën e aplikimit, por edhe ka shpërndarë linkun se ku duhet të dërgohen në email dhe gjithashtu kemi dhënë edhe detaje të tjera të cilat kërkohen për aplikim. Sipas njoftimit të ministrisë, prindërit duhet të aplikojnë në platformën E-Kosova, prindërit që kanë fëmijë prej klasës së parë deri në të pestën do të kompensohen, sipas ministrisë, me nga 80 euro, ku 50 janë për libra, kurse 30 euro për material shkollor, ndërsa prindërit që kanë fëmijë prej klasës së gjashtë deri në të nëntën, do të rimbursohen vetëm me nga 30 euro, vetëm për material shkollor. Me këtë rast, ne mendojmë që ministri i Arsimit dhe ministria e Arsimit, kanë bërë dy shkelje, ku shkelja e parë është shkelja e të drejtave të nxënësve për të poseduar librat që i ka pasur në vitin paraprak dhe ju them sinqerisht, sikur unë të isha nxënës, kurrë nuk do të pranoja që t'i ktheja librat që i kam përdorur për një vit të tërë, pasi e konsideroj si pronë e imja. Por, tani nxënësit detyrohen që t'i kthejnë librat që i kanë përdorur për një vit, pa marrë parasysh se a janë të grisura apo të përdorura dhe ne nuk e dimë se sa libra mund të kthehen nëpër shkollat amë kur kanë vijuar nxënësit në vitet paraprake, në mënyrë që të furnizohen nxënësit e klasave të gjashta deri në të nëntën. Pastaj, si shkelje dytë, Ministria e Arsimit ka bërë shkelje tek e drejta e aktiveve profesionale për të përzgjedhur se me cilat shtëpi botuese do të punojnë nxënësit dhe mësimdhënësit sepse, qe krijuar një sistem i mirë apo i keq qe dhjetë vjet me radhë, ku para se të vinin librat, aktivet profesionale i përzgjidhnin shtëpitë botuese qe do te furnizohen me tituj librash pastaj vinin librat ne DKA- pastaj i shpërndanim ne te gjitha shkollat dhe nuk kemi pasur kurrfarë problemi. Dhe tash, e gjithë kjo barrë e përgjegjësisë u mbetet prindërve dhe prindërit nuk mund ta dinë se çfarë libra u duhen nxënësve, pra kjo është një kontradiktë. Siç shihet, fatkeqësisht, nuk do të fillojmë mbarë për arsye se nëse vitin e kaluar na ka penguar greva, kurse para dy vitesh na ka penguar pandemia, siç duket edhe këtë vit do të kemi probleme serioze, sepse nuk do ta dimë se çfarë mësimi do të zhvillohet nëpër shkolla kur nxënësit nuk e kanë elementin bazë themelor, pra tekstin shkollor.

Defrim Kafexhiu – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, të nderuar kolegë anëtarë, drejtorë të drejtorive dhe të gjithë të pranishmit në sallë. Një pyetje shumë të shkurtër e kam për drejtorin e Arsimit, pasi e dëgjova me vëmendje drejtorin, pasi problemet e Ministrisë së Arsimit që po na i tregon neve, mund t'i adresosh direkt në Ministrinë e Arsimit se ne nuk kemi kompetencë, por kam një pyetje për ju, pasi si drejtor i Arsimit në Komunën e Rahovecit, tash mandati i dytë radhazi, sa herë keni bërë vërejtje drejtuar Ministrisë së Arsimit për çështjen e kualitetit të librave, ku e dimë që librat që iu kanë dhënë nxënësve, kualiteti ka qenë aq i dobët saqë për një vit shkollor nuk ka mundur të përmbyllet siç duhet me ato libra e lëre që ato libra të shfrytëzohen për gjeneratën tjetër.

Po besoj që këto janë çështjet më kryesore që duhet të diskutohen sesa drejtimi i gishtit tek institucionet qendrore. Pastaj çështja tjetër që dua të diskutoj është të tregoj qasjen apo mënyrën e funksionimit të kryetarit të Komunës që e kemi një rast faktik në Komunën e Rahovecit, saktësisht në qytet, te rruga “Vëllezërit Frashëri”, ku mund të shfaqim një pjesë jo të lëndueshme të kryetarit, i cili, mund ta faktojme, vepron politikisht dhe nuk punon dhe nuk vepron në të mirën e qytetarëve e sidomos të kësaj pjese aty. Rruga “Vëllezërit Frashëri”, është shembulli që Komuna, prej vitit 2017, nuk ka bërë asgjë në atë lagje. Fillimisht, banorët e asaj lagjeje kanë probleme të shumta infrastrukturore, por njëri nga problemet më të mëdha është mungesa e rrjetit të kanalizimit që i preokupon ata qytetarë, pra banorë të asaj lagjeje, qysh prej mandatit të parë të kryetarit, por që asnjëherë nuk ka shprehur vullnet për ta rregulluar këtë çështje delikate. Ne e dimë që kryetari e ka pak problem rregullimin dhe përderisa po bëhet gati të dalë dhe të japë sqarime, mendoj se këto sqarime jeni duke i dhënë që nga mandati i parë, d.m.th. unë e di se çfarë arsye do të japësh, por këto arsye nuk çojnë peshë më për shkak se keni përgjegjësinë dhe jeni bartës i institucionit, jeni kryetar i Komunës dhe sigurisht se qytetarëve duhet t’u bësh zgjidhje, pavarësisht sa delikate është situata. Problemin në të njëjtën lagje apo në të njëjtën rrugë, komplet pjesa “Vëllezërit Frashëri” është me tension të ulët të energjisë elektrike, që e dimë se është kompetencë e KEDS-it, por Komuna duhet të sigurojë pronë, edhe pse nuk ka pronë publike në atë pjese dhe duhet të sigurojë zgjidhje dhe mendoj se deri më tash do të ishte dashur që të bëhej zgjidhje, pasi jeni në mandatin e tretë si kryetar dhe nuk keni arritur të bëni shpronësimin e një pjese të vogël për të vendosur një trafo që do ta rregullonte një problem të kahershëm të atyre banorëve, që po e vështirëson jetën e tyre dhe po ju shkakton probleme financiare të përvitshme e sidomos në sezonin e dimrit. Këto dy probleme janë më të mëdhatë, por ka edhe probleme të tjera në atë lagje, edhe pse drejtori i Shërbimeve Publike nuk është prezent tani, ndriçimi publik, prej muajit shkurt te këtij viti, nuk është duke funksionuar në lagje, d.m.th. ky është edhe një fakt tjetër që ju kurrë nuk dilni të shihni se çka është duke u bërë atje dhe e gjithë kjo është për çështje politike, për shkak të mbështetjes së banorëve të asaj lagjeje që i kanë dhënë një partie tjetër politike, kështu që ju po vazhdoni t’i penalizoni ata në aspektin infrastrukturor. Kështu që ndriçimi publik nuk funksionon nga shkurti dhe ka kërkesa të tjera nga banorët e lagjes për policë të vdekur për shkak të dendësisë dhe qarkullimit të madh të automjeteve me shpejtësi të madhe që po rrezikon banorët e posaçërisht fëmijët e asaj lagjeje. Po ashtu, edhe pasqyrat që vendosen në rrugë, e dimë formën se si është e ndërtuar lagjja dhe kyqjet që bëhen prej rrugëve të papërshtatshme në rrugën kryesore “Vëllezërit Frashëri”, absolutisht nuk ka pamje të qarkullimit të automjeteve dhe ka pothuajse shumë shpesh edhe aksidente. Po ashtu kam edhe një kërkesë tjetër, pasi komplet rruga “Vëllezërit Frashëri” janë tri rrugë dytësore të pashtuara dhe të pakubëzuara, edhe pse Komuna e Rahovecit i ka dy kontrata të lidhura për kubëzimin e rrugëve dhe kjo a është koincidençë, apo e qëllimshme le ta vlerësojnë qytetarët, për shkak se të tri rrugët lidhen me anëtarët e Lëvizjes Vetëvendosje, ku njëra rrugë është ku banon anëtar i kuvendit të VV-së, tjetra rrugë është ku banon kryetari i nëndegës së Lëvizjes Vetëvendosje dhe rruga e tretë është rruga ku banon koordinatori i Lëvizjes Vetëvendosje. Kështu që, rrugët e tjera të militantëve dhe të anëtarëve të Aleancës, i keni shtruar deri në oborr, kështu që e pyes kryetarin dhe drejtorin e Shërbimeve Publike se kur do të bëhet rregullimi i tyre.

Burim Krasniqi – Drejtor, më duket se më keni keqkuptuar në diskutimin tim, pasi unë kam shprehur shqetësim dhe kam dhënë disa sugjerime të cilat mund t’i pranoni apo mund të mos i pranoni, kështu që nuk po besoj që është e udhës të arsyetoheni, por po besoj që është më mirë të veproni. Gjithashtu kam edhe një kërkesë të fundit që të na dërgoni në email se sa ka qenë numri i semimaturantëve që i janë nënshtruar testit të semimaturës në këtë fundvit dhe sa e kemi numrin e klasave të dhjeta që janë regjistruar në këtë vit në Komunën e Rahovecit dhe aty mund të bëjmë krahasimin për atë që po e them, pasi po afrohet rreth 30% e nxënësve të shkollave të mesme të ulëta të cilët vazhdojnë shkollën e mesme të lartë jashtë komunës së Rahovecit dhe këtë e them me përgjegjësi.

Kryetari – Faleminderit shumë kryesues, të nderuar të pranishëm! Unë pata përshtypjen se është duke folur ministrja e Arsimit në sallën e Kuvendit Komunal të Rahovecit dhe sikur dikush do ta kryqëzojë ministren e arsimit për çështjen e librave e më pas dikush duhet të jetë avokat i specializuar mbrojtës për t’i mbrojtur gjërat të cilat janë absurde. Të gjithë jemi në dijeni se kontratat, qoftë me negocim apo pa negocim, apo sido qofshin, i bën Ministria e Arsimit dhe mbikëqyrjen e kualitetit të librave e bën Ministria e Arsimit, pra sektori përkatës,

komisioni mbikëqyrës dhe natyrisht se në situata të tilla, DKA-ja gjendet para aktit të kryer pasi ata i sjellin librat dhe ato duhet të shpërndahen, por nëse ne do ta lidhnim kontratën, atëherë do të kishim mbajtur përgjegjësi edhe për kualitetin. Pra, për një çështje që nuk do të kishte mundur t'i jepte përgjigje as ministrja e Arsimit, që me gjasë e ka huqur edhe për çerdhe në qytet, edhe për shkollën "Milaim Krasniqi" në Pastasel. Pasi ajo ka bërë një deklaratë para disa ditësh, edhe unë jam detyruar ta përmend edhe në televizion, ku thotë se ne po i presim komunat për kërkesat dhe nevojat që i kanë për çerdhe të reja dhe krejt harron se e ka një çerdhe që e ka buxhetuar vitin e kaluar e po ashtu e ka të buxhetuar edhe sivjet edhe ende nuk kanë nisur procedurat e prokurimit, po ashtu harron që ka ndërtimin e një shkolle në Pastasel që vitin e kaluar e ka buxhetuar edhe sivjet e ka buxhetuar edhe ende nuk kanë nisur procedurat e prokurimit e po ashtu harron se i kemi tri çerdhe ne e po ashtu edhe katër i ka komuna e Suharekës e plot komuna të tjera që janë çerdhet e gatshme dhe nuk kanë inventarë dhe sigurisht se ministria është përgjegjëse pse nuk ka inventarë për çerdhe dhe po ashtu harron që e kemi ndërtimin e objektit të ri të Shkollës Fillore "Hamëz Thaqi" në Xërxë dhe buxhetimi ka ndodhur në 2025, pra buxhetimi i kësaj shkolle është bërë për vitin 2025. Kështu që nuk ka nevojë një anëtar i Kuvendit të Komunës të përfaqësojë interesat e ministrisë, sepse e kanë avokaturën shtetërore që mund ta mbrojë një ministër, një zëvendësministër e po ashtu një qeveri, pra i kanë mekanizmat shtetërore të veta e po besoj që duhet të mbrohen nëse kanë arsye të mbrohen. Ne po shtrojmë çështje për diskutim dhe po paraqesim fakte, pasi i illustroi shumë mirë drejtori dhe po besoj që edhe ato që i diskutoi Burimi, po besoj që drejtori i Arsimit do ta rikonfirmojë me një informatë me shkrim dhe do t'ia japë me evidenca në seancën e radhës, Burim Krasniqi. Pastaj në lagjen "Vëllezërit Frashëri" që dikur e kanë quajtur lagjja "Strana", pasi i bëra disa vite që jetoj me qira në Rahovec kështu që kam bërë vite duke jetuar këtu se sado që mund të flasin këtu për çështje të caktuara. Lagjja "Vëllezërit Frashëri", këtë rrugë për herë të parë e kemi hapur në mandatin tim, pasi ka qenë e bllokuar edhe rruga edhe kanalizimi, pasi ka qenë në sipërfaqe. Gjatë mandatit të parë kemi hasur në vështirësi të mëdha dhe pas një mori diskutimesh me banoret e lagjes, kemi arritur që të bëjmë kanalizimin dhe e kemi lidhur me kanalizimin kryesor dhe rrugën e kemi bërë zgjidhjen me shpronësim, pasi e kemi bërë një kthesë aty, pasi nuk ka lejuar të bëhet rrugë i njëjti që ka pranuar ta vëmë kanalizimin, sepse ka kërkuar kompensim shumë, por sido që të jetë, e kemi bërë shpronësimin përsëri në mandatin sa unë isha kryetar dhe i falënderoj kolegët edhe gjithashtu banorët e lagjes. Pastaj çështja e trafos, pasi asambleisti që foli, asnjëherë nuk ka shtruar kështu në kuvend, ndoshta edhe për shkak se ka qenë kryesues edhe nuk i ka takuar aq shumë, por tani po e shoh që është shumë aktiv edhe po besoj që është në dijeni edhe sigurisht se për më tepër e ka për reputacion publik e që realisht unë nuk e kam, pasi i kam konsumuar moti, gjithashtu e di që vjen nga ajo lagje, por e di që e ka edhe një oborr apo pronë aty ku e ka shtëpinë, mirëpo asnjëherë shpronësim për trafo nuk kemi bërë dhe ky le ta lëshojë një pjesë të oborrit si prone private, edhe unë publikisht e them se ia garantoj vendosjen e trafos, pasi këtë e bën KEDS-i, mirëpo s'ka pronë. Kështu që ju e dini shumë mirë se aty s'ka pronë, mirëpo ai personi tjetër, Shulina, e ka vënë vetëfinancim për nevoja të Bodrumit të verës dhe të rakisë dhe në bashkëpunim me KEDS-in. Kështu që unë ju them juve se ju, nëse e gjeni pronën, atëherë qysh në mbledhjen e shtatorit do ta vë si pikë të rendit të ditës për shpronësim, që realisht s'ka ndodhur asnjëherë që të paguhet financiarisht të shpronësohet për trafo. Ata banorë që ju po i ndani, unë nuk po e bëj një gjë të tillë, pasi mendoj se ata banorë nuk janë Lëvizje Vetëvendosje, por janë qytetarë të komunës së Rahovecit edhe për këtë s'ka tolerim për askënd, pasi unë asnjëherë nuk i ndaj qytetarët me rrugë apo me parti politike, kështu që në konceptin tuaj, ju po i ndani. Pra, ata janë qytetarë të Rahovecit që kanë problem me rrugë dhe mund të kenë problem me ndriçim publik, pastaj mund të kenë problem me kanalizim, por gjithashtu, nëse je i informuar për fushatën e fundit të inspektorëve, ata do të fillojnë të dënojnë, sepse ajo është prone private. Dhe unë jam këtu për të zgjidhur probleme e jo për t'u konfrontuar me banoret në praninë time që të eskalojë gjendja deri te më e keqja, kështu që këto situata nuk i kam krijuar unë por po mundohem t'i zgjidh dhe tash ka filluar aksioni i ndëshkimeve për shkak të kanalizimit dhe unë ta bëj gropën septike dhe nuk do të lejoj që ujërat e zeza të dalin në rrugën "Xhelal Hajda", siç po kalon, sidomos gjatë kohës së natës dhe vazhdimisht jam duke u marrë me këtë problem për shkak të këtyre aksioneve, kështu që do të dënohen ata që krijojnë pengesa dhe nuk e lejojnë operatorin pastaj për shkak të pronave private, gjithashtu edhe e derdhin ujin e zi, që vjen në rrugën kryesore, këtë nuk do ta lejoj pasi jam kryetar Komune

dhe jam kompetent. Po ashtu edhe rrugët e tjera që i përmende e po ashtu edhe te rruga juaj, e para është pronë private dhe e dyta, familja Rexha ka participuar për furnizim me kubëza, ndërsa familjet e juaja ndoshta jo, pasi ne i kemi participuar me kubëza dhe dikush i ka shtruar dhe gjithashtu ju nuk e keni bërë përkthimin, kështu që nëse nuk keni dashur të merrni pjesë, atëherë as ta shtroni rrugën e ne të marrim pjesë me kubëza, tash ju ftoj publikisht që të shkoni te drejtori i Gjeodezisë dhe Kadastrës, merri nënshkrimet që nuk kërkon kompensim për shpronësim, pasi kemi kontratë dhe mund të mbërrijmë edhe ta shtrojmë atë rrugë. Te ndriçimi publik kemi pasur avari sa i përket ndriçimit, kemi probleme pasi dikush edhe i prek siguresat e që mund edhe të dëmtohen edhe mbrojtëset e siguresave dhe gjithashtu kemi pasur disa herë djegie nga rrufeja, sikur që kemi tash problemi në rrugën tranzite që dikush ka bërë ndeshje edhe e ka dëmtuar shtyllën elektrike edhe nuk funksionon ndriçimi publik pasi ka shumë punë deri në rregullimin e saj, sepse duhet të ndërrohet shtylla, pastaj kabloja edhe pse ai që e ka dëmtuar duhet të përgjigjet për këtë, mirëpo deri sa te kryhet pagesa edhe të vije në xhirollogari të Komunës, ne nuk mund ta lëmë ashtu ndriçimin publik, jofunksional. Te pengesat në rrugë, nëse ka kërkesë për pengesa në rrugë, atëherë unë do ta obligoj kompaninë që t'i sjellin ato edhe t'i vendosin, mirëpo nëse nuk ka kërkesë, pasi ka një kriter, nuk mund të vëmë pengesa pa standarde. Sa i përket infrastrukturës tjetër, ka nevojë ajo lagje për kanalizim se nuk është një shtëpi, por janë më shumë se 300 shtëpi dhe siç e potencova më herët se derdhet uji i zi dhe shkon në rrugën kryesore te restorant *Viva-D*. Sigurisht se unë pajtohem me atë që thatë, se ju jeni kryetar dhe ju jeni për të bërë zgjidhje, por unë mendoj se zgjidhjet duhet që të gjithë bashkë t'i luftojmë edhe t'i bëjmë, por ju si asambleist nuk duhet të mendoni për diçka të tillë se 100% janë VV e gjithë lagjja, sepse nuk duhet të flasë diçka të tillë një asambleist i zgjedhur kështu, pasi nuk e nderon as elektoratin, pasi kërkesa duhet të jetë e arsyeshme dhe gjithashtu duhet të jeni falënderues edhe ndaj Komunës se për herë të parë shpronësim në mënyrë financiare u është bërë nga Komuna, pasi ne kemi plot raste të tjera, por gjithmonë gjejmë forma të tjera që mos t'i harxhojmë nga buxheti i Komunës. Kështu, në atë lagje edhe përmes kësaj seance, ju sfidoj që nëse e lëshoni një pjesë të oborrit tuaj, atëherë qysh në shtator e hedhim si pikë të rendit të ditës dhe e vlerëson komisioni profesional i certifikuar nga ministria. Si problematikë është e njohur edhe gjithashtu edhe KEDS-i është i gatshëm ta sjellë trafon, mirëpo kemi mungesë të pronës, pasi nuk dëshiron askush të lëshojë pronë private. Madje unë jam duke zbatuar edhe opsionin B, pasi po merremi me KEDS-in që të gjejmë edhe zgjidhje, sepse janë avancuar teknikat që të gjejmë ndonjë pajisje që të vendosim në ndonjë shtyllë dhe ta forcojmë rrymën në atë zonë, nëse është e pamundur të gjejmë vend për vendosjen e trafos. Pra jemi duke i shikuar të gjitha mundësitë që ekzistojnë, pasi është problem se duhet të kalojë nëpër prona private dhe një projekt kur kalon në prona private, atëherë ka vështirësi të shumta dhe pasi ti thua se e gjithë lagjja është VV, atëherë bindi banorët e lagjes, atëherë e gjithë merita e kësaj pune do të shkojë për ty dhe do të të falënderoj publikisht për këtë, por unë mendoj se nuk është situata e tillë ashtu si ti e komenton dhe madje për informacion, ata banorë të asaj lagjeje më kanë nxjerrë fitues të zgjedhjeve të vitit 2011, i pata thirrë disa kompani edhe e kanë shtruar me zhavorr. Kështu që unë nuk kam asnjë problem me ata banorë nga pikëpamja e politikës, por ne kemi problem me ata banorë për shkak se vërtet nuk kemi mbërri te një zgjidhje që është meritore për ata banorë që të kenë një jetë më normale, por tani problemi ka degraduar pasi uji i zi ka dalë në rrugën kryesore, por sigurisht se do të ndëshkohen për këtë pasi duhet të krijohen mundësitë që ta vendosim gypin përmes pronave private, që të bëjmë zgjidhje ose nuk do të bëhet gropa septike dhe nuk do të lejohet që uji i zi të dalë në rrugën kryesore. Pra, jemi duke u marrë me këto problematika vazhdimisht dhe nuk janë arsyetime këto, por argumente pasi me inspektorë, shërbimet publike pastaj edhe kompaninë e kemi dërguar, nuk kanë lejuar dhe nuk e di se pse sillen dikush këtu që shumë mirë e di situatën edhe paraqitet se nuk di asgjë. Unë jam që t'i japim zgjidhje kësaj shtate dhe e marr barrën e kësaj, mirëpo jam edhe për t'ju sqaruar juve dhe secilit se jemi duke u marrë me atë punë dhe problemet nuk kanë të bëjnë me politikë asgjë, pasi probleme të kësaj natyre kemi edhe diku tjetër e sidomos kur ndërlidhet me çështjen e pronave, pasi janë prona private, pavarësisht që neve na lejon një nen që e thotë se nën 50cm mund të bësh çka të duash se nuk është e privatit dhe sigurisht se duhet të ketë mirëkuptimin e secilit kur është fjala për pronë private. Edhe pse situata është problematike dhe ne po bëjmë përpjekje që të bëjmë zgjidhje dhe mendoj që me ndëshkimin që do ta marrin për shkak të ujërave të zeza që po dalin në rrugën kryesore, do te jetë moment ndërgjegjësimi se diçka

duhet te veprohet për ta zgjidhur këtë problematikë, që të lejojnë të hyhet nëpër oborre dhe ta vendosim gypin e kanalizimit dhe gjithashtu edhe një pjesë e sipërfaqes është e pashfrytëzuar për shkak të mungesës së infrastrukturës. Pra, jemi duke u munduar që të gjejmë zgjidhje adekuate dhe duk bërë përpjekje që të arrijmë deri te një zgjidhje për banoret e asaj lagjeje dhe sigurisht se edhe ndihma juaj do të ishte e mirëseardhur, nëse vërtet ke vullnetin të bësh diçka në këtë drejtim, e sigurisht se do të ju falënderoj publikisht për këtë.

Defrim Kafexhiu – Faleminderit kryesues! Nuk ke nevojë të më bësh nder mua e as të më falënderosh, por nëse unë do të isha kryetar, atëherë brenda javës do ta kisha rregulluar këtë çështje, mirëpo pasi jeni ju kryetar edhe përgjegjësia mbetet tek ju. Kështu që mbi 8 vjet jeni në pushtet dhe vazhdimisht jeni duke dhënë arsyen e njëjtë, por prapë puna nuk është duke u kryer, kështu që ju jeni kryetar i Komunës dhe ju duhet ta gjeni parcelën dhe ju duhet t’u jepni zgjidhje gjërave komplekse, pasi mbi 8 vjet jeni duke u marrë me këtë çështje dhe sigurisht se duhet ta kryeni punën dhe vjen këtu u gjuan hi qytetarëve dhe banorëve të asaj lagjeje, e jepni të njëjtën arsye që e jepni dhe kjo është e paarsyeshme. Pastaj, nëse tani më adresohesh mua për çështjen e rrugëve që i përmende dhe për pronën time private, atëherë ju them se unë nuk posedoj pronë private, kështu që është e drejtë legjitime që unë e kërkoj, pasi keni bërë kërdi me kubëzimin e rrugëve dhe ua keni shtruar njerëzve edhe oborret, pra në seancën tjetër ju sjell të dhënat se ku i keni shtruar edhe oborret e militantëve të aleancës dhe vjen këtu bën poshtërsi prej foltores dhe ju gjuan hi syve dhe thua të pavërteta.

Kryetari – E para, fjalën poshtërsi nuk pranoj ta dëgjoj në këtë kuvend nga dikush dhe kushdo që do të përdorë këso fjalori mundet vetëm në shtëpinë e tij e jo në sallën e Kuvendit, e dyta është që unë nuk i manipuloj qytetarët dhe nuk lejoj që dikush tjetër t’i manipulojë qytetarët dhe e treta, mos harroni se ju mund t’i keni 51% diku tjetër, por këtu vendosim ne bashkë dhe nuk do të lejoj asnjëherë që asnjë qytetar ta manipulojë e as ta shantazhojë, as ju edhe as dikush tjetër. Kështu që ju po mendoni se i kemi 51% diku edhe mund të bëni çfarë të doni e realisht kurrëgjë hiç s’po bëni, por këtu mund të shprehni mendimin tuaj, mirëpo fyerje dhe kualifikime nuk lejoj të bëni, pasi unë askënd nuk e fyej dhe nuk e kualifikoj, pasi Smajl Latifi nuk bën asnjëherë poshtërsi dhe ju them që mos ta përdorni asnjëherë këtë fjalë ju apo dikush tjetër, por gjithashtu nuk lejoj që as ju, apo dikush tjetër të bëni poshtërsi në këtë sallë të Kuvendit dhe njëherit e ftoj kryesuesin që njerëzit që përdorin fjalë fyese do të ishte më mirë të dalin nga salla e Kuvendit deri sa të qetësohen. Unë isha duke dhënë sqarime dhe ju kur të doni mund të sillni informata dhe nuk do ta keni rastin për situata të tilla pasi më keni thënë se ne jemi rritur politikisht duke të sharë ty, kështu që tani nuk do ta keni atë shans se kinse të ngriteni politikisht që të mendojnë njerëzit që jeni i zoti dhe realisht mos të thoni asgjë, bile të paktën mos të shpifësh dhe këto nuk do t’i lejoj asnjëherë. Kështu që unë do të flas me Kuvendin normalisht por ju nuk do të keni mundësinë se tani me humbjen e zgjedhjeve e keni kuptuar se nuk është ashtu edhe nuk bën të veprohet në atë mënyrë pasi edhe ju jeni qytetar njëjtë sikur unë dhe ne na ka ngarkuar dikush me mandat që mua më ka dhënë mandat ekzekutiv, kurse juve mandat përfaqësues. Por një përfaqësues dinjitoz që deri dje ka qenë kryesues i kuvendit, nuk duhet të veprojë ashtu siç ju flisni në këtë sallë të kuvendit, keni të drejtë t’i paraqitni problemet, si me ndriçim publik, kanalizim, trafo dhe me rrugët dhe nuk ka asgjë justifikime pasi ju shpjegova situatën, por meqenëse është kështu, atëherë e ftoj drejtorin e Shërbimeve Publike e gjithashtu edhe KEDS-in që në oborr të Defrim Kafexhiut ta dërgojë trafon dhe nëse e pengon, atëherë ne vazhdojmë dhe ky mund të bëjë padi. Kështu që ju kisha lutur që të keni kujdes herëve të tjera, të mos përdorni fjalë të pamenduara dhe fyese dhe meqenëse kjo pikë s’ka votim, e kisha lut kryesuesin që të kalojë në pikën e katërt të rendit të ditës.

Merisa Sharku – Përhëndetje për të gjithë! Kërkesat e vazhdueshme që tollovitë në rrugët e qytetit të mbarojnë para ardhjes së mërgimtarëve hasën në veshë të shurdhër apo thënë më mirë hasën në veshë të mosdëgjueshëm. Kështu që arnimi i rrugëve filloi pikërisht në fillimin e fluksit të mërgimtarëve për t’u uruar atyre mirëseardhje në mënyrën më të keqe të mundshme, ku pothuajse çdo rrugë ka qenë e prishur ose në punim e sipër. Problemet me infrastrukturë nuk mbarojnë këtu, ku pjesa më e madhe e lagjeve të qytetit të Rahovecit janë në terr dhe kërkesat e vazhdueshme edhe në këtë relacion, por për lagje specifike, hasi përsëri në veshë të shurdhër dhe kërkesat për t’u ndriçuar lagje specifike ngjallën kërkesa të shumta nga ana e qytetarëve dhe ankesa rreth ndriçimit pothuajse në shumicën e lagjeve të qytetit të Rahovecit dhe për ndriçimin e qytetit duhet të behet zgjidhje sa më e shpejtë.

Pra, çështja kryesore dhe aktuale në çdo bisedë sado të shkurtër me cilindo qytetar është sheshi në qendër të qytetit dhe jo që punët e tjera po bëhen në mënyrë të duhur. Ky projekt, me plot kuptimin e fjalës, është projekti më i dështuar i bërë në Rahovec dhe arsyet e tollovisë së deritanishme se akoma ka punime dhe sa herë kam bërë pyetje gjithmonë ka qenë arsyetimi se punimet po vazhdojnë dhe tani po shihet udhë pa krye dhe tollovia në atë pjesë si problem i pazgjidhshëm dhe zgjidhja e këtyre problemeve duhet të bëhet në mënyrë sa më të shpejtë.

Ilir Pallqa – Kam një pyetje të shkurtër sa i përket PZHK-së, se a kemi ndonjë informatë për çështjen e ridestinimit të pronave të *Stone castle*, pasi kemi informatë nga Ministria e Bujqësisë që ka gatishmëri e vullnet që të shtyhen përpara për shkak se është interes publik, dhe gjithashtu nga mbledhja që është mbajtur në Ministrinë e Infrastrukturës, kemi po ashtu informatë se janë duke shikuar mundësinë e zhbllokimit të kësaj çështjeje dhe po pritet që brenda disa ditëve të zhbllokohet kjo punë dhe gjithashtu uroj që edhe ju do të jeni konstruktiv në bisedime me krerët e ministrisë.

Albnor Mullabazi – Faleminderit kryesues, sa i përket Planit Zhvillimor Komunal nga muaji i katërt kur e kemi dorëzuar Planin Zhvillimor Komunal, komuna i ka përmbushur të gjitha obligimet që i ka pasur dhe gjithashtu e kemi përfshirë dhe kërkesën e *Stone castle* në pjesën ku ka qenë për këmbimin për stadium, por përgjigjja që ka ardhur nga Ministria e Bujqësisë, ku që tri jave është në Ministri të Planifikimit, mirëpo sot zyrtarisht ka ardhur edhe te ne dhe në vendimin që e kanë marrë, shkruhet se Ministria e Bujqësisë është përkushtuar në menaxhimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore, ku si prioritet e ka mbrojtjen e tokës bujqësore dhe gjithashtu e cek se duhet të harmonizohet me ligjin për mbrojtjen e tokave bujqësore, pra tokat që janë të klasifikuara prej klasës së parë deri në të katërtën dhe që nuk lejon shndërrimin e kësaj toke. Ndoshta ministri ka vullnet rreth kësaj, por komisioni që është formuar nuk ka dhënë vendim për shndërrimin e asaj toke. Ne jemi mbi 3 muaj duke biseduar me Ministrinë e Planifikimit dhe me shumë gjasë jemi të detyruar që ta tërheqim këtë pjesë dhe të vazhdojmë me Planin Zhvillimor, pasi edhe ashtu jemi shumë me vonesë, pasi tash do të ishte dashur që të jemi në diskutim publik për hartën zonale, mirëpo për shkak të kësaj pjesë, kemi më shumë se 3 muaj komentet që janë dorëzuar prej Ministrisë së Planifikimit, por kemi pritur komisionin e formuar prej Ministrisë së Bujqësisë dhe komisioni ka dalë me vendim që janë për mbrojtjen e tokave bujqësore sipas ligjit i cili është në fuqi.

Burim Krasniqi – Te rasti në Xërxë për zonë industriale që kemi diskutuar, që ka qenë komasacion ajo pjesa me gropa, a kanë kthyer ndonjë përgjigje rreth kësaj pasi ka pasur të bëhet një komision i përbashkët komuna me ministrinë, kështu që dua të di se çfarë informate kemi rreth asaj.

Albnor Mullabazi – Me atë pjesë jemi duke e formuar komisionin dhe ajo do të shkojë si zonë jashtë PZHK-së dhe më pas i bashkohet Planit Zhvillimor.

Kryetari – Sa i përket pyetjes së Merisa Sharkut, ka të drejtë sa i përket ndriçimit publik, ka të drejtë me bllokadën e krijuar, por nuk ka të drejtë në sheshin qendror, pasi sheshi ka sfida edhe është duke u bërë pasi edhe aty janë disa probleme që lidhen me shpronësim me pikën e karburantit dhe me lokalit Hardhia dhe ne jemi në pritje dhe po shpresojmë, gjithçka është në rregull nga ana jonë. Kurse, sa i përket sheshit në qendër, janë duke punuar në vendosjen e kabllave nëntokësore dhe menjëherë do të shtrohet shtresa e dytë e asfaltit dhe po besoj se do të jetë në rregull. Pastaj, te ndriçimi publik kemi pasur avari dhe jemi në pritje dhe nuk duam të harxhojmë buxhet për shkak se me kontratën e re ESCO, digjitalizimi nënkupton heqjen e të gjitha këtyre dritave dhe riparimin njëkohësisht edhe vendosjen e dritave digjitale. Pra nuk po kemi llogari që me kontratën e mirëmbajtjes të harxhojmë drita ku u ka skaduar afati. Pastaj çështja e mbulimit të gropave, kontrata është nënshkruar në ato ditë kur kanë filluar të vijnë mërgimtarët, pasi u vonua procedura dhe menjëherë me nënshkrimin e kontratës u bë plani i menaxhimit dhe menjëherë ka filluar mbulimi i gropave dhe po vazhdojnë edhe tash pasi kanë shkuar edhe pse për një kohë e kemi ndërprerë në pjesën qendrore nuk kemi mbuluar gropa si rruga “Ali Sokoli” që është premtuar se është kryer, pastaj në qendër janë kryer përgatitjet dhe po vazhdon me vendosjen e kabllave nëntokësore, si dhe me përgatitjen e shtresës së dytë dhe rregullimi i pusëve. Gjithashtu do të vazhdojmë edhe me mbulimin e gropave aty ku ka nevojë edhe mendoj se Rahoveci asnjëherë nuk ka pasur mërgimtarë më shumë se këtë vit dhe i keni parë mesazhet pozitive edhe nga ana ime edhe nga ana e të gjithëve. Pra, jemi duke punuar në qytet dhe vlera e investimeve në qytet është goxha e madhe dhe po shpresoj që pas 4 shtatorit, pra pos

Hardhfestit, do të bëjmë edhe disa angazhime të reja shtesë në disa rrugë në qytet në ndriçim publik edhe në rregullimin e qendrës dhe vazhdimin e rrugëve sipas kontratës që kemi me Ministrinë e Infrastrukturës për rrugët në qytet. Ndërsa, sa i përket PZHK-së, nuk mund të them asgjë derisa po presim deri të hënën që mund të ndërrojë ndonjë gjë në vendime politike të ministrave dhe sa u përket letrave nuk do të thotë që jemi të favorizuar, por mund të ketë ndonjë vendimmarrje politike e cila mund t'i ndryshojë këto letra, por njëherë tani nuk i kemi punët mirë me PZHK-në, përkundër faktit që pritëm mbi 3 muaj.

Kryesuesi – Atëherë, meqë nuk kemi pyetje dhe diskutime të tjera, kalojmë në pikën e radhës:

4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike P- 02302-0 Zona Kadastrale Rahovec me pronën e institucioneve qendrore P-02240-1, Zona Kadastrale Rahovec për interes publik.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë të kuvendit, drejtorë, të gjithë ju të pranishëm. Sipas ligjeve në fuqi, kryetari i Komunës ju propozon vendimin për të marrë pëlqim për këmbim të pronës komunale me pronë të institucionit qendror që menaxhohet nga Agjencioni pyjor, ku bëhet fjalë për 2 hektarë e gjysmë të cilat gjenden te Maja e Shkodranit prapa një fushe të këndit sportiv, ku atë sipërfaqe po e marrim prej Agjencionit pyjor prej menaxhimit dhe po i japim të njëjtën sipërfaqe në atë vlerë në zonën kadastrale të njëjtë në Rahovec, konkretisht parcela gjendet prapa basenit Shala, te pompa “Teuta”. Qëllimi i këtij këmbimi është se ka shumë kërkesa se në atë zonë te Maja e Shkodranit të zhvillohet turizmi, hapësirë për rekreacion dhe pjesë të tjera përbërëse. Ftoj anëtarët e kuvendit që të votojnë vendimin për marrjen e pëlqimit për këmbim të pronës komunale me pronë të Agjencionit pyjor të Kosovës.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues, drejtor, më la përshtypje dy raportet e komisioneve janë të panënshkruara prej një anëtari të komisionit, konkretisht prej gjeodetit, a është në pushim apo ka ndonjë arsye të caktuar.

Afrim Oruqi – Njëri prej anëtarëve të komisionit është jashtë vendit, pra në pushim dhe po kërkojmë falje që teknikisht nuk kemi mundur t'i bëjmë edhe katër raporte të tjera për shkak se shumica e këtyre anëtarëve kanë shkuar në pushime dhe janë jashtë vendit dhe po mundohemi që bashkërisht me sekretariatën dhe t'i përfundojnë, t'i nënshkruajnë dhe t'i përcjellin për MAPL për ligjshmëri, d.m.th. mungon nënshkrimi i njërit prej anëtarëve që është në pushime jashtë vendit.

Kryesuesi – Atëherë, meqë nuk kemi diskutime të tjera lidhur me këtë pikë, e kalojmë në votim. Me shumicë të votave kalon edhe kjo pikë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike P-05537-1, Zona Kadastrale Rahovec me pronën private P- 05539-0, Zona Kadastrale Rahovec, për interes publik.

Afrim Oruqi – Në mbështetje të ligjeve në fuqi, po propozoj që ju të merrni vendim që të këmbëjmë pronën private me pronë komunale, pasi dy parcelat janë në kufi njëra me tjetrën te rrethrotullimi, te pompa Shell, e cila është një parcelë private në emër të Muharrem Hajdës dhe një parcelë e cila është e komunës së Rahovecit, bëhet fjalë për 100 metra katror, e cila është një rrugë faktike që kalon për të dalë te varrezat dhe ne duam të bëjmë këtë rrugë me kadastrë dhe të njëjtën sipërfaqe pronarit privat që po i marrim pasi i kemi edhe vendimet për ligjshmëri që i kemi shpallur me interes të përgjithshëm në seancat e kaluara dhe po i japim pronarit në sipërfaqe të njëjte. Qëllimi i këmbimit të pronës është hapja e rrugës publike në interes të komunitetit. Ftoj anëtarët e kuvendit që të votojnë për propozim-vendimin për pëlqim për këmbim të pronës private me pronë komunale.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, atëherë, meqë nuk kemi diskutim për këtë pikë të rendit të ditës, e hedhim në votim. Me shumicë të votave, aprovohet edhe pika e pestë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike P-01505-0, Zona Kadastrale në Retijë me pronën e institucionit qendror P-0050-0, Zona Kadastrale Opterushë, për interes publik.

Erhan Morina - Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë të kuvendit, para jush keni propozim-vendimin e kryetarit për këmbimin e pronës komunale me atë të institucioneve qendrore, ku këmbëhet prona komunale me numër të certifikatës 01505-0 në Zonën Kadastrale në Retijë, me sipërfaqe 12,000 metra katror nga sipërfaqja e përgjithshme prej 279,608 metra katror dhe po ashtu i jepet Komunës së Rahovecit, pronë e cila menaxhohet nga Agjencioni pyjor, në sipërfaqe të njëjtë prej 12,000 metra katror, e cila gjendet në zonën kadastrale në Opterushë. Qëllimi i këmbimit të kësaj prone është me interes publik, përkatësisht funksionalizimi i zonës ekonomike apo të parkut industrial në Opterushë. Ftoj anëtarët e kuvendit që ta votojnë këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, atëherë, meqë nuk kemi diskutim për këtë pikë të rendit të ditës, e hedhim në votim. Me shumicë të votave nga anëtarët e Kuvendit kalon edhe kjo pikë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e radhës:

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike P-01505-0, Zona Kadastrale Retijë, me pronën e institucionit qendror P-01987-0, Zona Kadastrale Opterushë, për interes publik.

Erhan Morina – Faleminderit kryesues, para jush keni propozim-vendimin e kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës komunale me atë të Agjencionit të ujërave dhe bëhet fjalë për një parcelë e cila gjendet në zonën kadastrale në Retijë, me numër të P-01505-0, Zona Kadastrale Retijë, me sipërfaqe 650 metra katror dhe po ashtu i jepet Komunës së Rahovecit, pronë e cila menaxhohet nga Agjencioni i ujërave, me numër të certifikatës 01987-0, në zonën kadastrale në Opterushë. Qëllimi i këmbimit të kësaj prone është me interes publik, përkatësisht funksionalizimi i parkut industrial në Opterushë. Ftoj anëtarët e Kuvendit që të votojnë këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, atëherë, meqë nuk kemi diskutime të tjera lidhur me këtë pikë, e hedhim në votim. Me shumicë të votave aprovohet edhe pika e shtatë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronave publike P-01313-1,01313-2,01313-4,01313-5, Zona Kadastrale Rahovec me pronën private P-01313-3, Zona Kadastrale Rahovec, për interes publik.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, bëhet fjalë për Zonën Kadastrale Rahovec për parcelën private e cila është në posedim të Tasim dhe Hajrullah Dulës P-1313-3, ku sipërfaqja e përgjithshme e këmbimit të kësaj parcele me parcelat e pronave komunale janë 4 parcela që implikohen për të arritur sipërfaqen e njëjtë dhe po provojmë ta arrijmë qëllimin e njëjtë si e kemi bërë edhe më herët që na është kthyer e kundërligjshme për shkak se kjo e drejtë është e drejtë që garantohet me hartë zonale, ku prek parcelat 1313-5,1313-4,1313-2,1313-1, që të arrihet sipërfaqe e njëjtë prej 4 ari e 46 metra katror dhe që të gjitha janë në kufij njëra me tjetrën dhe janë të barasvlershme. Qëllimi i këtij këmbimi është që të funksionalizojmë vazhdimin e implementimit të projektit Sheshi qendror i qytetit. Ftoj anëtarët e kuvendit që të votojnë vendimin për pëlqim për këmbim të pronës komunale me pronë private në emër të pronarëve të përmendur më lart.

Burim Krasniqi – Meqenëse këto parcela janë te pjesa e sheshit qendror që po bëhet në qytetin e Rahovecit, a ju garantohet edhe qasja e rrugës në parcelën që do të bëhet shkëmbimi dhe si qëndron problematika me këta.

Afrim Oruqi – Këta pronarë, kur Komuna ka funksionuar ndryshe dhe ka marrë vendim bordi i Komunës së Rahovecit, i ka dhënë të drejtën e kalimit nëpër këto parcela në gjerësi prej 4 metra, d.m.th. që këta pronarë privat gëzojnë të drejtën e servitutit nëpër parcela komunale dhe ne në skicë e kemi prezent këtu, pasi ka një rrugë që do të jetë që të kenë këta qasje të dalin te rruga që tash është njëkahëshe që kalon në drejtim të parkingut që po bëhet aktualisht, d.m.th. se ekziston rruga, pasi e kanë gëzuar edhe ligjërisht më herët dhe ne këtë e kemi menduar dhe e kemi lënë rrugë për nevoja të komunitetit të atyre banorëve që jetojnë në atë zonë.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, meqë nuk kemi ndonjë diskutim tjetër, e kalojmë në votim këtë pikë të rendit të ditës. Me shumicë të votave kalon edhe kjo pikë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike P-01015-1, Zona Kadastrale Xërxë, me pronën private P-01015-12, Zona Kadastrale Xërxë, për interes publik.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, bëhet fjalë, për zonë kadastrale në Xërxë, ku parcela private me parcelën komunale është në kufij njëra me tjetrën, për një sipërfaqe prej 134 metra dhe atje në terrene me vite është rrugë faktike e kalueshme dhe e kubëzuar prej komunës, me kërkesë dhe pëlqim të pronarit privat dhe në fillimisht, bashkë me juve, kemi shpallur me interes të përgjithshëm dhe sot po kërkojmë prej juve që të marrim vendim për t'i këmbyer këto parcela dhe të bëjmë rrugë zyrtarisht edhe atje që pala mos të kërkojë të drejtat e veta përmes institucioneve gjyqësore që do t'i kushtonte shumë më tepër Komunës së Rahovecit. Ftoj anëtarët e Kuvendit që të votojnë pëlqimin për këmbim të pronës komunale me pronë private për interes të përgjithshëm hapje e rrugës publike apo zgjerimi i rrugës publike.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, meqë nuk kemi diskutime të tjera për këtë pikë, e hedhim në votim. Me shumicë të votave nga anëtarët e Kuvendit, aprovohet edhe pika nëntë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

6. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2022.

Afrim Limani – Përshëndetje kryesues, kryetar, nënkryetar, asamblistë dhe të gjithë të pranishmit. Auditimi i pasqyrave financiare të Komunës së Rahovecit për vitin 2022 ka rezultuar i pamodifikuar dhe nga ky auditim, siç e dini edhe ju janë prodhuar 9 rekomandime, ku 4 janë të reja dhe 5 të përsëritura. Në raport me ligjet e ZKA-së, brenda afatit ligjor, si qeveri komunale e kemi formuar një komision për zbatimin e rekomandimeve dhe atë dokument planin e veprimit e kemi dërguar me kohë në ZKA, ku deri më tash e kemi mbajtur dhe besoj që deri në fund të vitit t'i mbajmë edhe 3-4 takime të tjera dhe në bazë të këtyre rekomandimeve të cilat janë të përshkruara në raport, 70-80% të këtyre rekomandimeve do të zbatohen, mirëpo ka edhe ndonjë tjetër që është në proces, por jo të pazbatueshme. Dhe për mendimin tim, këto rekomandime janë më lehtë të zbatueshme në raport me auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Rahovecit për vitin 2021, pasi i kemi pasur 14 rekomandime, ku 10 prej tyre janë të zbatueshme dhe 4 të tjera jo të zbatueshme.

Burim Krasniqi - E kam parë raportin apo Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, por është diçka që prej 9 rekomandimeve, prej tyre 4 apo 5 janë, do të zbatohen, nëse jo plotësisht, pjesërisht, që të lë të kuptosh se prapë këto rekomandime mund të përsëriten vitin tjetër. Po ashtu te çështja B3, te veprimet e planifikuara për t'u ndërmarrë, nuk ka asgjë dhe nuk figuron asgjë, pra garancioni i punimeve jo në afatin e duhur te pjesa e veprimeve që planifikohen për të ndërmarrë, nuk ka asnjë shpjegim.

Afrim Limani – Siç u deklarova në fillim se 70-80% të rekomandimeve besojmë se do të realizohen plotësisht, kurse pjesa tjetër pjesërisht, për shkak të afatit të caktuar kohor, atëherë një rekomandim nuk mund ta zbatojmë plotësisht, pasi kërkohet kohë d.m.th. edhe fillimi i vitit tjetër fiskal, p.sh. ne kemi filluar ta zbatojmë këtë rekomandim, zotimi dhe urdhërblerja e mjeteve para se të dorëzohet fatura dhe jemi në gjysmë të vitit fiskal dhe kemi filluar menjëherë së vepruari, mirëpo nuk mund të themi se ky rekomandim do të realizohet plotësisht, kështu që e lamë pjesërisht edhe vitin tjetër në proces dhe besoj që edhe ky rekomandim do të zbatohet. Te çështja B3, ai rekomandim tash veç është i zbatuar, pasi aty ka ndodhur një gabim teknik që na ka ikur, pasi fjala është për anëtarët e komisionit që nuk guxojnë të jenë nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa e sidomos të gjithë nëpunësit që janë të certifikuar për ekzekutimin e pagesave. Dhe ne kemi vepruar menjëherë, në vendimin e ri të komisionit, nuk kemi futur anëtar.

Burim Krasniqi – A3 e keni ndarje jo e duhur e detyrave, kurse B3 e keni garancionin e punimeve jo në afatin e duhur.

Afrim Limani – Pra B3 na ka ikur për çështje teknike, mirëpo edhe ky rekomandim do të zbatohet në kuadër të këtij viti fiskal.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për përfshirjen e komunitetit rom dhe ashkali për vitin 2023-2025.

Lendrit Qeli – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendit dhe të gjithë ju të pranishëm. Para jush po prezantoj Planin e veprimit për përfshirjen e komunitetit rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare, gjegjësisht në Komunën e Rahovecit për periudhën 2023-2025. Ky plan i veprimit ka për qëllim përfshirjen e komuniteteve në fjalë, në vazhdimësi të politikave të Qeverisë së Republikës së Kosovës, gjegjësisht në kuadër të strategjisë për përfshirje të komunitetit rom dhe ashkali për periudhën 2022-2026, për të

cilën përmban 5 komponenta, siç është arsimi, punësimi dhe mirëqenia sociale, shëndetësia, banimi dhe diskriminimi. Po besoj që edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa e kemi sqaruar pak më në detaje dhe për koston që ka ky plan i veprimit. Kështu që ftoj të gjithë anëtarët e Kuvendit për miratim.

Sejfullah Sejfullahu – Faleminderit kryesues, e kam lexuar detajisht planin disa here dhe nuk po them se nuk e kam kuptuar apo në Komitetin për Politikë dhe Financa e keni sqaruar më tepër, por si qytetar i Krushës së Madhe i pashë dhe më pëlqyen shumë, por privilegjet që ishin të punësimi, shkollimi, mirëqenia sociale, pasi ka shumë familje që kanë pësuar në luftë dhe në Krushë të Madhe kemi 14 persona që janë vrarë nga komuniteti rom dhe ashkali. Kështu që pse nuk është futur edhe ky kriter, apo si bazë të përfshihet pasi edhe për komunitetet e tjera kemi përfshirë, pra do të ishte mirë të përfshihej edhe ky kriter.

Lendrit Qeli – Sa i përket pyetjes, duke marrë parasysh se Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar këtë strategji dhe ne jemi të detyruar që në bazë të derivimit të krijojmë Planin e veprimit, pasi komponentët nuk guxojnë të ndryshohen sepse kemi pasur edhe vërejtjet tona pasi në këtë strategji nuk është përfshirë edhe komuniteti egjiptian, kështu që nuk është diçka që varet nga ne, pasi në njëfarë mënyre jemi të detyruar ta krijojmë këtë plan veprimi në bazë të strategjisë që e ka krijuar Qeveria, kështu që ndryshimet nuk kanë mundur të bëhen dhe po shpresojmë që në strategjitë e ardhshme do ta kenë parasysh edhe këtë.

Burim Krasniqi – I nderuar z. Qeli, ne e biseduam edhe pak më herët bashkë për shkak të pyetjeve që i kam pasur në KPF, por kur e shikoj dokumentin, ka një kosto financiare që, në një formë, apo tjetrën, është vështirë e mbulueshme për buxhetin që e keni ju si Zyrë për komunitete. A është diskutuar në nivelin qendror kjo çështje edhe në tabelën që japin planin e veprimit, askund nuk e keni paraparë rrezikun e mosrealizimit të projekteve, kur ka parasysh se ka kosto financiare, parashihet te tabela 1 kostoja financiare 5000 euro prej donatoreve dhe kjo krijon një rrezik të implementimit të kësaj pike, nëse nuk ka donatorë, d.m.th. një kolonë që i parasheh rreziqet në tabelë, nuk më ka rastisur të shoh ndonjëherë, kështu që kërkoj mirëkuptimin që pa dashur të tentoj të shtyhet për një seancë të radhës, ky dokument të plotësohet edhe në kolonën e rreziqeve se cilat prej projekteve apo aktiviteteve nuk mund të bëhen, që në njëfarë forme e zbehin edhe arritjen e objektivit duke pasur parasysh se mund të ketë vështirësi në gjetjen e fondeve për zbatimin e këtij dokumenti.

Lendrit Qeli – Sa për sqarim, strategjia në nivel qendror ka një kosto milionësh, por fatkeqësisht prej vitit 2006 e tutje asnjëherë nuk është implementuar në mënyrën më të mirë të mundshme edhe mund të themi se kjo është njëra prej strategjive që asnjëherë nuk është zbatuar në mënyrën më të mirë të mundshme, pasi qeveria vetë e harton dhe vetë dështon dhe në njëfarë mënyre po na bie barrë neve komunave si patate e nxehtë, në kuptimin e implementimit. Ne, si Komunë, është e vërtetë se kemi një buxhet të vogël, gjegjësisht Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, por në kuadër të kësaj strategjie, gjegjësisht planit, ne kemi planifikuar takim edhe në një konferencë të donatorëve për të cilën kemi marrë edhe një dritë të gjelbër edhe prej korit diplomatik në Kosovë, gjegjësisht prej ambasadës kanadeze dhe po shpresojmë që do ta kemi sa më shpejt.

Sejfullah Sejfullahu – Siç e kuptova, edhe ky është dëmtuar si Zyrë Komunale për Komunitete dhe Kthim, por nuk më pëlqen fakti pasi është strategji jo vetëm e kësaj qeverie, por e shume qeverive të mëparshme, unë mendoj që duhet të bëhen disa ndryshime dhe të dërgohen disa vërejtje dhe do të ishte mirë të ketë një konsideratë rreth kësaj si kërkesë, pasi sakrifica e atyre 14 personave, prej 241 krushjanëve, është me të vërtetë e barabartë dhe nuk kisha dashur të diskriminohet, por përkundrazi të privilegjohej dhe t'u tregohet se 4 anëtarë, pra babai me tre vëllezër të tjerë kanë qenë anëtarë të ansamblit. Pra, do të ishte mirë që të përmbushet, apo të ketë ndonjë aneks se çka mund të bëhet nga Komuna në këtë strategji, apo nëse është nevojë edhe t'i kthehet.

Kryetari – Unë e kuptova drejt edhe Sefën edhe Burimin, gjithashtu Lendriti i dha shpjegimet e veta dhe sigurisht se strategjia është shtetërore dhe pastaj derivojnë produktet që bëhen edhe miratohen në kuvendet komunale. Besoj që Zyrën Komunale për komunitete dhe kthim, pavarësisht që nuk e kanë përfshirë hiq komunitetin egjiptian e që realisht i takon pasi shefi i Zyrës është i atij komuniteti por unë besoj që me drejtorin e Financave dhe si ekzekutiv nuk e kemi lënë asnjëherë për sa i takon përmbushjes së objektivave të projekteve që janë në interes të komunitetit dhe vazhdimisht do ta përkrahim edhe pse buxheti i Zyrës nuk është i mjaftueshëm dhe ne jo rrallë kemi ndërhyrë qoftë me letra motivuese apo nënshkrim memorandumesh apo participim nga fondi i përbashkët për financim që

e kemi në Drejtorinë e Financave, apo me memorandumet me ministritë e linjës për t'i kryer projektet, pasi nëse e lëmë buxhetin e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, atëherë asgjë nuk mund të përmbushë pasi janë vetëm 30,000 euro. Po ashtu respekt e mirënjohje për martirët nga Celina, Krusha e Madhe e posaçërisht nga komuniteti egjiptian që jashtëzakonisht ka qenë aktiv dhe me qëndrim mbështetës dhe të drejtë ndaj problemeve që i ka pasur shumica e popullsisë këtu e ka shumë prej tyre që janë viktimë, martirë, si në Krushë të Madhe, Celinë, apo edhe në ndonjë vend tjetër dhe ndaj tyre ushqejmë respekt dhe mirënjohje dhe gjithashtu i kemi parasysh çdo herë edhe kërkesat e tyre edhe në strategjinë apo qasjen tonë në vazhdimisht e kemi si komunitet.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar, atëherë meqë nuk kemi diskutime të tjera, e hedhim në votim. Me shumicë të votave, aprovohet edhe kjo pikë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

8. Shqyrtimi i Draft statutit të Ansamblit të Komunes së Rahovecit.

Afrim Dina – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, anëtarë të Kuvendit dhe të gjithë të pranishmit. Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të ligjit Nr.03/L 040 për vetëqeverisjen lokale, të nenit 5, paragrafi 2, i ligjit Nr. 04/L164 për Ansamblin kombëtar të këngëve dhe të valleve dhe ansambleve të tjera, si dhe statutit të komunës së Rahovecit për themelimin e ansambleve komunale. Me caktimin e grupit punues nga kryetari i komunës për hartimin e statutit të ansamblit komunal të këngëve dhe valleve në Rahovec, të datës 04.04 .2023, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, ka filluar punimet dhe ka hartuar draft-statutin e Komunës së Rahovecit. Anëtarët e grupit punues janë 13, si: Afrim Dina, Qemajl Krasniqi, Naser Dula, Muharrem Morina, Saranda Rama, Sylejman Kryeziu, Fiknete Kasapi-Iska, Bledar Zhuniqi, Fjolla Duraku, Fatmir Sejfullahu, Vjollca Gurgule, Armend Mullaavda, Adelina Paçarizi, të cilët kanë qenë anëtarë të Grupit punues, të cilët kanë mbajtur takime të rregullta dhe duke u bazuar në ligjin për themelimin të ansambleve, të cilat sipas ligjit janë ansamble publike dhe ansamble private. Ansamblet publike apo institucionale janë një, kurse ansamble private mund të jenë disa ansamble të cilat në statutet e tyre mund të ndërrojnë nga shoqëritë kulturore artistike dhe të kalojnë në ansamble të cilat i plotësojnë kriteret në MAPL dhe në Ministrinë e Kulturës. Ansambli i Komunës së Rahovecit është institucion i cili themelohet nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit dhe ka si objekt veprimtarinë dhe zhvillimin e artit skenik, ruajtjen e trashëgimisë kulturore, pastaj kultivimin dhe ruajtjen e vlerave kombëtare brenda dhe jashtë vendit. Në këtë statut përkufizohet funksionimi i veprimtarisë së Ansamblit të këngëve dhe valleve të Komunës së Rahovecit, të cilin e keni në nenin 1 të Draft-statuti i Komunës. Ansambli i Komunës ka strukturën organizative e cila përbëhet nga këshilli drejtues që duhet t'i ketë anëtar drejtorin, këshillin artistik dhe udhëheqësin artistik. E keni në material Draft-statutin dhe ndoshta nuk keni mbërri ta lexoni të tërin, por nëse ka nevojë unë do t'i them të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë që do t'i ketë Ansambli Komunal i Rahovecit. Veprimtaria e Ansamblit Komunal bën mbledhjen, konservimin dhe arkivimin e lëndës muzikore të traditës shpirtërore, materiale e popullore, si dhe nxitjen, zhvillimin, publikimin dhe promovimin e artit kombëtar. Atëherë ftoj anëtarët e kuvendit që, pas shqyrtimit, të votojnë për këtë pikë të rendit të ditës.

Leonard Morina – Tek neni i 8-të po thotë Këshilli drejtues përbëhet prej 5 anëtarëve me mandat katër-vjeçar dhe preferohet të jetë profesionist i fushës dhe une mendoj se duhet të jetë jo të preferohet edhe të mos ketë njerz që nuk janë të fushës së artit, pra të neni 8.1, kurse të neni 8.2 thotë se Këshillin drejtues e emëron dhe e mbikëqyr kryetari i Komunës, pastaj në nenin 8.3 thotë se njëri nga anëtarët e Këshillit drejtues duhet të jetë i emëruar nga kryetari i deleguar nga ekzekutivi dhe 8.4 thotë se kryetari i Këshillit drejtues zgjidhet nga 5 anëtarë dhe kjo i bie që krejt kryetari i Komunës të bën përzgjedhjen dhe a do të kishte pasur mundësi që vetëm njëri të jetë i emëruar nga kryetari, kurse këta të tjerët nga asambleja të votohen.

Faton Ramadanin – Pajtohem plotësisht me parafolësin, pasi këshilli drejtues nuk duhet të zgjidhet nga kryetari, por të zgjidhen me konkurs dhe pra 2 anëtarë nga ekzekutivi dhe 3 nga kuvendi edhe zgjedhin Këshillin drejtues e më pas nga Këshilli drejtues ata vetë zgjidhen.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues, për ta plotësuar edhe Fatonin, edhe si LDK po propozojmë që Asambleja komunale të caktojë një komision, i cili të zgjedh Këshillin drejtues përmes një konkursi dhe pika 8.2 e nenit 8 të ndryshohet edhe të jetë: Këshilli drejtues zgjidhet nga një komision i caktuar nga asambleja komunale,

ku në përbërjen e komisionit mund të jetë që 4 i cakton asambleja, kurse një e delegon ekzekutivi apo 3 asambleja dhe 2 ekzekutivi, sikurse që ishin praktikat për përzgjedhjen e rasteve të tjera. Pra, propozimi është që Këshilli drejtues të zgjidhet nga një komision i caktuar dhe i votuar nga Asambleja komunale dhe komisioni për përzgjedhjen e këshillit drejtues përbëhet 3 nga Asambleja komunale dhe 1 nga ekzekutivi dhe një OJQ, sipas praktikave që kemi pasur me herët.

Afrim Dina – Ne jemi bazuar edhe në themelimet e statuteve të Ansambleve të komunave të tjera si komuna e Deçanit pastaj e Obiliqit, që janë bazuar në ligjin për themelimin e ansambleve. Te diskutimi i Leoanrd Morinës që tha te Këshilli drejtues i ansamblit, ku anëtarët e Këshillit drejtues janë 5 me mandat 4-vjeçar pasi mandati i ansamblit është edhe mandat institucional të cilët veprojnë sipas ligjit për themelimin, që i kemi. Kurse te pika 8.2, edhe në komunat e tjera është e njëjta, d.m.th. se kjo është arsye pasi ende është draft-statut dhe këshillin drejtues e emëron dhe e mbikëqyr kryetari i Komunës së Rahovecit. Kurse te drejtori, ku e keni në pikën më lart, zgjidhet me konkurs publik, pra është neni 6 ku përcakton qartë zgjedhjen e drejtorit përmes konkursit publik. Sa i përket që duhet të jetë i profesionit mirëpo mund të ndodhë që nuk ekziston tamam profesional dhe të përzgjidhet i përafërt i profesionit, mirëpo duhet patjetër të jenë profesionalë të fushës. Pastaj te pjesa e Fatonit, që propozoi se ndoshta do të ishte më mirë, mirëpo unë po besoj që si draft që e kemi sjellë, jemi munduar ta kryejmë punën tonë dhe e kemi parë të arsyeshme të jetë kështu, por meqenëse jemi në kuvend, atëherë sigurisht se kuvendi ka propozimet e veta. Te udhëheqësit e këshillit artistik të ansamblit që, përveç këshillit artistik, pastaj e ka koreografin, koperatorin, përgjegjësin e seksionit të solistëve vokal, përgjegjësin e seksionit të orkestrës, të cilët të gjithë duhet t'i kenë përgjegjësitë dhe kompetencat që do të japin llogaritë e veta që duhet të kenë një bashkëpunim të mirëfilltë me DKRS-në dhe me kryetarin e Komunës së bashku me ekzekutiv.

Hasan Përboqi – Faleminderit drejtor edhe komplet grupi punues që është marrë për hartimin e këtij draft-statuti për themelimin e ansamblit të Komunës së Rahovecit, konsiderojmë se është një dokument mirë i përgatitur edhe në një të ardhme mund të ketë edhe diçka të re, atëherë mund të bëhen plotësime-ndryshime dhe desha të ndalem lidhur me pikën që është diskutuar edhe nga kolegu Faton, pasi diskutimi dhe propozimi i tij mund të jetë me vend, por pastaj unë konsideroj se mbikëqyrja e Këshillit drejtues do të ishte shumë problem, pasi Këshilli drejtues, kur ngarkohet apo emërohet nga kryetari i Komunës, atëherë ata janë të detyruar sipas ligjit t'i raportojnë kryetarit dhe drejtorit, përkatësisht drejtorisë. Nëse këshilli drejtues emërohet nga Kuvendi komunal, atëherë mbikëqyrja dhe raportimi i tyre nuk besoj që do të ishte në një nivel shumë të mirë në krahasim me propozimin që e kemi tani në draft-statut. Pra, mbikëqyrja dhe raportimi do të ishte me nivel ashtu siç ka ardhur në propozim që të emërohet nga kryetari i Komunës dhe konsideroj që më shumë i kishte kontribuar këtij statuti që të mbetet kështu siç është në propozim, pra Këshilli drejtues të emërohet dhe të mbikëqyret nga ana e kryetarit të Komunës.

Sejfullah Sejfullahu – desha vetëm si sqarim te pika 8.2 dhe 8.3, edhe janë të njëjta gjithashtu edhe po gërshetohen mes vete pasi Këshillin drejtues e emëron dhe e mbikëqyr kryetari i Komunës së Rahovecit dhe menjëherë në pikën 8.3 thotë se njëri nga anëtarët e Këshillit drejtues duhet të jetë i emëruar nga kryetari, pra në pikën tjetër thotë të gjithë, kurse në këtë tjetrën thotë një. Pastaj tjetra që më bën përshtypje, të gjitha këto burokraci se Këshilli drejtues, Këshilli artistik, sa i përket pagesës është paraparë, mirëpo askund në këtë strategji nuk është përfshirë se si të mblidhen anëtarët, të motivohen të rinjtë, pastaj të krijohen grupet e instrumentalistëve dhe do të ishte mirë të parashihen edhe këto gjera dhe gjithashtu të pyetemi edhe ne pasi Fatmiri nuk ka mundur të marrë pjesë në takimet që ka pasur Komisioni, pasi do të kisha ardhur unë personalisht që të kisha mundësi të jepja kontribut në këtë drejtim. Pra do të ishte mirë që të parashihen edhe këto, pasi mendoj se nuk është bash e njëjtë me të Deçanit e pikërisht në këto dy pika ka dallime.

Burim Krasniqi – Faktikisht propozimi ynë para se të vendoset në votim, është që pika 8.2, Këshilli drejtues zgjidhet përmes konkursit nga një komision prej 5 anëtarëve, ku 3 anëtarë zgjidhen nga asambleja, një nga shoqëria civile dhe një nga ekzekutivi dhe mbikëqyret nga kryetari i Komunës së Rahovecit, pastaj pika 8.3 mbetet e njëjta, që në Këshill drejtues, një anëtar e dërgon kryetari, kurse 4 anëtarë i zgjedh komisioni. Pra, jemi që pikës 8.2 t'i shtohet propozimi ynë.

Kryetari – Unë po besoj që edhe mund të ketë situata të cilat edhe mund të diskutohen, por po besoj që grupi punues, prej 13 anëtarëve ka pasur mundësi t’i shohë dhe modelet e projekt-statuteve edhe të komunave të tjera dhe sigurisht se është diskutuar sa i përket këtyre çështjeve në Grup punues e gjithashtu ka kaluar edhe në shqyrtim publik dhe që propozimin që e dha Burimi nuk do të thotë që e dëmton diçka edhe sigurisht se nuk jam kundër, por ideja është që në statut nuk përcaktohen apo nuk parashihen se si do të mobilizohen anëtarët e një ansambli, pasi është dokument që i përcakton të drejtat e funksionimit, detyrimet, përgjegjësitë e secilit anëtar të ansamblit dhe gjithashtu jam për ta pranuar ndryshim-plotësimin pasi mund të ketë edhe lëshime teknike pasi e shoh që në pikën 8.4 ka një kontradiktë që nuk shkon e gjithashtu edhe pika 8.2 dhe 8.3. Kështu që jam për ta hedhur në votim këtë projekt-statut me këto paqartësi që i tha Burimi dhe Sefa dhe të harmonizohet pasi ka një ligj për ansambël që te mos bie ndesh me ligjin, por ajo që është dëshpëruese kushdo që zgjidhet anëtar nuk do të paguhet njëherë pasi do të jetë një proces i gjatë, po shpresojmë që shumë shpejt do të aktivizohet që me ndonjë ndihmë eventuale me subvencione të komunës pasi e shoh që në qarkoren e dytë buxhetore ka ndonjë mundësi, edhe pse ansambli bëhet me ligj dhe e parashihet ligji edhe pse do të ishte mirë të jetë e parashikuar në qarkoren e dytë që t’i sigurohen dhe nga 5 apo 6 vende ansamblit, por kjo sigurisht se do të marrë edhe një kohë, duke pasur parasysh edhe ansamblet e Deçanit apo të Obiliqit që moti janë krijuar edhe plot komuna të tjera, por vetëm Ansambli shtetëror “Shota”, krejt vonë pas luftës e ka zgjidhur problemin, sepse kjo çështje nuk është thjesht pasi duhet të futen në listën e pagave dhe të sigurohen kuotat. Mirëpo sido që të jetë, jam shumë i kënaqur që hapat e parë ligjor për themelimin e ansamblit i kemi vendosur në kuvend në vendimin e mëhershëm dhe tash projektstatuti është një dokument që e rregullon se si duhet të funksionojë një ansambël i konsoliduar dhe jam dakord që të adresohen këto shqetësime që i paraqiti Burimi dhe jam që ta hedhim në votim me ato vërejtje.

Sejfullah Sejfullahu – Këshilli artistik i ka përgjegjësitë dhe përputhet me statutin edhe të Obiliqit edhe të Deçanit, por nuk ishte e cekur aty që Këshilli drejtues e bën selektimin, pranimin dhe vlerësimin e anëtarëve, për mbledhjen e instrumentalistëve, të valltarëve.

Kryetari – Edhe njëherë e them që me propozimin e Burimit, por edhe me vërejtjet që ka Sefa, në harmonizim me Zyrën ligjore, sidoqoftë unë jam shumë i kënaqur që kemi mbërri te një projektstatut pasi edhe Ansambli “Bajram Curri” nga Krusha e Madhe ka një rrugëtim tjetër që do të përkrahet vazhdimisht për shkak të traditës që ta mbajmë gjallë, ta forcojmë dhe ta begatojmë, kurse ansambli ligjor komunal është një nivel tjetër ligjor dhe jam i interesuar që, në bashkëpunim me ministrin e Financave të sigurojmë kuota dhe të respektohet ky statut dhe u konsolidua Ansambli i këngëve dhe i valleve “Rahoveci”. Pra, propozoj që të hidhet në votim me propozimet e Burim Krasniqit dhe vërejtjet e Sefës, të precizohet.

Kryesuesi – Atëherë, meqë nuk kemi diskutime të tjera, e kalojmë në votim. Me propozimet dhe vërejtjet që u diskutuan, aprovohet me shumicë të votave. Kalojmë në pikën e radhës:

9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore për fondacionin “Adrian Orllati”, sipas kërkesës Nr. Protokolli 1232004, të datës 20.9.2023, për ndërtimin e objektit P+4.

Albnor Mullabazi – Faleminderit kryesues, para jush keni vendimin për dhënien e lejes për kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore, me kërkesë të fondacionit “Adrian Orllati”, ku kërkesa ka ardhur në Drejtorinë e Urbanizmit për ndërtimin e objektit P+4. Me ligjet që kemi në fuqi, ne mund të lëshojmë kushte për leje vetëm P+2. Objekti është me sipërfaqe 2550 metra katror dhe në objekt po ndërtohen 37 apartamente për të moshuarit, ku përveç apartamenteve për të moshuar do të ndërtohen edhe banesat për banorët që janë duke banuar dhe po kësaj banorët që janë duke banuar aty, do të kenë 10% më shumë të sipërfaqes se sa që e kanë tani në gjendjen aktuale. Kështu që kërkoj nga anëtarët e Kuvendit që të votoni vendimin për dhënien e lejes për kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore.

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues, në emër të grupit të asambleistëve të LDK-së, e përkrahim këtë propozim-vendim, pasi edhe në seancat paraprake e kemi përkrahur një vendim të tillë, për shkak të veprës për të cilën është duke u financuar dhe po bën ky fondacion bamirës, e përkrahim si grup i LDK-së.

Ilir Pallqa – Kam një pyetje se mos veprojmë në bazë të planit të PZHK-së që është në fuqi dhe mund të krijojmë precedent pastaj, mirëpo pasi nuk qenka ashtu, atëherë në rregull jemi. Por, pasi të miratohet PZHK-ja, a do të kemi të drejtë si institucion, si kuvend të japim prapë leje në këtë formë, vetëm si pyetje e kisha.

Kryetari – Mund të ju them se PZHK-së së vjetër i ka skaduar afati dhe PZHK-ja e re ende nuk është në fuqi dhe sigurisht se harta zonale do të përcaktojë etazhitetin dhe meqë jemi larg kësaj dhe meqë është projekt bamirësie dhe humanizëm krejtësisht, ne nuk bëjmë precedent pasi nuk është PZHK-ja e vjetër në fuqi dhe ndërkohë jemi në pritje të PZHK-së së re dhe deri sa të vije harta zonale ne nuk mund të presim. Po ashtu shpresojmë që nuk do të kemi raste të reja ndërmjet kësaj periudhe, por nëse shkon ashtu siç duhet dhe i shkon mirë Komunës, atëherë sigurisht se votojmë për ndonjë rast tjetër, por në këtë rast, që të mos vonohemi, pasi ndoshta edhe 4 muaj nuk do të bëhet PHZK-ja, por tani sigurisht se lejohet, që mos të vonohemi deri atëherë, ju ftoj që ta kemi në konsideratë, ashtu siç veproi LDK-ja, të veprojmë të gjithë unanimisht, ashtu siç e kemi marrë vendimin bashkërisht, ta marrim edhe tani në votim.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar, atëherë, meqë nuk kemi diskutime të tjera, e hedhim në votim. Me shumicë të votave, aprovohet edhe kjo pikë e rendit të ditës. Kalojmë edhe në piken e fundit të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.264/22, i datës

25.01.2022, për themelimin e Komitetit për Komunitete, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin

01 Nr.414/22, të datës 28.12.2022

Burim Krasniqi – Meqë ishte kërkesë e grupit të LDK-së, po e jap arsyetimin e shkurtër, ku faktikisht, për shkak të ndryshimit të rrethanave në funksionimin e Asamblesë komunale, grupi i LDK-së ka rekomanduar që të bëhet ky plotësim-ndryshim dhe si i tillë, anëtarja e Komitetit për Komunitete, zonja Edona Kryeziu, të tërhiqet nga ky komitet dhe njëherit i hap rrugë grupit të asambleistëve, që i takon në bazë të ndarjes së këtyre pozitave, të propozojë përfaqësuesin apo anëtarin për Komitetin për Komunitete.

Leonard Morina – Ne, si grup i VV-së, si propozim e kemi Merisa Sharkun.

Kryesuesi – Atëherë, me këtë përbërje, e hedhim në votim. Me shumicë të votave, aprovohet edhe kjo pikë e rendit të ditës dhe duke ju falënderuar për durimin dhe kohen, ju ftoj që t'i bashkëngjitemi festës së Hardhfestit, apo Festes së Vjeljes së Rrushit, më datë 1, 2 dhe 3 shtator. Faleminderit dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

Procesmbajtësi:

Agim Hoti

K R Y E S U E S I

Arbër Zenuni



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec



01 Nr. 09/23
Rahovec, 18.9.2023

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal që të marrin pjesë në mbledhjen e nëntë (9), e cila do të mbahet më **26 shtator 2023 (e martë)**, me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje, propozoj këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelën P-01035-0, në Zonën Kadastrale Xërxë;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e Pëlqimit për këmbimin e pronës publike komunale P-02302-0, me pronën e institucionit qendror P- 02240-1, për interes publik ZK-Rahovec;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ridestininim të mjeteve;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e buxhetit për vitin 2024;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së Komunës së Rahovecit P-00266-0, ZK- Hoçë e Madhe;
8. Informatë nga DKA-ja për përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2023/2024;
9. Informatë për muajin e mërgimtarëve prej 15 korrikut, deri më 15 gusht 2023.

KRYESUES I KUVENDIT

Arbër Zenuni



Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), nenit 14, nenit 17 dhe nenit 40, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (*"Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"*), nenit 19, paragrafi 3, pika 3.1 dhe 3.2, të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (*"Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 10/2019*), konform nenit 22 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.09.2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim, firmës **"Eurobag Packing L.L.C"** me seli në Mamushë, rr. Kisla Mahallesi, të cilën e përfaqëson Naser Morina nga Mamusha, I JEPET në shfrytëzim afatgjatë deri **25 (njëzet e pesë)** vjet, prona e paluajtshme e komunës, zonën kadastrale Hoçë e Madhe, sipas certifikatës së pronësisë P-71510008-00266-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 10099m² (dhjetë mijë e nëntëdhjetë e nëntë metra katror), duke përfshirë zyrat administrative dhe objektin në sipërfaqe prej 2000m² (dy mijë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.
2. Afati për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës, fillon të rrjedhë nga data 1.11.2023 dhe përfundon me datën 30.10.2048, ndërsa pas mbarimit të këtij afati ose ndërprerjes së parakohshme të kontratës, e drejta e shfrytëzimit i kthehet Komunës së Rahovecit, si titullar faktik dhe juridik i pronës.
3. Prona e paluajtshme e cekur në pikën 1 të këtij vendimi, i jepet për ushtrimin e veprimtarisë afariste, sipas rekomandimit të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, me Nr. Prot. 5413, të datës 07.09.2023.
4. Obligohet kryetari i Komunës që, me personin fizik dhe juridik përfitues të pronës së paluajtshme të komunës, të lidhë kontratë me të cilën i përcaktojnë të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.
5. Obligohen shfrytëzuesit e cekur në nenin 1 të këtij vendimi, që pronën e paluajtshme të cekur në nenin 1 të këtij vendimi ta shfrytëzojnë me mirëbesim si nikoqir i mirë, që mos t'ia humbë vlerën e saj.
6. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana

e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Kryetarit të Komunës,***
- ***Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,***
- ***Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.140/23
Më datë: 26.09.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (*"Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"*), nenit 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (*"Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019"*), nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 2, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.09.2023 merr këtë:

V E N D I M

Për këmbimin e pronës komunale me pronën e institucionit qendror

1. **Miratohet** propozimi Kryetarit të Komunës Nr. 02/2090/23 i datës 08.09.2023 dhe jepet PËLQIMI për këmbimin e pronës publike komunale me pronën e institucionit qendror për interes publik, e cila gjendet në vendin e quajtur Ravne shume, zona kadastrale Rahovec, parcela me numër P-71510057-02302-0 sipas Certifikatës së pronësisë pronë e Komuna e Rahovecit, me sipërfaqe prej 10000m² (dhjetëmijë metra katror) e cila ndahet nga pjesa e përgjithshme prej 199774m² (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër metra katror) **I JEPET** në posedim P.SH.E KOSOVES K.K.RAHOVEC SHF.EKO.E PYJ. RAHOVEC, ndërsa parcela sipas Certifikatës së pronësisë P-71510057-02240-1 në Zonën Kadastrale Rahovec në posedim të P.SH.E KOSOVES K.K.RAHOVEC SHF.EKO.E PYJ. RAHOVEC me sipërfaqe të përgjithshme prej 10000m² (dhjetëmijë metra katror) e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 7577401m² (shtatë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e një metra katror) **I JEPET** Komunës së Rahovecit, në emër të këmbimit.
2. Qëllimi i këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e institucionit qendror të cekur në pikën **1** të këtij vendimi është për interes publik, përkatësisht për ndërtimin e një mjedisi (parku) rekreativ, i cili do të shërbejë për rekreacion dhe inovacion për qytetarët e komunës së Rahovecit dhe më gjerë.
3. **OBLIGOHET**, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që ti zhvilloj procedurat ligjore në përputhje me dispozitat e nenit 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

4. Vlerësimi i pronës komunale dhe pronës së institucionit qendror të cekur në pikën 1 të këtij vendimi bëhet në bazë të ligjit përkatës për pronën e paluajtshme.
5. Pas përfundimit të procedurave për këmbim, rezultatet e këmbimit duhet publikuar, me përmbajtjen e të dhënave të pronave të këmbyerë, si dhe emrin e pronarit të institucionit qendror me të cilin është bërë këmbimi.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Anëtarëve të Kuvendit,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C

01-Nr.137/23
Me datë:26.09.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Në mbështetje të nenit 12, nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40 paragrafi 2 shkronja (b) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal të datës 13.03.2008, nenit 10 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika 2.2 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 26.09.2023 merr këtë:

V E N D I M
Për miratimin e buxhetit për vitet 2024-2026

Neni 1

Komuna e Rahovecit konform dispozitave ligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës, miraton buxhetin për vitin 2024 me limitet, në bazë të qarkores buxhetore 01 dhe 02 të shpërndara nëpër kategori ekonomike dhe buxheti për vitin 2024 është gjithsej 19,804,785.00€, ku nga grandet qeveritare janë 18,189,881.00€ dhe të hyrat vetanake janë 1,614,904.00€.

Shpërndarja e buxhetit në kategori ekonomike për Komunën e Rahovecit për vitet 2024-2026 është si vijon:

Struktura e Shpenzimit	2024	2025	2026
Paga dhe Mëditje	10,407,314.00 €	10,438,536.00 €	10,469,851.00 €
Mallra dhe Shërbime	2,466,340.00 €	2,498,402.00 €	2,565,859.00 €
Shpenzimet Komunale	390,000.00 €	418,470.00 €	445,671.00 €
Subvencionet dhe Transferet	890,000.00 €	970,100.00 €	1,028,306.00 €
Investimet Kapitale	5,651,132.00 €	6,519,282.00 €	7,370,224.00 €
Buxheti total për vitin 2024	19,804,785.00 €	20,844,790.00 €	21,879,911.00 €

Neni 2

Të hyrat buxhetore komunale krijohen nga dy burime: Grandit qeveritar dhe të hyrave vetanake të cilat realizohen nga tarifat dhe ngarkesat e aprovuara në Kuvendin Komunal të Rahovecit.

Neni 3

Shpenzimet nënkuptojnë të gjitha shpenzimet që kryhen nga Buxheti komunal dhe Buxheti për Arsim dhe Shëndetësi në Komunë, sipas rregullave dhe udhëzimeve financiare të mjeteve të buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Neni 4

Ky vendim do të aplikohet së zbatuari nga 1 Janari 2024.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Kryetarit të Komunës,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

K U V E N D I I K O M U N Ě S N Ě R A H O V E C

01Nr.139/23
Datë:26.09.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008*”), nenit 53 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.09.2023 merr këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit 01 Nr. 129/23 i datës 30.08.2023 për dhënien e lejes për kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore

1. Me këtë vendim **shfuqizohet** vendimi me Nr. Prot. 01 Nr. 129/23 i datës 30.08.2023 për dhënien e lejes për kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore.
2. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **MAPL-së,**
- **Kryetarit të Komunës,**
- **Shërbimit të Kuvendit, dhe**
- **Arkivit.**

K U V E N D I I K O M U N Ě S Ě R A H O V E C

01Nr.141/23
Datë:26.09.2023

Arber Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 26.09.2022 miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelën P-71510033-01035-0 në Zonën Kadastrale Xërxë

- 1. Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/2091/23 i datës 08.09.2023 dhe merret vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelën **P-71510033-01035-0** në Zonën Kadastrale Xërxë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2252m² (dymijë e dyqind e pesëdhjetë e dy metra katror) në vendin e quajtur Skeja, me kulturë Arë e klasës 3, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të P.SH.E KOSOV.K.K.RAHOVEC-SHFRY.N.B.I.RAHOVECI.
- 2.** Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë “Inicimi i procedurave për shpronësimin e parcelës”.
- 3.** Autorizohet Kryetari i Komunës që komform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmer të gjitha veprime të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- 4.** Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
- 5.** Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
- 6.** Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Anëtarëve të Kuvendit,**
- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,**
- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

K U V E N D I I K O M U N Ě S N Ě R A H O V E C

01Nr.136/23
Data:26.09.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Në mbështetje të nenit 11 dhe nenit 24 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 2 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.27/2008, nenit 10, 40, 57 paragrafit 1.1 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.09.2023 merr këtë:

V E N D I M

Për transfer të mjeteve në kuadër të kategorisë Investime Kapitale për vitin 2023

1. MIRATOHET Vendimi për transferin e mjeteve buxhetore të Komunës së Rahovecit për vitin 2023 në shumën prej **60,722.49 €**, si vijon:

2. Nga transferi i mjeteve në kuadër të kategorisë shpenzime kapitale, fondi burimor (10):

2.1. Nga programi Shërbime publike, mbrojtje civile (180), nën programi Infrastrukturë publike (18171), kodi funksional (0451), fondi burimor (10), nga **Investime Kapitale** (30), nga projekti **Ndërtimi dhe trajtimi i ujerave atmosferik në qytet Rr. Xhelal Hajda, 8 Deshmoret e Pashtrikut, Sheh Myhedini (53867)**, shuma prej **40,722.49 €**

2.1.1 Të transferohen në programin Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale (730), nën programin Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73700), kodi funksional (0721), në fondin burimor (10), në projektin: **Blerja e Autoambulancave Krushe e Madhe dhe Rahovec (52287)** shuma prej **9,998.00€** si dhe

2.1.2 Të transferohen në programin Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (470), nën programi Bujqësi (47011), kodi funksional (0421), në fondin burimor (10), në projektin: **Ndërtimi rrugëve fushore Kramovik-Xerxe-Drenoc-Opterushë-Krushë Madhe-Rahovec (53795)**, shuma prej **30,724.49€**

3. Nga transferi i mjeteve në kuadër të kategorisë shpenzime kapitale, fondi burimor (21):

3.1. Nga programi Shërbime publike, mbrojtje civile (180), nën programi Infrastrukturë publike (18171), kodi funksional (0451), fondi burimor (21), nga **Investime Kapitale** (30), nga projekti **Krijimi i parkingjeve Rr. Xhelal Hajda, Gezim Hamza në Rahovec (53793)**, shuma prej **20,000.00 €**

3.1.1 Të transferohen në programin Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale (730), nën programin Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73700), kodi funksional (0721), në fondin burimor (21), në projektin: **Renovimi i objektit të vjetër të QKMF-së në Rahovec (51298)** shuma prej **20,000.00€**.

4. Bartës për rregullimin e dokumentacionit do të jetë Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa***
- ***MAPL-së dhe***
- ***Arkivit.***

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.138/2023
Me datë: 26.09.2023

Arber Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality of Rahovec

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Odeljenje za Kultur, Omladinu i Sport
Department of Culture, Youth and Sport



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Odeljenje za Kultur, Omladinu i Sport

-XIII- Nr. I prot. 75 Më 07.09 2023
Br. prot. 0866 - ORAHOVAC



Datë: 06.09.2023

Datë/Datum/Date:	06.09.2023
Referenc-ë	
Për/Za/To:	Kuvendin Komunal-Rahovec
CC:	
Nga/Od/From:	z. Afrim Dina, Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport
Subjekti/Predmet/Subject	Informatë:



-Informatë për muajin e mërgimtarëve prej 15 korrik deri më 15 gusht 2023:

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa- KPF-së

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport si bartëse e të gjitha aktivitete për muajin e mërgimtarëve ju paraqet dhe informon për mbarëvajtjen e të gjitha aktiviteteve nga 15 korrik deri më 15 gusht 2023.

Manifestimi dhe organizimi i aktiviteteve "Ditët e mërgatës"

Manifestimi tradicional "Ditët e mërgatës", nisi më 15 korrik dhe u përmbyll më 15 gusht, sipas agjendës e cila ka qenë publike, aktivitetet janë organizuar mirë dhe janë pritur jashtëzakonisht mire nga qytetarët tanë.

Me qëllim të ofrimit të mundësisë për takime reciproke ndërmjet mërgimtarëve tanë dhe takimeve me autoritetet lokale, Komuna e Rahovecit, konkretisht DKRS-ja ka organizuar turne në futboll, shah, koncerte dhe ndeja me mërgimtarët (sofra e mërgimtarit) në disa lokalitete.

Ndërsa kryetari i komunës z. Smajl Latifi ka pritur në zyrën e tij shumë mërgimtarë me të cilët ka biseduar për gjendjen socio-ekonomike në komunën e Rahovecit, si dhe ka dëgjuar kërkesat e tyre. Me këtë rast kryetari Latifi ju ka kërkuar mërgimtarëve që merren me biznes në vendet Perëndimore që të shqyrtojnë mundësinë e investimeve në vendlindje.

Përveç pritjeve të organizuara nga kryetari Latifi, mërgimtarët tanë kanë pasur mundësi të argëtohen nga artistët të shumtë të estradës kosovare.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në bashkëpunim edhe me drejtoritë tjera komunale si Drejtorinë për Administratë, Drejtorin e Arsimit, Drejtorin për Ekonmi, Drejtorinë për Bujqësi dhe Zyrën e Kryetarit, kanë organizuar aktivitete të shumta si: Shfaqja teatrale "QUO VADIS" në Qendrën Kulturore "Mensur Zyberaj" –Rahovec, në këtë shfaqje actor kanë qenë të rinjtë e komunës sonë, regjisor i kësaj shfaqje ishte z. Gjergj Mena, shfaqja teatrale ka qenë projekt i SHL-Kosova ku DKRS-ja e ka mbështetur këtë projekt.

Turne në futboll dhe shah, koncerte argëtuese në Rahovec, Xërrxe, Ratkoc, Çifllak, Drenoc, Optrushë dhe Krushë të Madhe u mbajt "Agro Festa" ku kanë prezantuar grupe dhe muzikantë të njohur, siç janë: "Sabri fejjullahu", "Vesa Luma", e këngëtarë të tjerë.

Ndër aktivitetet e pëlqyeshme ka qenë edhe organizimi i veprimtarisë "Sofra e mërgimtarit", që është pritur shumë mirë nga qytetarët dhe kemi kërkesa nga qytetarët që këto aktivitete të organizohen dhe të mbahen në të gjitha vendbanimet e komunës sonë, duke patur parasysh që po ju krijohet mundësia e takimeve dhe bashkëbisedimi me mërgimtarët tanë.

Gjatë muajit të mërgimtarëve 2023 janë mbajtur 16 aktivitete si në Qytet dhe vendbanimet e tjera

Përveç këtyre aktiviteteve u organizua edhe turneu në Shah për penzionista në fshatin Ratkoc ku moren pjesë edhe kurbetqarë në këtë turne, mërgimtarët kanë pasur mundësi të marrin pjesë edhe në turneun e futbollit, që u organizua enkas për dashamirësit e këtij sporti.

Pjesëmarrja e madhe e qytetarëve në këto aktivitete nga data 15 korrik deri më 15 gusht, është dëshmia më e mirë se organizimet kanë qenë në nivel dhe se janë përmbushur në masë të koniderueshme pritjet e mërgimtarëve tanë, aktivitete e organizuar në qytet pikërisht në rrugën "Xhevat Kaspi" janë organizuar në bashkëpunim me bizneset të cilët veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në atë pjesë, ku edhe i falenderojmë për bashkëpunim të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në muajin e mërgimtarëve.

Në të gjitha aktivitetet e mbajtura kanë qenë prezent Pocicia e Kosovës-Stacioni Policor në Rahovec të cilët janë kujdeusr për mbarëvajtjen dhe sigurinë e qytetarëve, ku shfytëzojmë rastin ti falenderojmë për bashkëpunim të cilët janë të gatshëm çdo here të ofojnë siguri për qytetarët.


Sipas të dhënave të vëzhguesve tanë, në këto aktivitete duke filluar nga Qyteti e në të gjitha vendbanimet tjera ku janë mbajtur aktivitete kanë marrë pjesë rreth 16,000mijë qytetarë.

Më poshtë përmesë imazheve po ju paraqesim të gjitha aktivitetet e mbajtura si në Qytet dhe në të gjitha vendbanimet për 30 ditë rreshtë nga 15 korriku deri më 15 gusht 2023,


Me 15.07.2023 mbremje muzikore me kengetarin Visar hajrullaga në Rahovec.



Turneu në futboll të vogël me grupmoshat Pioner, junio dhe senior të mbajtur më 19-20.07.2023 në Ratkoc



Aktiviteti ne Gradish mbajtur me 24.07.2023 koncerti është mbajtur me Shoqerin Kulturo Artistike “Bajram Curri” dhe me këngëtar të estradës sonë.



Sofra e mërgimtarit në Qifllak 29.07.2023



Më 01.08.2023 Në kuadër të Muajit të Mërgimtarëve, në Ratkoc u organizua një turne në shah, ku garues ishin pensionistët e Ratkocit dhe mërgimtarët e kësaj ane. Aktiviteti u organizua nga DKRS, kryesia e fshatit Ratkoc dhe u mbështet nga mërgimtarja Valentina Xheladin Hoti. Për të respektuar mërgimtarët e kësaj ane në turne mori pjesë edhe mjeshtri i shahut Përparim Makolli, reprezentues i Përfaqësueses së Kosovës në shah.



Sofra e mërgimtarit në Drenoc 01.08.2023



Takim me biznese vendore dhe nga diaspora mbajtur me 01.08.2023.



Mbremje muzikore në Rahovec 02.08.2023



Sofra e mergimtarve Opterushe 04.08.2023




Aktivite e mbajtura në AgroFesta 05-06.2023 në Krushë të Madhe.











Të gjitha aktivitetet e filluara me 15 korrik deri më 15 gusht në komunën tonë kanë qenë në nivelin të lartë, kjo falë bashkëpunimit dhe koordinimit me Policinë e Kosovës në Rahovec dhe QKMF-së të cilët na mbështeten tër kohën e mbajtjes së aktiviteteve.

Faleminderit!



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo




Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje
Department for Education

Informatë nga DKA për përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2023/2024

Përsëndetje të nderuar!



Drejtoria Komunale për Arsim, ashtu sikur edhe viteve të tjera është angazhuar maksimalisht t'i bëjë të gjitha përgatitjet e nevojshme për fillimin e vitit të ri shkollor 2023-2024. Pas 3 viteve të ç'rregullta të fillimit të vitit të ri shkollor, për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia globale covid-19 dhe vitin e fundit për shkak të rrethanave të krijuara nga grevat e sindikalistëve, më në fund, ky vit i ri shkollor u bë e mundur të fillojë si vit i rregullt shkollor, më 1 shtator 2023.

Më 1 shtator 2023 filloi viti i ri shkollor 2023/2024 në të gjitha shkollat e komunës sonë, përveç në 2 shkolla, në SHFMU "Gëzim Hamza-Piktori" dhe në SHFMU "Rilindja". Në këto dy objekte shkollore, për shkak të punimeve në ndërmarrjen e masave të efijencës së energjisë dhe për shkak të punimeve në renovime të brendshme, viti i ri shkollor nuk filloi më 1 shtator, por më 11 shtator. Ditët e humbura të mësimit në këto dy shkolla do të kompensohen gjatë vitit shkollor.

Gjatë muajit gusht, DKA ka bërë përgatitjet e duhura në planifikimin e orëve dhe kuadrit mësimor për të gjitha nivelet, e poashtu kemi organizuar dhe mbajtur trajnim për mësimdhënësit e rinj në disa nga fushat kurrikulare. Ky trajnim është mbajtur për mësuesit dhe edukatorët e programit fillor dhe parafillor, për fushën kurrikulare të shkencave të natyrës, për fushën kurrikulare të matematikës dhe për fushën kurrikulare të shkencave shoqërore (shoqëria dhe mjedisi).

Procesi mësimor filloi, por në këtë fillim viti u shkaktua një problem i papritur dhe i paplanifikuar nga MASHTI, sepse 10 ditë para fillimit të vitit të ri shkollor, Ministria doli me njoftim se nxënësit nuk do të furnizohen me tekste shkollore ashtu sikur viteve të kaluara, por këto tekste prindërit duhet t'i blejnë vetë dhe pastaj ata do të rimbursohen nga Qeveria me nga 50 euro për tekste shkollore dhe 30 euro për material shkollore për ciklin e ulët, ndërsa me nga 30 euro rimbursim për material shkollore për ciklin e lartë, klasat 6 deri 9.

Ky vendim i ministrisë, përveç që krijoi huti e kaos, shkaktoi edhe vonesë në furnizimin me libra e tekste shkollore për nxënësit e të gjitha shkollave të komunës sonë. Edhe sot e kësaj dite, shumica e nxënësve nuk i kanë tekstet e duhura shkollore, ndërsa nxënësit e klasave 6 deri 9 janë obliguar t'i përdorin tekstet e vjetra të viteve të kaluara, të kthyer nëpër shkollë nga nxënësit e vitit paraprak shkollor. Gjatë ditëve të para të shtatorit jemi angazhuar që sadopak t'u dalim në ndihmë prindërve përmes mësuesve dhe drejtorëve të shkollave që ata ta kenë më të lehtë të orientohen për tekstet që duhet t'i blejnë për fëmijët e tyre, por edhe për t'i udhëzuar ata se si të aplikojnë në platformën e-Kosova për rimbursimin e mjeteve.

Para fillimit të vitit të ri shkollor, përkatësisht më 26 gusht 2023, u organizua dhe u mbajt edhe afati I dytë I Provimit të Maturës, në të cilin morën pjesë 184 maturantë, të cilët nuk e kishin arritur prapagun e kalueshmërisë në afatin e parë.

Gjithashtu, në fund të muajit gusht, në datat 22, 23 dhe 24 gusht organizuam edhe afatin e dytë (plotësues) të regjistrimit të nxënësve në klasat e dhjeta në 2 SHML-të dhe në IAAP.

Të nderuar!

Edhe pse DKA ka kërkuar vazhdimisht furnizimin me inventar të 3 çerdheve të reja, të ndërtuara nga buxheti i komunës sonë, ky furnizim akoma nuk ka ndodhur nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Këto kërkesa për furnizim me inventar i kemi shoqëruar edhe me specifikacionet përkatëse, por furnizimi akoma nuk ka ndodhur deri më sot. Ne kemi rekrutuar edhe stafine edukatoreve që duhet të angazhohen në këto 3 çerdhe, mirëpo pa ardhur inventari, çerdhet nuk mund të funksionalizohen.

Avni Morina

Drejtor i DKA-së

